Republika e Kosovës

# Republika e Kosovës
## Komuna e Kaçanikut

KAÇANIKU

# KOMUNA E JUAJ, PËR JU

# VJETARI 2011




http://kk.rks-gov.net/kacanik

Janar 2012

Republika e Kosovës
Komuna e Kaçanikut

# KOMUNA E JUAJ
# PËR JU

# VJETARI 2011

Janar 2012

Boton:
Komuna e Kaçanikut

Mbështetur nga:
LOGOS

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Përmbajtja:
Zyra e Informimit
http://kk.rks-gov.net/kacanik/

Retushimi profesional:
Klubi i Gazetarëve të Kaçanikut

Shtypi: Shtypshkronja “ERA” Ferizaj

Shpërndarja falas

*Bashkëqytetarë të nderuar,*

*Besoj se e ndani mendimin tim se edhe 2011-ta ishte vit i sukseseve të Komunës sonë. Kanë vazhduar investimet e shumta në infrastrukturën rrugore e shkollore, rrjete kanalizimesh, terrene sportive, zgjerim hapësirash të gjelbëruara etj.*
*Investime të konsiderueshme janë bërë edhe në sektorin e bujqësisë.*
*Administrata komunale ka qenë e efektshme në ofrimin e shërbimeve qytetarëve, ndërsa tërësisht funksional ka qenë edhe legjislativi komunal.*
*Unë e vlerësoj arritje edhe nisjen e procesit për hartimin e Planit Rregullues Urban të qytetit Kaçanik.*
*Edhe sivjet kemi pasur trend pozitiv të arkëtimit të mjeteve nga tatimi në pronë dhe nga burimet tjera vetjake komunale.*
*Nëpërmjet bashkëpunimit të suksesshëm me donatorë të huaj kemi arritur të sigurojmë donacione për projektet e Komunës. Sivjet është viti i katërt i botimit të Vjetarit. Edhe Vjetari 2011 në mënyrë kronologjike pasqyron vetëm punët dhe aktivitetet më me peshë të realizuara gjatë vitit.*
*Ecja jonë bashkë vazhdon. Besojmë fort se bashkëpunimi i ndërsjellë na bënë më të suksesshëm.*

*Me respekt,*
*Xhabir Zharku*
*Kryetar i Komunës*



*Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku me kabinetin e tij*

*Nga e majta në të djathtë: Bekim Troni, drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Heset Loku, nënkryetari i Komunës, Xhabir Zharku, kryetar i Komunës, Misim Sopa, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës dhe Jeton Topalli, drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme*



Anëtarët e Kuvendit të Komunës bashkë me kryetarin z. Xhabir Zharku

# JANAR 2011

## Tejkalohet planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë

**6 janar.** Zyra e Tatimit në pronë e ka tejkaluar kuotën e planifikuar të arkëtimit të mjeteve nga tatimi në pronë për vitin 2010. Sipas z. Xhelal Dema, menaxher i ZTP-së, ndërmjet 1 janarit dhe 31 dhjetorit 2010 janë arkëtuar 190.228 euro ose 25.228 euro, përkatësisht 15.29 % më shumë se 165 mijë euro e planifikuar me buxhet. Këto të hyra përbëjnë 39 % e të hyrave të përgjithshme vetjake buxhetore. Faktikisht, ZTP-ja plani-fikimin vjetor për këtë vit e ka përmbushur 13 tetor, ndërsa pat arkëtuar 165.115 euro. Në shtimin e të hyrave nga ky tatim ka ndikuar vetëdijesimi i taksapa-guesve, të cilët e kanë kuptuar këto mjete u kthehen atyre nëpërmjet investimeve në projekte kapitale.



# Takimi i parë i Ekzekutivit për vitin 2011

**10 Janar.** Ekzekutivi i Komunës e ka mbajtur takimin e parë për këtë vit. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka uruar me këtë rast për një vit të mbarë e të suksesshëm, ndërsa ka shpalosur një varg çështjesh të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në rritjen e efektivitetit në administratën komunale. Kryetari Zharku theksoi se gjatë këtij viti duhet ndryshuar qasja në punë e sidomos në raport me punëtorët, duke kërkuar përgjegjësi maksimale dhe zero tolerancë.

Kryetari, z. Zharku kërkoi që të vendoset rendi dhe rregulli në të gjitha segmentet e funksi-onimit të administr-atës komunale dhe në terren. Që nga ardhja e z. Xhabir Zharku në postin e kryetarit të Komunës tonë, Ekzekutivi ka mbaj-tur dy takime në javë, të hënën dhe të premten. Këto taki-me i udhëheq kryetari i Komunës, ndërsa marrin pjesë edhe nënkryetari, drejtorët e drejtorive komunale, shefa, menaxherë dhe zyrtarë të sektorëve relevantë të ekzekutivit komunal.



# **Kryetari uron nxënësit** për gjysmëvjetorin e dytë

**10 Janar.** Kam nderin dhe kënaqësinë që në emrin tim dhe të gjithë qytetarëve të Komunës tonë, t'ua uroj fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2010/2011. Sot, një armatë e tërë, pas pushimeve dimërore, po vazhdon betejën për nxënien e njohurive të reja në institucionet tona arsimore.

Të dashur nxënës, sistemi i arsimit në komunën tonë është një shembull i mirë në proceset e reformimit në arsim, duke dëshmuar një paraqitje të lartë dhe duke qenë model edhe për të tjerët. Prandaj, vitin shkollor 2010/2011 e kemi shpallur vit të avancimit të cilësisë në arsim. Jam i bindur se me përkrahjen edhe nga qendrore, së bashku do të arrijmë objektivat tona.

Uroj të jetë një vit i mbarë shkollor dhe të sukseseve të përbashkëta!

***Kaçanik, 10 janar 2011***
***Kryetari i Komunës***
***Z. Xhabir Zharku***

# DAK-ja publikon suksesin e nxënësve për GjVP-në

**12 janar.** Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës ka publikuar raportin e suksesit të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2010/2011. Raportin në takimin me drejtorët e shkollave, në të cilin ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka prezantuar z. Azem Guri, drejtor i DAK-së. Sipas z. Guri, numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar në 12 shkollat fillore të komunës tonë është 5.743 nxënës, prej të cilëve sukses pozitiv kanë arritur 4.793 syresh (84.47 %). Me një e më shumë nota të dobëta gjysmëvjetorin e kanë përfunduar 881 nxënës (15.53 %), ndërsa 69 nxënës kanë mbetur të pa notuar. Nota mesatare në nivel komune për shkollat fillore është 3.63, ndërsa në gjimnazin "Skënderbeu" 3.11, përkatësisht në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" 2.62.

Në këtë takim kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka përshëndetur vendimin e kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për ngritjen e pagave të mësimdhënësve, ndërsa ka kërkuar angazhim më të madh të stafit të

shkollave për ngritjen edhe më shumë të cilësisë si në mësim dhe po ashtu edhe të mirëmbajtjes së objekteve shkollore.



## Arkëtohen 20.984 euro nga qiraja komunale

**13 janar.** Buxheti komunal mbushet edhe nga qiraja e objekteve dhe tokës në pronësi komunale. Gjatë vitit 2010 nga taksa e shfrytëzimit të kësaj pasurie janë arkëtuar 20.984 euro, ose 4.124 euro më shumë se një vit më herët (16.860 euro). Drejtori i Urbanizmit..., z. Bekim Troni, ka thënë se ky rezultat është arritur me një angazhim serioz, duke kontaktuar qiramarrësit dhe duke përdorur forma veprimi efikase. Sipas z. Troni, ndaj pronarëve të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj shfrytëzimit të pronës komunale, janë marrë masa ndëshkuese deri në mbylljen e përkohshme të lokaleve të tyre.

# Formohet komisioni për regjistrimin e popullsisë

**14 janar.** Komuna e ka formuar Komisionin komunal për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Ky komision aktualisht përbëhet nga tetë anëtarë, ndërsa pritet të plotësohet edhe me një anëtar



nga Zyra e regjistrimit të popullsisë. KKRP-ja përbëhet nga: z. Xhabir Zharku, kryetar komune; z. Heset Loku, nënkryetar komune; z. Jeton Topalli, drejtor i DAP-së; z. Azem Guri, drejtor i DAK-së; z. Bekim Troni, drejtor i DUKMM-së; z. Misim Sopa, drejtor i DSHMS-së; z. Fikri Vërbani, drejtor i DFEZH-së dhe z. Shemsedin Abazi, kryetar i NKMDLNJ-së në Kaçanik. Ky komision është formuar me vendimin e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku, më 12 janar 2011, konform nenit 15.3 të Ligjit për regjistrimin e popullsisë.

# Futbollisti Xhevdet Shabani zgjedhet sportisti i vitit 2010

**15 janar.** Në një ceremoni solemne, e mbajtur në Pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj", komuna jonë ka zgjedhur sportistin e vitit 2010. Epiteti i më të mirit i ka takuar futbollistit të Lepencit, Xhevdet Shabani. Nga KF

Lepenci doli edhe pozita e dytë e sportistit të vitit, sulmuesi Rinor Zeneli, ndërsa vendin e tretë e ka zënë Liridon Tafa, i klubit taekwandoo "Shqiponja". Po ashtu janë zgjedhur edhe më të mirët e kategorive të tjera. Në konkurrencën e ekipeve më i suksesshëm është zgjedhur KF Lepenci, i cili sezonin vjeshtor e ka përmbyllur në pozitën e tretë të klasifikimit të Ligës së parë të Kosovës. Trajner i vitit është zgjedhur Selajdin Zeneli (KF Lepenci). Sportisti më perspektiv është zgjedhur Menduh Raka, taekwondo



"Shqiponja", ndërsa donatori më aktiv "Sharrcem-Titan" nga Hani i Elezit. Komisioni vlerësues përbëhej nga: Ismet Shurdhani (FFK), Kjani Sallahu ("Zëri"), Jeton Matluma ("Fikshat"), Fikri Vërbani, drejtor i DFEZH-së dhe Fatos Vishi (DAK).

## Zyra e Pritjes shqyrton 30 mijë lëndë

**17 janar.** Zyra e Pritjes në Kaçanik, në të cilën palët aplikojnë për nxjerrjen e dokumenteve personale..., brenda vitit 2010 ka shqyrtuar rreth 30 mijë kërkesa të qytetarëve, ndërsa nxjerrja e certifikatave të lindjes vazhdojnë të dominojnë në kërkesat e qytetarëve. Gjatë vitit që lamë pas janë kryer gjithsej 29.950 lëndë, prej të cilave 6.923 certifikata të lindjes, pastaj certifikata të shtetësisë (4.736), të vendbanimit (3.965), të kurorëzimit

(2.643) etj. Sipas z. Ilir Teneqja, koordinator i Zyrës së Ofiqarisë, më së paku kërkesa ka pasur për “gjendjen materiale” (82 sosh). Në kuadër të raportit vjetor të kësaj zyre, në librin e amzës figurojnë vetëm 102 banorë të regjistruar në vitit 2010, sepse sipas drejtorit të Administratës së Përgjithshme, z. Jeton Topalli, banorët e ri të komunës tonë figurojnë kryesisht në librat amzës të komunës fqinje- Ferizaj, për shkak se në komunën tonë nuk është funksionale shërbimi i maternitetit.

## Komuna dhe LOGOS-i takohen me GPHPRr-në

**19 janar.** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe koordinatori i projektit LOGOS, z. Norbert Pijls, janë takuar me anëtarët e grupit punues për hartimin e Planit rregullativ të qytetit të Kaçanikut.
Kryetari Zharku ka shprehur mbështetjen e tij për këtë projekt dhe e ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm. Z. Zharku ka shprehur bindjen e tij se ky plan rregullativ do të përputhet me interesat e qytetarëve të komunës tonë. Ndërkaq, koordinatori i projektit LOGOS, z. Norbert Pijls, ka thënë folur në superlativ për udhëheqjen e përkushtuar të komunës tonë. Z. Pijls ka thënë se ky plan është i rëndësishëm sidomos për qytetarët të cilët jetojnë në këtë zonë, ndërsa ka kërkuar pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit të bërjes së këtij plani. Bartëse e hartimit të planit rregullativ është Drejtoria e Urbanizmit, kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ndërsa drejtori i saj, z. Bekim Troni, ka përmendur emrat e 15 anëtarëve të grupit punues të këtij plani, zyrtarë komunalë dhe ekspertë të jashtëm: z. Bekim Troni, z. Fatos Koxha, z. Edmond Mjaku, znj.



Arlinda Kolshi, z. Imer Vlashi dhe z. Mendu Krasniqi (zyrtarë komunalë) dhe ekspertë të jashtëm: z. Fadil Sherifi, z. Alban Sokoli, znj. Vjosa Kyqyku-Rexhepi, z. Xhevdet Kuka, znj. Florie Durmishi – Guri, z. Hisni Baftiu, z. Gafurr Guri, dhe znj. Arlinda Krivanjeva.

## Komuna përfshihet në projektin e KE-së EULUP

**21 janar.** Komuna jonë është përzgjedhur nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO), për realizimin e projektit Mbështetja e Mëtutjeshme e Shfrytëzimit të Tokave (EULUP). Konfirmimin për pranimin e komunës tonë në këtë projekt e ka bërë znj. Nada Nordin, zëvendësmenaxhere e projektit të EULUP-it, në një takim me nënkryetarin e Komunës, z. Heset Lokun.
Nisur nga fakti se komuna jonë është kryesisht rurale, nënkryetari Loku, e ka vlerësuar si shumë i rëndësishëm këtë projekt, i cili sipas znj. Nordin projekti synon të bëjë shtimin e vazhdueshëm të produktivitetit dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore, përmes reformave dhe planifikimit të qëndrueshëm hapësinor. Sipas saj, ndër komponentet e këtij projekti janë: të ndihmojë në harmonizimin e legjislacionit për menaxhimin e tokave rurale, të nxisë dhe kryej skemat e konsolidimit të tokave, të krijojë dhe testoj modelin për planin e menaxhimit të tokës rurale në nivel komunal, të përmirësojë praktikat dhe procedurat e qiradhënies dhe vlerësimit të tokës, të iniciojë regjistrimin e thjeshtësuar të parcelave të tokës sipas modelit prototip GIS,



të bëjë regjistrimin e gjurmimit të terrenit për ndotje të tokës bujqësore dhe krijojë bazën e të dhënave GIS, të koordinojë bashkëpunimin dhe bëjë ngritjen e kapaciteteve për përfituesit dhe palët me interes... Qëllimi kryesor i projektit është zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në përgjithësi.

## Blegtoria- 5.308 krerë gjedhe dhe viça

**21 janar.** Komuna jonë ka bërë përmbledhjen e gjendjes së përgjithshme blegtorale. Sipas të dhënave të cilat i ka prezantuar drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë..., z. Nuhi Provoliu, në pronësi private në komunën tonë ekzistojnë 5.308 krerë gjedhe dhe viça, 3.094 krerë dele, 245 krerë dhi, 122 kuaj, 31.400 kokë shpezësh, 1.500 koshere bletësh dhe dy ferma pulash ekstensive. Këto të dhëna z. Provoliu i ka bërë publike në takimin e drejtuesve të ekzekutivit, ndërsa tha se ky raport statistikor i është dorëzuar Ministrisë së Bujqësisë.

## Aprovohet hartimi i Plani rregullues i zonës së parë të qytetit

**28 janar.** Në seancën e rregullt, legjislativi ia ka dhënë vizën hartimit të Planit rregullues për zonën e parë të qytetit. Plani rregullues parashihet të realizohet më së largu deri në 12 muajt e ardhshëm, ndërsa në fazën e parë do të përfshihet vetëm zona prej rrugës "Emin Duraku" dhe përfshin hapësirën mbi rrugën "Skënderbeu", në gjatësinë e saj duke filluar nga xhamia e qytetit e deri te



Shtëpia e Kulturës “Xheladin Kurtaj”. Ky projekt realizohet nga Fondacioni zviceran “Intercoorporation”, ndërsa financohet nga Qeveria Zvicerane. Në këtë mbledhje Kuvendi Komunal pa debat ka aprovuar edhe planin vjetor të mbledhjeve të KK-së për vitin 2011, si dhe Raportin e punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2010.

## Kryetari Zharku takohet me ekspertin irlandez Mc Keever

**31 janar.** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka pritur në zyrën e tij ekspertin nga Irlanda Veriore, z. Sean Mc Keever. Ky i fundit ka shpalosur projektin “Bashkëpunimi Evropian për komuna të fuqishme- Planifikimi për ofrimin e shërbimeve”. Sipas z. Mc Keever, ky projekt i Komisionit Evropian ka për qëllim ta përkrah komunën në zhvillimin e mëtejmë të planifikimit dhe sistemet e ofrimit të shërbimeve të cilat reflektojnë dialog me qytetarët dhe mekanizma efikas të ofrimit të shërbimeve. Ndërkaq kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka vlerësuar se Komuna ka nevojë për pajisje më të avancuara teknologjike, në mënyrë që të krijohen kushte për shërbime më efikase.



SHKURT 2011

## Kryeshefi i AKK-së vizitoi Kadastrën

**1 shkurt.** Kryeshefi i Agjencisë së Kadastrave të Kosovës, z. Murat Meha, i shoqëruar nga zyrtarë të lartë të kësaj agjencie, e ka vizituar Zyrën e Kadastrit të komunës tonë. Vizita e z. Meha ishte në funksion të ngritjes së bashkëpunimit ndërmjet AKK-së dhe ZKK-së, si dhe të njoftimet rreth punës dhe sfidave me të cilat është duke u përballur sektori i kadastrës.



# Promovohet libri “Puset e vdekjes”

**3 shkurt.** Në Kaçanik është përuruar libri “Puset e vdekjes” dhe është shfaqur një dokumentar me përmbajtje nga lufta në Kosovë, i autorit norvegjez Josef Martinsen. Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, ka përgëzuar autorin e këtij libri për punën e tij humane, që përmes librit dhe filmit dokumentar ka prezantuar ngjarje të tmerrit dhe masakrave në Kosovë, të kryera nga regjimi i egër pushtues serbë gjatë viteve 1998-1999. Libri “Puset e Vdekjes” sjell shumë dëshmi faktografike për masakrat në Kosovë dhe zhvarrosjen e viktimave të hedhura në puse nga forcat pushtuese. Edhe dokumentari për krimet e luftës në Kosovë prezanton krimet ndaj popullatës civile, ndërkaq bazohet në dëshmitë e njerëzve të gjallë të cilët përjetuan këto krime. Në mesin e ngjarjeve në këtë dokumentar ishte përfshirë edhe masakra e Kotlinës së Kaçanikut, në të cilën më 24 mars 1999 forcat paramilitare e policore serbe patën masakruar disa civilë shqiptarë.



# Botohet dhe shpërndahet “Vjetari 2010”

**4 shkurt.** Përmbledhja e aktiviteteve njëvjeçare të Komunës, e publikuar në librin “Vjetari 2010”, e cila ka dalë nga shtypi, ka nisur t’i shpërndahet falas qytetarëve të komunës tonë. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në një takim me drejtorët e ekzekutivit komunal, tha se ky libër, sikurse edhe ata të dy viteve pararendëse, është bërë me qëllim të publikimit të punës dhe aktiviteteve të Komunës dhe është në funksion të rritjes së transparencës së Ekzekutivit dhe Legjislativit komunal. Edhe në këtë vëllim të Vjetarit 2010 në mënyrë kronologjike janë përfshirë vetëm punët dhe aktivitetet më me peshë gjatë vitit që e lamë pas.
Librin “Vjetari 2010”, i cili është përgatitur nga Zyra Komunale për Informim, e ka botuar Komuna e Kaçanikut.



## Kryetari Zharku priti një delegacion të FSK-së

**7 shkurt.** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka pritur në zyrën e tij një ekip mobil të FSK-së, në krye me kapter Zeqir Zeqirin. Ky takim është zhvilluar në funksion të sensibilizimit dhe inkurajimin e të rinjve për të aplikuar që të bëhen pjesë e FSK-së. Kryetari Zharku tha me këtë rast se Forca e Sigurisë së Kosovës është një forcë e re dhe profesionale, ndërsa misioni i saj është që të kryejë operacionet e reagimit ndaj krizave në Kosovë dhe jashtë saj. Në kuptim të kësaj, ai vlerësoi se nevojiten njerëz të përkushtuar, të përgatitur fizikisht e profesionalisht, në mënyrë që kjo forcë të kryejë sa më me përgjegjësi misionin që ka.



## Komuna dhe CDF-ja realizojnë projektin e PSZhL-së

**8 shkurt.** Komuna dhe Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) janë pranë fillimit të realizimit të projektit: "Përfshirja sociale dhe zhvillimi lokal", projekt i cili financohet nga Banka Botërore. Znj. Vjollca Kelmendi, koordinatore e projektit në CDF, në një takim me kryetarin e Komunës, z. Xhabir Zharku, ka thënë se ky projekt trevjeçar për qëllim përmirësimin e kualitetit të infrastrukturës dhe ndërtimin e infrastrukturës së re për komunitete, si dhe përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla. Ndërkaq, kryetari Zharku, duke e cilësuar si shumë konkret dhe në të mirë të qytetarëve, ka premtuar se do ta mbështesë fuqishëm këtë projekt. Ai tha se ideja e këtij

projekti përputhet plotësisht me vizionin tim, ndërsa ka shtuar se do t'i inkurajojmë edhe ndërmarrësit që të aplikojnë për grante në përkrahjen e NVM-ve. Projekti i sipërpërmendur përmban tri komponentë kryesore: zhvillimin e infrastrukturës lokale (me bashkëfinancim të Komunës), përkrahjen në gjenerimin e punësimit nëpërmjet asistencës teknike për NMV-të dhe grante në shumën deri 10 mijë euro, si dhe ndërtimin e kapaciteteve në nivel komunal.



## Komuna u dërgon apel qiraxhinjve borxhlinj

**9 shkurt.** Komuna e Kaçanikut u ka dhënë afat prej tri javësh qiraxhinjve borxhlinj, që ta paguajnë borxhin e tyre ndaj Komunës, përndryshe atyre do t'iu mbyllen lokalet, do t'iu merret e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore dhe lokaleve, rrënimi i objektit dhe masa të tjera ligjore. Nëpërmjet një ftese publike borxhlinjtë e qirasë komunale janë afatizuar që deri më 1 mars të këtij viti, në emër të borxhit të tyre t'i paguajnë Komunës së paku 20 mijë euro, përkatësisht gjysmën e borxhit të tyre. Janë gjithsej 82 lokale afariste të ndërtuara në pronë publike të Komunës së Kaçanikut, pronarët e të cilëve i kanë borxh të qirasë 40.419 euro. Një apel i ngjashëm borxhlinjve i është bërë edhe vitin e kaluar dhe se disa lokale qenë mbyllur deri në kohën e pagesës së qerasë.

## Interesim i madh për kontrollor të regjistrimit të popullsisë

**11 shkurt.** Për pesë ditë rreth 83 persona kanë marrë fletë-aplikacionin për të konkurruar për kontrollor të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në komunën e Kaçanikut, ndërsa 36 sish tashmë i kanë deponuar dokumentet e kërkuara për t'u bërë pjesë e këtij procesi. Sipas z. Misim Sopa, anëtar i Komisionit komunal për regjistrim, ky konkurs do të jetë i hapur deri më 18 shkurt, ndërsa në këtë funksion do të pranohen gjithsej 18 kandidatë. Për pranimin në këtë punë në kohëzgjatje nga 10 marsi deri më 25 prill të këtij viti, Sopa i ka përmendur edhe kriteret e aplikueshme. Sipas konkursit, për këtë pozitë paga bazë mujore do të jetë 400 euro.

## Turne në futboll për nder të Ditës së Pavarësisë

**14 shkurt.** Për nderë të Ditës së Pavarësisë, edhe sivjet, për të tretën herë me radhë, po mbahet Turneu në Futboll të vogël "Kupa e Pavarësisë".
Në këtë turne po marrin pjesë nga dy ekipe të 12 shkollave fillore të komunës tonë. Turneu ka filluar më 7 shkurt, ndërsa sistemi i garave është eliminues. Finalja e turneut "Kupa e Pavarësisë" do të luhet më 16 shkurt 2011, në orën 15:00. Të gjitha ndeshjet janë duke u zhvilluar në fushën e futbollit të vogël "Diti Sport" në Kaçanik.



# Prezantohet programi i USAID-it për pyjet

**15 shkurt.** Në kuadër të programit të USAID-it për ndërmarrjet private në Kosovë, është mbajtur një punëtori në të cilën janë trajtuar planet menaxhuese, procesi i certifikimit, parimet, kriteret dhe procedura të tjera për pyjet në komunën e Kaçanikut. Në këtë prezantim të organizuar nga USAID-i, Drejtoria e Pylltarisë e Komunës së Kaçanikut, është vlerësuar se Kosova ka potencial të madh për zhvillimin e pyjeve, ndërsa është folur për certifikimin e kësaj pasurie sipas kritereve të caktuara. Në takim është shprehur shqetësimi se pyjet janë duke u prerë me të madhe, ndërsa është thënë se sivjet do të pyllëzohet një sipërfaqe prej 5 hektarësh me pishë të zezë dhe po aq me fidanin e llojit hormosh. Në këtë prezantim kanë marrë pjesë përfaqësues të DBPZHR-së në Kaçanik, përfaqësues të ndërmarrjeve private të pyjeve nga Kaçaniku, etj. Komuna e Kaçanikut ka gjithsej 14.215 hektarë pyje, 10.416 hektarë pyje publike dhe 3.800 sosh private. Që nga 12 korriku i vitit 2010, menaxhimi i pyjeve po bëhet nga Komuna, pasi kjo kompetence është bartur nga niveli qendror.



# Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, uron për Ditën e Pavarësisë

**16 shkurt.** Qytetarë të nderuar të komunës së Kaçanikut!
Kam kënaqësinë, që me rastin 17 shkurtit, t'ua uroj trevjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Kosova e pavarur, sovrane e demokratike sot feston Ditën e Pavarësisë, ditë për të cilën u derdh shumë gjak.
Sa herë që vjen kjo ditë, ne kujtojmë historinë tonë të lavdishme edhe të dhimbshme. Kjo ditë na përkujton sakrificat dhe vuajtjet tona, na kujton breza të tërë që luftuan nëpër kohë, na kujton dëshmorët e rënë për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës, ata që dhanë më të shtrenjtën, jetën e tyre.
Gjaku i tyre u bë themel i së sotmes dhe i së ardhmes së vendit tonë.




**Gëzuar Festa e Pavarësisë!**

Me respekt,
Kryetari i Komunës
z. Xhabir Zharku

# Shkolla “Emin Duraku” fitoi “Kupën e Pavarësisë”

**16 shkurt.** Ekipi i shkollës fillore “Emin Duraku” është fitues i turneut në futboll të vogël “Kupa e Pavarësisë”, turne i cili u mbajt për nder të trevjetorit të shpalljes së Kosovës shtet i pavarur. Fituesit kupën ia dorëzoi nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku. Ekipi më “Fair Play” i turneut është shpallur ai i shkollës fillore “Jusuf Gërvalla” nga fshati Biçec, ndërsa futbollisti më i mirë u shpall Masar Jakupi nga shkolla fillore “Emin Duraku”.
Organizatori i turneut, Drejtoria e Arsimit e Kulturës , ka ndarë mirënjohje dhe medalje për më të mirët dhe ekipet pjesëmarrëse.
Turneu në Futboll të vogël “Kupa e Pavarësisë” është organizuar për nderë të përvjetorit të tretë të pavarësisë, ndërkaq kanë marr pjesë 12 shkollat fillore të komunës së Kaçanikut me nga dy ekipe.
Të gjitha ndeshjet janë zhvilluar në fushën e futbollit të vogël “Diti Sport” në Kaçanik.



## Filloristët pikturojnë Pavarësinë

**16 shkurt.** Për nder të trevjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në Pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj" është hapur një ekspozitë me piktura dhe vizatime me motive nga 17 shkurti 2008. Këto punime janë realizuar nga nxënës të shkollave fillore, shumicën e të cilëve e kanë ekspozuar nxënës të SHMU "Ali Asllani" nga fshati Doganaj. Për nder të kësaj dite, në komunën tonë janë zhvilluar edhe aktivitete të tjera kulturore e sportive.




## Kremtohet trevjetori i Pavarësisë së Kosovës

**17 shkurt.** Me një mori aktivitetesh kulturore e sportive në komunën tonë është shënuar përvjetori i tretë i shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Për nder të këtij përvjetori është mbajtur një akademi solemne, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve lokale dhe qytetarë të shumtë. Në një fjalë rasti në emër të Komunës, z. Heset Loku, nënkryetar, ka përshkruar historikun e zhvillimeve kombëtare nëpër periudha të njohura që nga Lidhja e Prizrenit e deri në shpalljen e Kosovës shtet sovran e demokratik. "Ishte

rrugë e gjatë për të ardhur deri te pavarësia e vendit tonë. Për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës u derdh gjak, prandaj duhet t'i kujtojmë të gjithë ata që kontribuuan që vendi ynë të jetë i lirë. Jeta dhe vepra e dëshmorëve është një kapitull i ndritur për lirinë e Kosovës", ka thënë nënkryetari Loku, i cili ka vlerësuar se tani si shtet kemi shumë obligime, e sidomos procesin e integrimit të vendit. Akademinë e ka përshëndetur z. Ejup Runjeva, kryetar i OVL-së, dega në Kaçanik. Për nder të këtij përvjetori është shfaqur edhe një koncert festiv me këngë e valle të këngëtarëve dhe SHKA-ve kaçanikasve. Para se të mbahen këto dy aktivitete, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku bashkë me stafin e tij si dhe qytetarë të shumtë, kanë bërë homazhe pran varreve të dëshmorëve dhe kanë vendosur lule të freskëta. Për festën e pavarësisë, i tërë qyteti është veshur me flamuj shtetëror e kombëtar.



## Pezullohen nga shkolla 26 gjimnazistë

**18 shkurt.** Për shkak të mungesave të shumta, 26 nxënës të gjimnazit "Skënderbeu" në Kaçanik, prej tyre 8 maturantë, janë pezulluar nga shkolla. Vendimin për përjashtimin e tyre e ka marrë drejtori i këtij gjimnazi, z. Ibush Vishi. Kjo masë disiplinore e pezullimit ka afat prej tri ditësh. Vendimi është bazuar në udhëzimin administrativ të MASHT-it, nr. 7/2009, për thyerjen e Kodit të mirësjelljes. Në vendimin e drejtorit Vishi, thuhej se ka ka nxënës që ka të regjistruara madje deri në 106 mungesa të paarsyeshme, përderisa minimumi i tyre është 32 mungesa të paarsyeshme, me aq sa nxënësi e

humb statusin e nxënësit të rregullt. Një vendim të ngjashëm për 29 nxënës të tjerë, drejtori i gjimnazit "Skënderbeu" e pat marrë edhe në prill të vitit të kaluar, por ata qenë falur më 22 prill nga kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, për për nderë të përvjetorit të 11-të të rënies së dëshmorit Feriz Guri- komandant "Shpatës".

## Lojërave të fatit së shpejti i vihet dryni




**19 shkurt.** Komuna e Kaçanikut ka nisur procedurat për ndalimin e disa lojërave të fatit. Një propozim për t'ia vënë drynin këtyre bizneseve e ka nisur në procedim kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në takimin e drejtuesve të ekzekutivit. Ky propozim i është adresuar për shqyrtim Komitetit për Politikë dhe Financa, ndërsa fjalën e fundit do ta thotë legjislativi lokal, javën e ardhshme. Në nenin 1 të dispozitave të përgjithshme të këtij propozimi thuhet se: "Me qëllim të parandalimit të problemeve si rrjedhojë e ekzistimit të këtyre lokaleve me ndikim në nxitjen e kriminalitetit, prishjen e rendit dhe qetësisë publike dhe uljen e mirëqenies sociale, ndalohet organizimi i këtyre lojërave të fatit: "Keno" dhe variantet tjera të saj, lojërat në "Casino", lojëra në automate në klube të veçanta dhe çdo lojë tjetër që mund të ndikojë në dukuri të sipërpërmendura". Për shkelësit eventualë të këtij vendimi, Komuna ka paraparë gjobë në lartësi prej 500 euro për personat fizikë dhe 1.000 euro për personat juridikë. Aktualisht janë 6 lokale të cilat ushtrojnë këso veprimtarish, ndërsa ky vendim nuk përfshinë edhe bastoret sportive.

# Nis procedimi i projekteve të sivjetme

**25 shkurt.** Projektet kapitale të cilët janë në listën e investimeve për sivjet, kanë nisur rrugën e realizimit. Menaxheri i Zyrës së Prokurimit, z. Zeqir Selmani, ka thënë se për katër projekte tashmë është shpallur tender publik: faza e parë e asfaltimit të rrugës në lagjet "Murseli" e "Kolshi" të fshatit Doganaj, për të cilën janë paraparë 50 mijë euro, pastaj faza e tretë e asfaltimit të rrugës në fshatin Bob (50 mijë euro), asfaltimi i rrugës në lagjen "Kukaj" të fshatit Bob (100 mijë euro) dhe ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen "Dalloshi" të fshatit Soponicë. Në listën e projekteve kapitale për vitin 2011 janë gjithsej 34 projekte në vlerë 1.470.374 euro. Prej tyre 969.194 euro janë planifikuar të përfitojmë nga grantet qeveritare dhe 501.180 euro nga të hyrat vetjake. Nga lista e investimeve kapitale për sivjet dominojnë projektet e asfaltimit të rrugëve.



# Miratohet raporti financiar 2010, ndalohen lojërat e fatit

**28 shkurt.** Kuvendi i Komunës në mbledhjen e dytë me radhë për këtë vit, ka miratuar Raportin vjetor financiar për vitin që e lamë pas, raport i cili është hartuar në bazë të pasqyrave standarde të Udhëzimeve Administrative të thesarit dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për financat publike.

Sipas këtij raporti, buxheti fillestar i vitit 2010, i miratuar në Kuvend, ishte në shumë prej 4.334,710 euro, ndërsa buxheti final ishte 4.644,944 euro apo për 310.139 euro ose 7.2 % më i lartë se ai i miratuar në fillim të vitit.

Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 2.788,329 euro, për mallra dhe shërbime 457.819 euro, për shërbime komunale, 92.580 euro, për transfere dhe subvencione 61.158 euro dhe shpenzime kapitale prej 1.245,059 euro.

Anëtarët e Kuvendit kanë aprovuar edhe bartjen e bilanceve të pashpenzuara (202.572 euro) nga të hyrat vetjake komunale nga viti 2010 në buxhetin e sivjetmë.

Kuvendi i Komunës miratoi edhe propozim-vendimin për ndalimin e disa lojërave të fatit. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, këtë vendim e ka cilësuar si shumë të drejtë dhe në përputhje me interesat e qytetarëve të komunës tonë. Ai ka thënë se me këto lojëra qytetarët po e thellojnë krizën buxhetore familjare, e cila është mjaft i varfër, ndërsa është rritur edhe shkalla e kriminalitetit . Ky vendim i ndalon lojërat e fatit: keno, lojëra në kazino dhe lojëra në automate.



# *MARS 2011*

## Mali prehet dhe bartet natën me vetura

**1 mars.** Në Drejtorinë e Pylltarisë kanë marrë një informacion, sipas të cilit është duke u zhvilluar një aktivitet i madh ilegal për dëmtimin e pyjeve përskaj rrugës rajonale Doganaj-Glloboçicë. Për ndalimin e kësaj dukurie, drejtori i këtij dikasteri, z. Nuhi Provoliu, ka thënë se i kemi koncentruar rojet e pyllit dhe punëtorët teknik për kontroll të shtuar dhe rigoroz në këtë pjesë, ndërsa është njoftuar edhe policia. Ai tha se persona ende të panjohur janë duke e prerë ahishtën e malit Sharr, ndërsa prerjet e drunjve janë duke ndodhur gjatë natës dhe janë duke u transportuar me automjete të vogla transporti. Përgjatë kësaj rruge shihen me të madhe drunj të prerë të cilët pothuaj e kanë zënë edhe rrugën. Pyjet e territorit të komunës së Kaçanikut, nga viti 2010 i menaxhon Komuna, e cila që nga marrja e kësaj kompetence ka ndikuar në masë të madhe në parandalimin e veprimtarisë ilegale të prerjes së pyjeve në këtë trevë.



# Kryetari takoi përfaqësuesit e GIZ-së

**1 mars.** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka takuar përfaqësuesit e organizatës gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar GIZ, udhëheqësen e projektit znj. Veronika Hofinger, eksperte ndërkombëtare dhe z. Mustafë Kastrati dhe znj. Fëllanza Bajçinovci, këshilltarë lokalë të projektit. Kryetari Zharku u ka thënë mysafirëve se Komuna ka projekte konkrete dhe është e interesuar për mbështetje financiare të tyre. Ai tha se do të bashkëpunojmë ngushtë me donatorë, të cilëve do t'ua propozojmë projektet e modifikuara në përputhje me formën në të cilën e kërkon investitori.
Ndërkaq, ekspertja e GIZ-së, znj. Hofinger ka thënë se kjo organizatë është e interesuar të informohet për nevojat që i ka komuna e Kaçanikut. Ajo tha se GIZ-ja u ofron asistencë partnerëve të saj dhe më pas i bën vlerësime rezultatit të projekteve, të cilat financohen nga BE-ja. Projekti i GIZ-it "Zhvillimi ekonomik rural" do të mbështes promovimin e sektorit privat dhe do të përkrahë ndërmarrjet ekzistuese në ngritjen e aftësisë konkurruese dhe në zgjerimin e prodhimtarisë së tyre edhe me qëllim të rritjes së shkallës së punësimit.



# Drejtorët identifikuan prioritetet për projektin POSh

**2 mars.** Drejtorët komunalë kanë identifikuar dhe specifikuar fushat dhe nevojat për përmirësimin dhe menaxhimin më të mirë të Komunës. Në një takim me z. Sean Mc Keever, ekspert nga Irlanda Veriore dhe Argurjana Sadiku, zyrtare në projektin: "Bashkëpunimi evropian për komuna të fuqishme - Planifikimi për ofrimin e shërbimeve", ata kanë përmendur si prioritet trajnimin e zyrtarëve të sektorit të Urbanizmit për GIS, trajnimin e Grupit të Ambientalistëve të Rinj, trajnimet për mjekësi familjare etj. Po ashtu është shtruar si nevojë edhe kyçja e shoqërisë civile në hartimin e buxhetit dhe dokumenteve zhvillimore. Ky është projekt i Komisionit Evropian dhe synon të ndërtojë marrëdhënie të ngushta në mes Britanisë së Madhe dhe Danimarkës me Kosovën.



# Kryetari Zharku prononcohet për KTV-në

**2 mars.** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka dhënë një intervistë televizionit me frekuenca nacionale KTV. Tema e kësaj interviste kishte të bënte me vendimin e Komunës për ndalimin e disa lojërave të fatit në territorin e komunës së Kaçanikut. Kryetari Zharku e ka mbrojtur vendimin e KK-së, duke e cilësuar atë si vendim në të mirë të qytetarëve tanë. Kryetari, z. Zharku i ka thënë gazetarit të KTV-së, Ridvan Hamza se ky vendim është në të mirë të gjithë qytetarëve. "Ne jemi këtu që të mbrojmë interesat e tyre prandaj edhe kemi hartuar një Propozim - Vendim për ndalimin e këtyre lojërave që dëmtojnë buxhetin edhe ashtu të varfër të qytetarëve tanë. Propozimi është mbështet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit por edhe është mirëprit nga qytetarët" ka thënë mes tjerash kryetari Zharku



# Më shumë investime për qasje fizike të PAK-ve

**3 mars.** Shoqata e personave me aftësi të kufizuara "Handikos", e mbështetur nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, ka mbajtur një tryezë diskutimi për avancimin e kushteve të kësaj kategorie, me theks të veçantë qasjen fizike të këtyre personave në objektet e institucioneve publike. Në këtë debat në të cilin morën pjesë përfaqësues institucionesh lokale, ata të institucioneve arsimore, nxënës e studentë dhe shoqëria civile, është vlerësuar se edhe ndërmarrjet publike, por edhe disa kompani private të frekuentuara nga personat me aftësi të kufizuara, duhet të kenë infrastrukturën fizike për qasje të personave me aftësi të kufizuara. Është thënë se Komuna ka investuar në këtë drejtim. Vedat Dema, koordinator i të Drejtave të Njeriut, ka insistuar në aplikimin e një rregulloreje të brendshme komunale, për t'i obliguar ndërtimet e larta që ta kenë edhe infrastrukturën e nevojshme për qasje të plotë të PAK-ve. Si projekte të realizuara kohën e fundit për qasje të PAK-ve, drejtori i Urbanizmit, Bekim Troni, ka përmendur mundësimin e kyçjeve me karroca në të gjitha trotuaret e rrugëve të qytetit dhe ndërtimin e pjerrinës në objektin e KK-së.



# BB-ja akordon 70 mijë euro për NMV-të

**4 mars.** Fondi i pavarur për zhvillimin e komunitetit – CDF është implementuese e një granti të Bankës Botërore në vlerë 70 mijë euro, ndërsa këto mjete i ka orientuar për t'i përkrahur ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, për ngritjen e infrastrukturës dhe përmirësimin e kualitetit të tyre, përkatësisht përkrahjen e themelimit të ndërmarrjeve të reja. Projektin "Përfshirja sociale dhe zhvillimi lokal" CDF e ka prezantuar në një takim në të cilin kanë marrë pjesë rreth 50 pretendues për përfitimin e këtij granti. Grantet nuk jepen në formë të parave gatshme, por bëhet financimi i makinerisë dhe mjeteve të punës. Albina Berisha, përgjegjëse e implementimit të këtyre granteve në CDF, tha se ndër kriteret e përfitimit nga ky donacion janë: gjenerimi i punësimit, qëndrueshmëria e biznesit, ofrimi i punës së vazhdueshme, dëshmia për zhvillim potencial të biznesit të ri, participimi me 20 për qind të vlerës së projektit etj. Të pranishmit më së shumti kanë shfaqur interesime për investime, përkatësisht hapje të bizneseve në lëmin e ndërtimtarisë, shpezëtarisë, transportit, përpunim të plastikës dhe metaleve, etj.



# Nata e Zjarreve

**7 mars.** Në kuadër të manifestimit "Epopeja e UÇK-së" është shënuar "Nata e Zjarreve", ndërsa në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve është bërë ndezja tradicionale e zjarreve në shenjë nderimi për luftës dhe flijimin e komandantit legjendar Adem Jashari. Në shënimin e 13 vjetorit të kësaj ngjarje historike, pos qytetarëve të shumtë, morën pjesë krerët komunal, familjarë të dëshmorëve dhe ish ushtarë të UÇK-së."



# Shënohet  Dita e Mësuesit

**7 mars.** Për nderë të 7 Marsit– Ditës së Mësuesit, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka shtruar një darkë për arsimtarët e të gjitha shkollave të komunës tonë.

Kryetari Zharku ua ka uruar të gjithë arsimtarëve festën e mësuesit dhe ka çmuar lartë sakrificën e tyre në mbajtjen gjallë të arsimit në kohën e okupimit. Në këtë darkë ishte i pranishëm edhe ministri i MASHT-it, z. Ramë Buja dhe këshilltari i tij z. Nehat Mustafa. Kryetari Zharku, 7 Marsin e ka vlerësuar si ngjarje me rëndësi në gjithë hapësirën shqiptare ndërsa tha se kjo ditë madhështohet pasi që koincidon me Epopenë e UÇK së dhe sakrificën e familjes Jashari. Ndërkaq, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë Buja, u ka thënë arsimtarëve kaçanikas se synim i tij është ngritja e cilësisë në arsim e kjo arrihet me një angazhim të përbashkët. Ministri Buja ka ripërsëritur premtimin e Qeverisë së Kosovës, se pavarësisht vështirësive financiare, do të jetësohet rritja e pagave për mësimdhënësit kosovarë.

Kryetari Xhabir Zharku me këtë rast i ka dhuruar ministrit Buja një pikturë me motive nga shkolla e parë shqipe.



# Nderohen dëshmorët e rënë më 8 mars 1999

**8 mars.** Përfaqësues të institucioneve komunale kanë nderuar në përvjetorin e 12-të të rënies dëshmorët Murat Lika, Qani Luma, Raif Koraçi dhe Osman Luma. Me këtë rast nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, përfaqësues të OVL-UÇK-së dega në Kaçanik, bashkëluftëtarë e familjarë të dëshmorëve dhe përfaqësues të fshatit Ivajë kanë vendosur kurora lulesh pranë lapidarit, në vendin e rënies, të këtyre dëshmorëve në fshatin Ivajë.



# Pesë aplikues për një regjistrues

**9 mars.** Konkursi për aplikim për një vend pune të regjistruesit të popullsisë në Kaçanik ka përfunduar, ndërsa interesimi për t'u bërë pjesë e këtij projekti është mjaft evidentë. Në përmbyllje të këtij konkursi ka rezultuar se 482 aplikues i kanë dorëzuar kërkesat e tyre për 94 vende të lira pune për regjistrimin e popullsisë së komunës së Kaçanikut. Komisioni përzgjedhës është përcaktuar që në testin pranues në listën e ngushtë janë përfshirë 185 konkurrues. Nga fundi i muajit të kaluar janë pranuar 18 kontrollues të procesit të regjistrimit, për të cilët do të jenë me kontratë pune prej 10 marsit deri më 25 prill 2011. Procesi i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është paraparë të zhvillohet nga 1 deri më 15 prill të këtij viti.



# Marrëveshje DAK – "Sporti pa Kufij"

**9 mars.** Drejtorisë e Arsimit dhe Kulturës ka firmosur një marrëveshje partneriteti me organizatën joqeveritare "Sporti pa Kufij" (Sport Sans Frontieres). Në emër të DAK-ut marrëveshja është firmosur drejtori z. Azem Guri, ndërsa për "Sportin pa Kufij" znj. Aurelie Viard, shefe e misionit. Marrëveshja synon zhvillimin e edukimit joformal dhe përmirësimin e dialogut ndëretnik për të rinjtë dhe fëmijët përmes krijimit dhe trajnimit të një rrjeti multietnik të vullnetarëve të rinj, të cilët zbatojnë sportin dhe aktivitetet sportive në mënyrë të hapur dhe me mundësi qasjeje për të gjithë fëmijët. Projekti zbatohet në partneritet me MKRS-në, dhe me një qendër rinore apo një OJQ rinore si dhe me DAK-në.



# Caritasi i Luxemburgut ndihmon shkollat e komunës tonë

**10 mars.** Drejtori i Arsimit dhe Kulturës, z. Azem Guri dhe përfaqësuesja e Caritasit të Luksemburgut, znj. Valbona Rexhepi, kanë firmosur realizimin e 14 projekte të përzgjedhura. Në takimin e sotëm, në të cilin merrnin pjesë e dhe drejtorët e shkollave, është përcaktuar që të realizohet nga një projekt më prioritar në vlerë nga 3 mijë euro për secilën nga 14 shkollat e komunës tonë.

Projektet e përzgjedhura kanë të bëjnë kryesisht me furnizimin e bibliotekave me pajisje dhe literaturë shkollore, furnizimi i shkollave me mjete konkretizimi, inventar shkollor etj.



# QKMF-ja i bën surprizë dr. Mary Packerit

**11 mars.** Qendra Kryesore e Mjekësisë familjare "Dëshmoret e Lirisë" i ka bërë një surprizë dr. Mary Packer, për punën dhe kontributit që ajo e ka dhënë për shtatzënat dhe fëmijët e porsalindur në komunën tonë. Në prani të stafit të QKMF-së dhe drejtuesve të institucioneve shëndetësore, dr. Packerit, mjeke e njohur nga Anglia e cila qe 10 vite është duke kontribuar në këtë lëmi në Kosovë, i është vendosur një fotografi në sallën e ligjëratave të kësaj qendre, në shenjë respekti e kujtimi për kontributin e saj në lëmin e shëndetësisë së Kaçanikut. Fotografinë e kanë vendosur dr. Ekrem Dullovi, drejtor i QKMF-së dhe Kadrije Piliçi-Berisha, koordinatore e OJQ-së "Lidhja e Gjallë e Kosovës", implementuese e projektit të trajnimit dymujor për kujdesin ndaj shtatzënave dhe fëmijëve të porsalindur.



## Rreth 200 konkurrentë për 70 mijë euro

**14 mars.** Është përmbyllur konkursi i konkurrimit për grantin e Bankës Botërore, në vlerë 70 mijë euro, për të cilin kanë konkurruar rreth 200 palë të interesuara. Për këtë grant aplikacionet i kanë dorëzuar 180 pronarë firmash të vogla e të mesme apo pretendentë për themelimin e bizneseve të reja. Implementues i këtij projekti është Fondi i pavarur për zhvillimin e komunitetit – CDF. Nga ky grant do të përfitojnë ata konkurrues të cilët paraqesin projekte serioze, ndërsa granti parasheh pagesën e makinerive dhe mjeteve të punës. Gjenerimi i punësimit, qëndrueshmëria e biznesit, ofrimi i punës së vazhdueshme, dëshmia për zhvillim potencial të biznesit të ri, participimi me 20 për qind të vlerës së projektit, janë disa nga kriteret e projektit: "Përfshirja sociale dhe zhvillimi lokal", i cili do të zgjasë deri në vitin 2014.

## Komuna reagon ndaj arrestimeve të ish-pjesëtarëve të UÇK-së

**17 mars.** Ekzekutivi dhe Legjislativi i Komunës kanë reaguar ndaj arrestimit të fundit të pjesëtarëve të UÇK-së nga policia e EULEX-it, ndërsa këto arrestimet i kanë vlerësuar si në funksion të njollosjes së luftës së pastër të UÇK-së. Kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku, ka thënë se arrestimet janë edhe një spektakël i EULEX-it, i cili bashkë me ato të mëparshmet, po krijojnë shqetësim dhe tensione të panevojshme në mesin e qytetarëve, jo vetëm të komunës tonë. Kryetari i Komunës e ka cilësuar z. Fatmir Limaj si njërin nga personalitetet që ka dhënë shumë gjatë luftës dhe pas saj, e i cili është liruar nga organi më i lartë ndërkombëtar i drejtësisë- Tribunali i Hagës, ndërsa tash përsëri akuzohet. Ky është një rast i papresedant dhe ka për qëllim komprometimin e autoritetit të tij, të cilin nuk mundën ta mposhtin edhe pas shumë akuzave të ulëta. Ndaj arrestimit të ish-pjesëtarëve të UÇK-së ka reaguar edhe z. Xhelal Gashi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut.

# Prezantohet faza e parë e PRrU-së për zonën e parë të qytetit

**18 mars.** Grupi punues për hartimin e Planit Rregullues Urban për zonën e parë të qytetit të Kaçanikut ka zhvilluar një takim pune ku kanë marr pjesë edhe znj. Ermira Salihu dhe z. Mentor Rexhepi, zyrtar nga LOGOS-i, si dhe Dritan Shutina, konsulent i jashtëm nga LOGOS. Gjendjen aktuale me të dhënat karakteristike si dhe infrastrukturën fizike ekzistuese në këtë zonë e ka prezantuar Edmond Mjaku, zyrtar komunal, njëherësh anëtar i Grupit Punues për hartimin e Planit Rregullues Urban për zonën e parë të qytetit. Ai i ka paraqitur detajet e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik, rrugët, objektet e banimit, objektet afariste, hartat gjeologjike, hartat pedologjike etj. Ky plan do të realizohet për 10-12 muajt e ardhshëm. Në fazën e parë përfshihet Zona e parë e qytetit, që përkufizohet prej rrugës "Emin Duraku" dhe përfshin hapësirën mbi rrugën "Skënderbeu" dhe në gjatësinë prej Xhamisë së Qytetit deri te Shtëpia e Kulturës "Xheladin Kurtaj". Projekti Zvicër-Kosovë "Përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim" – LOGOS, është projekt i financuar nga Qeveria Zvicerane, ndërsa realizohet nga Fondacioni Zviceran INTERCOOPERATION.



# Tryezë për prokurimin

**18 mars.** OJQ INPO ka organizuar një debat në Kaçanik, në të cilin është diskutuar për sfidat dhe pengesat me të cilat përballet prokurimi publik dhe praktikat e shpenzimit të fondeve publike. Në këtë debat ka marrë pjesë edhe Abdyl Limani, zyrtar i lartë i Komisionit Rregullues të Prokurimit Publik. Ai ka vlerësuar me këtë rast se Zyrat e prokurimit duhet të jenë plotësisht të pavarura në kryerjen e punëve të tyre. Izahir Kuka, zyrtar i prokurimit në Kaçanik, u ka thënë zyrtarëve të lartë të KRPP-së dhe OJQ-ve se zyrtarët e prokurimit në komunën tonë e kanë autonominë e kryerjes së punës së tyre dhe se zyrtarët e ZP-së nuk kanë pasur asnjë presion nga jashtë për të ndikuar në shkeljen e procedurave të prokurimit. Këtë debat e ka mbështetur "The Balkan Trust for Democracy".

# USAID-i dhe Komuna financojnë shkollën e Nikajve

**22 mars.** Falë një donacioni të USAID-it dhe bashkëfinancimit të Komunës, në fshatin Nikaj ka nisur ndërtimi i aneksit të shkollës së këtij fshati. Gurin themeltar të këtij objekti e kanë vendosur kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe z. Faik Guri, babai i dëshmorit Feriz Guri- komandant Shpata. Kryetari Zharku me këtë rast ka përgëzuar nxënësit, mësimdhënësit dhe banorët për këtë projekt, duke uruar që kjo shkollë të jetë një vatër e fuqishme e



diturisë. Ky projekt realizohet me bashkëfinancim të Bankës Botërore (80,000 euro) dhe Komunës (44,000). Implementuese e këtij projekti është "CHF International". Aneksi i objektit të shkollës së fshatit Nikaj, e cila është

paralele e ndarë fizike e SHFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec, do t'i ketë 3 dhoma mësimi, nyjat sanitare dhe hapësirën e ngrohjeve qendrore. Aneksi përmban hapësirën prej 360 $m^2$.

## Protestohet kundër arrestimit të çlirimtarëve



**23 mars.** Edhe në komunën e Kaçanikut është protestuar kundër arrestimit të nëntë ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Qindra qytetarë janë tubuar në afërsi të Stacionit Policor, duke kërkuar lirimin nga burgjet e të gjithë çlirimtarëve. Protestuesit kanë mbajtur në duar pankarta, nëpërmjet të cilave përcillnin mesazhe se lufta e UÇK-së ka qenë plotësisht e drejtë dhe e pastër, ndërsa arrestimin e luftëtarëve të lirisë e kanë cilësuar si të motivuar politikisht. Në emër të shoqatave të dala nga lufta, protestuesve u është drejtuar z. Ejup Runjeva, kryetar i degës së OVL-së në Kaçanik. Ai ka porositur Kuvendin e Kosovës që ta miratojë ligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës.

## Komuna e qon Serbinë në gjyqin ndërkombëtar

**24 mars.** Në të njëjtën ditë kur, para 12 vitesh filluan sulmet ajrore të NATO-s kundër caqeve ushtarake e policore serbe në Kosovë, Komuna e Kaçanikut ka vendosur që ta vejë në peshoren e drejtësisë shtetin serb, për krimet e kryera në territorin e komunës tonë gjatë periudhës së luftës 1998-1999. Për t'i nisur këto procedura ekzekutivi lokal ia ka adresuar një

propozim Kuvendit Komunal, që të formojë një komision i cili do të grumbullojë fakte për ngritjen e padisë për krimet njerëzore dhe materiale-ekonomike në komunën e Kaçanikut, të cilat i ka kryer pushteti serb i asaj kohe. Komisioni do të përbëhet nga përfaqësues të legjislativit, ekzekutivi dhe shoqërisë civile. Propozimin në emër të ekzekutivit e ka bërë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku. Para se të ushtrojë padinë kundër Serbisë, komisioni për punën e vet do t'i raportojë KK-së.



## Përkujtohen të rënët e Kotlinës

**24 mars.** Me një manifestim përkujtimor të mbajtur në fshatin Kotlinë, janë përkujtuar në 12-vjetorin e rënies 11 dëshmorë dhe 15 martirë të këtij fshati. Në përshëndetje të pjesëmarrësve të këtij tubimi, nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, është shprehur se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe dëshmorët sollën lirinë e vendit. Ai vlerësoi se lufta e UÇK-së ka qenë plotësisht e pastër, ndërsa i ka kundërshtuar arrestimet e pjesëtarëve të saj nga organet e EULEX-it. Nënkryetari Loku ka apeluar te instancat më të larta të shtetit, që të mos lejojnë EULEX-in të nëpërkëmbë dhe njollosë luftën e

drejt të UÇK-së. Fjalën e rastit e ka mbajtur z. Avni Kuçi, ndërsa në emër të familjeve të dëshmorëve, të pranishmit i ka përshëndetur z. Mustaf Loku.

Më 24 mars të vitit 1999, në Kotlinë ranë 11 dëshmorë dhe 15 martirë. Kotlinasit këtë ditë kanë përkujtuar edhe tre dëshmorë të rënë para dhe pas 24 marsit. Në nderim të të rënëve, nxënësit e shkollës fillore "Naim Frashëri" kanë shfaqur një program kulturor artistik, ndërkaq pranë lapidarit të të rënëve janë vendos kurora lule.




## Debat për regjistrimin e popullsisë

**25 mars.** Në Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj" është mbajtur debati publik me qytetarë për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Anëtarët e Komisionit Komunal për regjistrimin e popullsisë ofruan të dhëna dhe informata lidhur me këtë proces, duke e vlerësuar atë si shumë të rëndësishëm. Anëtari i KKR-së, z. Azem Guri, ka thënë se ky debat publik është në funksion të informimit dhe sensibilizimit të qytetarëve për procesin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Një ekip nga niveli qendror ka qëndrua një ditë në komunën tonë ku zhvilloi një

fushatë sensibilizuese ndërkohë që është mbajtur edhe një debat me qytetarët e fshatit Begracë. Në këtë debat të pranishmit shtruan shumë çështje lidhur me këtë proces, ndërsa ndër pyetjet e shtruara ishte ajo se si do të regjistrohen mërgimtarët dhe fëmijët e lindur jashtë vendit.

## Nis zbatimi i Planit inspektues i transportit rrugor

**25 mars.** Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka nisur zbatimin e Planit operativ për inspektimin e transportit rrugor në komunën tonë. Sipas drejtorit të këtij dikasteri, z. Rushan Ceka, ky plan është duke u zbatuar nga inspektori i komunikacionit z. Besim Sallahu, ndërsa është duke asistuar Policia e Kosovës në Kaçanik. Zbatimi i këtij plani ka për qëllim ndalimin e veprimtarisë ilegale të transportit të udhëtarëve dhe mallrave, eliminimin e parkingjeve ilegale në rrugët e qytetit, parandalimin e lëvizjes së automjeteve me shpejtësi të palejuar nëpër rrugët lokale si dhe ngritjen e performancës në transportin publik të udhëtarëve.



# Aprovohet puna e Ekzekutivit për vitin 2010

**30 mars.** Kuvendi i Komunës ka mbajtur seancën e tretë të rregullt, ndërsa ka shqyrtuar she dhe miratuar Raportin e punës së ekzekutivit për vitin 2010. Sipas këtij raporti, aktivitetet kyçe të Ekzekutivit të Komunës gjatë periudhës njëvjeçare: koordinimi i punëve me drejtorët e drejtorive, shtimi i efikasitetit dhe cilësisë në punë, ushtrimi i përgjegjësive dhe menaxhimit në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e komunës dhe në pajtueshmëri me Statutin dhe Rregulloret e punës, ofrimin e kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, koordinimi i aktiviteteve me donatorë të brendshëm dhe të jashtëm, përcjellja e realizimit të projekteve, plotësimin e të gjitha nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësive nga autoritetet lokale sa më afër qytetarëve, bashkëpunimi ndër komunal, bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës, bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, shënimi i përvjetorëve të betejave dhe rënies së dëshmorëve, etj.



Në këtë seancë është paraqitur edhe Plani i punës së Ekzekutivit për vitin 2011.

KK-ja ka aprovuar propozimin e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku, për formimin e Komisionit Komunal për grumbullimin e provave materiale dhe fakteve e argumenteve për ngritjen e padisë kundër Serbisë, për të gjitha krimet e kryera në territorin e komunës së Kaçanikut, gjatë periudhës prej

vitit 1998 deri më 20 qershor 1999. Komisioni do të përbëhet nga Ekzekutivi, Legjislativi dhe shoqëria civile.

## SHMP-ja me kamera vëzhguese

**30 mars.** Në Shkollën e Mesme Profesionale "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka" janë instaluar kamerat vëzhguese, projekt i cili është financuar nga Caritasi i Luxemburgut. Kamerat janë vendosur në funksion të përmirësimit të disiplinës së përgjithshme të nxënësve në shkollë dhe për ndikimin në respektimin e orarit të punës nga stafi i kësaj shkolle.



# PRILL 2011

## Nis regjistrimi i popullsisë

**1 prill**. Edhe në komunën tonë ka filluar regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Regjistruesit e popullsisë janë nisur nëpër qarqet e regjistrimit dhe se deri tani çdo gjë ka qenë në rregull dhe nuk ka pasur asnjë problem. Në komunën e Kaçanikut janë caktuar 85 qarqe të regjistrimit. Për ta kryer këtë proces janë përzgjedhur 18 kontrollues të regjistrimit dhe 94 regjistrues, prej tyre nëntë janë rezervë.

## NKMDLNj-ja ia dhuron Komunës monografinë e luftës

**1 prill**. Nënkëshilli i Mbrojtjes së të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Kaçanik, ia ka ndarë Komunës monografinë për krimet e luftës të cilat i kanë kryer forcat ushtarake e policore serbe në Kosovë gjatë viteve 1998 – 1999. Këtë libër kryetari i NKMDLJN-së ia ka dhuruar solemnisht kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku. Kryetari Zharku e ka çmuar lartë punën e NKMDLNJ-së këshillit në nivel vendi, ndërsa ka vlerësuar se vetëm faktet e dokumentuara për krimet e bëra ndaj popullit tonë do të mund të zbardhin ngjarjet tragjike që kanë ndodhur në Kosovë gjatë kësaj periudhe dhe është shumë e rëndësishme që tani në këtë përmbledhje faktografike janë pasqyruar të dhëna të sakta dhe dokumentuara, që tregojnë sakrificën e popullit tonë për liri.
Sipas z. Shemsedin Abazi, në këtë monografi janë prezantuar edhe krimet serbe të luftës në komunën e Kaçanikut, nëpërmjet deklaratave të dëshmitarëve dhe provave materiale. Gjatë luftës në komunën e Kaçanikut janë vrarë 138 civil ndërsa 6 të tjerë evidentohen të zhdukur. Monografia

është hartuar nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të njeriut në Prishtinë.



## CDF mbështet 24 biznese në komunën e Kaçanikut

**6 prill.** Fondi për Zhvillimin e Komuniteteve (CDF) ka përzgjedhur 24 biznese të cilët kanë aplikuar për grantin e kësaj organizate, në vlerë deri në 10 mijë euro. Për të përfituar nga ky grant kanë aplikuar 180 subjekte afariste nga komuna jonë. Bizneset e kualifikuara për këtë grant kanë kaluar fazën e parë, ndërsa tani në fazën e dytë do të bëhet vizitë në terren për të verifikuar kriteret të cilat duhet t'i plotësojnë bizneset për të qenë përfitues të grantit. Nga 24 bizneset e përzgjedhura, 5 janë biznese të reja dhe 19 prej tyre janë biznese ekzistuese. Ky grand është në kuadër të projektit trevjeçar të CDF-së: "Përfshirja sociale dhe zhvillimi lokal", i cili mbështetë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

# Formohet komisioni për ngritjen e padisë ndaj Serbisë

**6 prill**. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 të Statutit të Komunës dhe vendimit të Kuvendit të Komunës, nr. 16-2355/11, ka marrë vendim për për formimin e komisionit komunal për grumbullimin e materialeve faktografike dhe ngritjen e padisë kundër Republikës së Serbisë për dëmet e luftës për periudhën 1998-1999. Sipas vendimit, ky komision do të përfaqësohet nga: z. Heset Loku, nënkryetar i Komunës, z. Xhelal Gashi, kryesues i Kuvendit Komunal, z. Zekirja Loku, znj. Florjeta Gashi dhe znj. Sevdije Frangu, anëtarë të KK-së dhe znj. Hafide Kuka e z. Shemsedin Abazi nga shoqëria civile.



# MKRS, GIZ dhe Komuna mbështesin KRVL-në

**7 prill.** Drejtori i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, z. Azem Guri dhe koordinatori për Rini, z. Fatmir Çaka, kanë realizuar një takim me Vedat Jasharin, zyrtar për çështje të rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), znj. Donika Gashi, zyrtare në këtë ministri dhe Albana Koshi, zyrtare për koordinim me sektorin e rinisë nga GIZ. Ky takim kishte për qëllim gjetjen e mundësive të MKRS-së, GTZ-së dhe Komunës për mbështetjen e Këshillit Rinor për Veprim Lokal të Kaçanikut. KRVL-ja ka hartuar një plan veprimi, i cili do të miratohet në Kuvendin e Komunës,

ndërkaq që aktivitetet e planifikuara do të mbështeten nga tri komponentët e sipërpërmendura.

## Denoncohet ryshfetdhënësi

**8 prill.** Qytetari Sh. Sh. nga fshati Begracë, është arrestuar nga policia pasi ka tentuar t'i japë ryshfet drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Bekim Troni. Tentuesi për të dhënë ryshfet të monedhave euro, është denoncuar në polici nga z. Troni. Ai kishte tentuar t’i ofrojë të holla për t’i lejuar ndërtimin e një objekti afaristë në Begracë. Drejtori Troni e ka ftuar policinë në prezencë të tentuesit për mitdhënie dhe policia e ka arrestuar të dyshuarin. Ky denoncim është bërë publik në një konferencë për gazetarë.

## Një milion euro nga tatimi në pronë

**8 prill.** Arkëtimi i të hyrave nga tatimi në pronë ka shënuar shifrën 1,000.000. Nga viti 2002, qëkur ka filluar aplikimi i mbledhjes së kësaj takse e këtej, në arkën e Komunës janë arkëtuar gjithsej 1,002.490 euro. Të hyrat nga ky tatim destinohen për realizimin e projekteve kapitale.



# Përkujtohen dëshmorët dhe martirët e 9 Prillit

**9 prill.** Faruk Dogani, Jehona Raka dhe Nevzat Çallaku janë emra të tre nga 28 dëshmorët e rënë më 9 prill 1999, në betejën e përgjakshme në Rakoc. Ditën kur u flijuan për lirinë e Kosovës, Faruku dhe Nevzati ishin 31 vjeç, ndërsa Jehona 23 vjeçe. Emrat e këtyre dëshmorëve i kanë trashëguar mbesa dhe nipër të tyre. Sikur u rreshtuan në radhët e UÇK-së në luftën për liri, ashtu ranë dëshmorë në të njëjtën ditë, në mbrojtje të atdheut. Tre



trashëgimtarët e emrave të tyre, Faruku 11 vjeç, Jehona 5 vjeçe dhe Nevzati 8 vjeç, janë përkulur para pllakës përkujtimore në Rakoc, duke vendosur lule të freskëta në memorialin e axhallarëve dhe hallës dëshmore. Janë përkulur për t'i nderuar edhe dëshmorët tjerë dhe të martirizuarit e 9 Prillit, ditës së njërës nga betejat më të përgjakshme të luftës në komunën tonë. Për t'i nderuar në 12-vjetorin e rënies së 28 dëshmorëve dhe 32 martirëve, në Rakoc dhe Lagje të Re të qytetit janë mbajtur tubime përkujtimore. Një fjalë rasti në Lagje të Re e ka mbajtur z. Nejazi Zharku, bashkëluftëtar i të rënëve,

ndërsa në Rakoc, z. Arben Fera. Në emër të Komunës, të pranishmit i kanë përshëndetur z. Fikri Vërbani e z. Rushan Ceka, drejtorë komunalë. Pranë lapidarit të dëshmorëve dhe martirëve, kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku me stafin e tij dhe përfaqësues të OVL të UÇK-së kanë vendosur kurora lulesh, ndërsa më pas janë bërë homazhe Varrezave të Dëshmorëve dhe janë vendosur kurora lulesh pranë memorialit të ngritur për dëshmorët. Për nder të kësaj dite përkujtimore janë zhvilluar edhe aktivitete kulturore e sportive. Aktivitetet në përkujtim të 9 Prillit janë organizuar nën përkujdesen e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku.

## Në Komunë nuk shkelen të drejtave e njeriut

**12 prill.** Përfaqësues të zyrës së Avokatit të Popullit kanë qëndruar në Administratën komunale të komunës tonë, ndërsa qëllimi i kësaj vizite është hulumtimi i ndonjë rasti eventual i shkelje e të drejtave të njeriut apo keqpërdorim i pushtetit ndaj qytetarëve ana e institucioneve komunale. Drejtori i Administratës Komunale, z. Jeton Topalli dhe koordinatori i Njësisë për të Drejtat e Njeriut, z. Vedat Dema, kanë konstatuar para zyrtarëve të Avokatit të Popullit z. Faton Morina dhe z. Tafil Rrahmani, se nuk është evidencuar ndonjë shkelje e të drejtave të njeriut në Komunë. Lidhur me qëllimin e qëndrimit në komunën tonë, z. Morina ka thënë se ka të bëjë me koordinimin e aktiviteteve për të adresuar të drejtat e njeriut apo keqpërdorimet e autorizimeve nga autoritetet publike dhe ofrimin e shërbimeve juridike dhe avokim publik.

## Kaçaniku ka 33 mijë banorë, pa mërgimtarët

**17 prill.** Në procesin e regjistrimit të popullsisë, sipas shifrave preliminare, janë regjistruar rreth 33 mijë qytetarë të komunës së Kaçanikut, e që mendohet të jetë edhe numri i tërësishëm i banorëve rezidentë të përhershëm. Në këtë shifër nuk janë përfshirë qytetarët me qëndrim të përkohshëm jashtë vendit. Procesi i regjistrimit ka përfunduar dhe nuk ka mbetur asnjë banor pa u vënë në formularët e regjistrimit. Sipas zëdhënësit të Komisionit komunal të regjistrimit, z. Azem Guri, të gjithë të regjistruarit

janë me përkatësi etnike shqiptare. Zëdhënësi Guri ka thënë se me shifrat e sakta të banorëve të regjistruar do të dilet në muajin qershor.



## KFOR-i dhe Komuna vlerësojnë gjendjen e sigurisë

**18 prill.** KFOR-i ka vlerësuar se situata e sigurisë në komunën tonë është e mirë. Në një takim me nënkryetarin e Komunës, z. Heset Loku, togeri Raymond Pierce, përgjegjës i Zyrës për Monitorim dhe Ndërlidhje (LMT) në Kaçanik, e ka vlerësuar gjendjen si të mirë dhe ka artikuluar kënaqësinë e tij që i është dhënë rasti të punoj me njerëzit e kësaj komune. Edhe nënkryetari Loku është pajtuar me konstatimin e mysafirit se gjendja në rrafshin e sigurisë në komunën e Kaçanikut vazhdon të jetë e mirë. Në takim folur edhe për gjendjen në rrafshin socio-ekonomik dhe kapacitetet zhvillimore të komunës, me theks të veçantë për sektorin e bujqësisë.



# Shënohet Dita e Tokës

**22 prill.** Për nderë të Ditës së Tokës është organizuar aksion për pastrimin e ambientit dhe janë zhvilluar aktivitete të ndryshme kulturore sportive. Për ta trajtuar rëndësinë e natyrës dhe ambientit të pastër, të gjitha shkollat e komunës i kanë kushtuar një orë mësimi, ndërsa më pas kanë vazhduar me



pastrimin e ambientit përreth objekteve shkollore dhe rrugëve. Krahas pastrimit të hapësirave publike, Grupi i Ambientalistëve të Rinj kanë bërë shpërndarjen e fletushkave, ndërsa kompania "Pastërtia" ka bërë pastrimin e disa deponive ilegale. Aktivitetet janë mbështetur nga DAK-ja, Qendra Rinore dhe Pro Credit Bank.

# Rrugët e fshatrave me emërtime

**28 prill.** Për herë të parë edhe rrugët e fshatrave të komunës tonë do t'i kenë emrat e tyre. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka marrë vendim që t'ia adresojë organeve të legjislativit propozimin për nisjen e procedurave për emërtimin e rrugëve lokale. Ky propozim fillimisht i është dërguar

Komitetit për Politikë dhe Financa, për ta formuar një komision i cili do të merret me këtë çështje. Në seancën e Kuvendit Komunal, më 28 prill, i është dhënë viza formimit të komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale të komunës tonë. Kryesuesi i KK-së, z. Xhelal Gashi, këtë çështje e ka vlerësuar si ndër më të rëndësishmet aktualisht në këtë komunë. Për shkak të rëndësisë dhe ndjeshmërisë së kësaj çështje, në seancë është apeluar që ky komision të mos politizohet dhe se emërtimet të përfshijnë të gjitha periudhat e historisë kombëtare. Anëtar të këtij komisioni janë zgjedhur: z. Ramadush Osmanit (PDK), znj. Sevdie Frangu (AAK), z. Ibrahim Hoxha (LDK), znj. Sherife Troni (AKR), z. Rushan Ceka, drejtor i Shërbimeve Publike, z. Fatos Koxha, zyrtar i Urbanizmit dhe z. Ejup Runjeva (OVL e UÇK-së). Për faktin se emërtimet ekzistuese janë të stërvjetëruara dhe nuk përkojnë me historinë tonë më të re, ka gjasa që të ketë edhe riemërtime të disa rrugëve në qytet.



# MAJ 2011

## Kaçaniku shënoi jubileun e 20-të të Demonstratave ‘81

**5 maj.** Oborri i gjimnazit “Skënderbeu” në Kaçanik ishte nikoqir i shokëve dhe shoqeve të idealit për Republikën e Kosovës. Në të njëjtin vend, por 30 vjet pas, organizatorë të demonstratës së 5 majit ‘81, ish-maturantë, ish-mësimdhënës, të shoqëruar edhe nga brezi i tanishëm i këtij gjimnazi, kanë improvizuar marshimin e demonstrimit të kërkesave të atëhershme për Kosovën Republikë. Ish-demonstrues të asaj kohe, përfshirë edhe të burgosurit politik, kanë nisur marshimin nga gjimnazi “Skënderbeu”, duke kënduar këngën “Kaçanik, shkëmb e gur” dhe duke brohoritur parullat: “Republikë-Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë”, “Lironi shokët”..., parulla të



cilat ishin artikuluar në demonstratat popullore në Kosovë, më 1981. Masa e tubuar ka vazhduar me improvizimin duke ecur nëpër rrugët e qytetit dhe duke përshkuar pikat e marshimit të para 30 vjetëve. Para nisjes së marshimit, në objektin e gjimnazit "Skënderbeu", është shpalosur pllaka përkujtimore me mbishkrimin: " '81, Kosova Republikë - Nga kjo shkollë u nis demonstrata e 5 majit 1981". Këtë pllakë e kanë zbuluar z. Hysen Shurdhani e znj. Mihane Hasani-Buzhala, pjesëmarrës të demonstratës së 5 majit '81 dhe z. Xhabir Zharku, kryetar i Komunës së Kaçanikut, të cilët iu drejtuan me disa fjalë pjesëmarrësve të këtij përvjetori jubilar, përkitazi me rëndësinë e veprimtarisë së asaj kohe. Për nder të këtij përvjetori janë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve, ndërsa në orët e mbrëmjes është mbajtur një akademi përkujtimore dhe është hapur një ekspozitë tematike kushtuar demonstratave të vitit 1981. Në një fjalë përshëndetëse kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, tha se Kaçaniku në të gjitha periudhat e rezistencës kombëtare ka pasur burra, trima e atdhetar që i dolën zot këtij vendi, që nga Idriz Seferi, Avdyl Dura, Din Hoxha, Sali Bajra, Agim Bajrami etj. Kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku me Mirënjohje ka nderuar të gjithë pjesëmarrësit e demonstrative të vitit 1981, të cilët në forma të ndryshme pësuan nga pushteti i atëhershëm.

## Fermerët ndihmohen me 60 mijë euro

**10 maj.** Komuna ka vendosur që nga buxheti i vet t'i ndihmojë fermerët e komunës tonë, kryesisht me ndihma në sektorin e blegtorisë dhe perimekulturës. Për këtë qëllim janë ndarë rreth 60 mijë euro për investime në ndërtimin e serrave dhe për aparate për mjeljen e lopëve. Do të ndërtohen 10 sera me sipërfaqe secila nga 2.5 ari, në vlerë të tërësishme 37 mijë euro, si dhe do t'u shpërndahen më shumë se 50 aparate për mjeljen e lopëve, në vlerë më shumë se 20 mijë euro. Përfitues të serave mund të jenë aplikuesit me projekte serioze, ndërsa për makina elektrike të mjeljes së lopëve ata që kanë pesë e më shumë lopë qumështore.

# Kryetari Zharku ka pranuar Posterin e Zotimit

**11 maj.** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka pranuar Posterin e Zotimit, poster i cili konfirmon përkushtimin e Komunës për ngritjen e kapaciteteve organizative dhe individuale drejt parimeve të Qeverisjes së Mirë, sundimit të ligjit, transparencës, llogaridhënies, efikasitetit, përgjegjshmërisë dhe pjesëmarrjes si dhe shprehjes së gatishmërisë për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve të cilat përmbushin nevojat dhe pritjet e qytetarëve drejt zhvillimit proaktiv ekonomik lokal. PZ-në kryetarit Zharku ia ka dorëzuar z. Sali Salihu, zyrtar për qeverisje lokale në programin Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI). Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në ndërkohë ka themeluar Ekipin për përmirësimin e organizatës komunale (EPOK), i cili përbëhet nga drejtorët e drejtorive dhe zyrtarë komunalë. Në fillim të muajit të kaluar është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit në mes USAID-it dhe komunës tonë për programin Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive.



# Inspektorët ndalojnë ndërtimet pa leje

**11 maj.** Inspektorët komunalë të ndërtimit janë duke ndaluar ndërtimin e objekteve, para se pronarët e tyre të kenë marrë lejen përkatëse. Disa objekteve u janë vendosur shiritat që ndalojnë realizimin e punimeve. Sipas z. Afrim Fuga, inspektor i ndërtimit, punimet i janë ndërprerë tre ndërtimeve pa leje në Kaçanik të Vjetër dhe një mbindërtim pa leje skaj magjistrales Kaçanik-Ferizaj. Drejtues të Urbanizmit këtë punë e vlerësojnë të jetë në funksion të respektimit të planit zhvillimor komunal. Ndërkaq sipas z. Bekim Troni, drejtor i Urbanizmit..., pothuaj menjëherë pas vendosjes së shiritave ndalues të ndërtimit, palët kanë ardhur në Komunë për të kërkuar leje ndërtimi. Fluksi më i madh i këtyre ndërtimeve është në Kaçanik të Vjetër, ndërsa ato objekte që janë ndërtuar jashtë rregullores së planifikimit urban, do të rrënohen.

# LOGOS-i ndihmon hartimin e Rregullores së bashkëpunimit

**13 maj.** Projekti Zvicër-Kosovë: “Përkrahja për qeverisje lokale dhe decentralizim” – LOGOS, është duke e mbështetur hartimin e Rregullores për



bashkëpunim ndërmjet Komunës dhe fshatrave e lagjeve urbane të qytetit. Kjo mbështetje është konfirmuar në një takim ndërmjet përfaqësuesit të kësaj organizate, z. Pascal Fenderich, me nënkryetarin e Komunës z. Heset Loku. Sipas këtij projekti, Komuna do ta formojë Grupin punues për hartimin e kësaj rregullore, ndërsa drafti i saj do të prezantohet në diskutim publik, e pastaj do të miratohet në Kuvendin e Komunës. Nënkryetari Loku ka thënë me këtë rast se ky grup punues do të formohet shumë shpejtë dhe sqaroi se secili lokalitet ka të zgjedhur përfaqësuesin e vet, i cili punon në baza vullnetare.

## Përkujtohet Komandant Bardhi

**14 maj.** Me një akademi përkujtimore të mbajtur në Pallatin e Kulturës në Kaçanik është përkujtuar në 12-vjetorin e rënies dëshmori Qamil Ilazi - Komandant Bardhi, ish- komandant i Brigadës 162 të UÇK-së "Agim Bajrami". Për jetën dhe veprën atdhetare të Komandant Bardhit ka folur z. Osman



Krasniqi, i cili meritat për lirinë që po e gëzojmë sot dhe historinë tonë më të re ia ka atribuuar gjakut të dëshmorëve, si komandanti i përkujtuar 12 vjet pas rënies në altarin e lirisë. Akademinë e kanë përshëndetur z. Heset Loku, nënkryetar Komune, z. Hajrush Kurtaj, ish-zëvendëskomandant i Brigadës 162 "Agim Bajrami", z. Ejup Runjeva, kryetar i OVL të UÇK-së në Kaçanik dhe z. Nazmi Kuka, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve. Në emër të familjes së Komandant Bardhit, të pranishmit i ka falënderuar për pjesëmarrje z. Besim Ilazi, djali i dëshmorit Qamil Ilazi, ndërsa në fund është shfaqur një program i shkurtër artistik. Për nder të këtij përvjetori është shfaqur edhe dokumentari "Bardhësitë", i cili i kushtohej jetës dhe veprës së dëshmorit dhe komandantit Qamil Ilazi, i cili ra për liri më 14 maj 1999. Në lokacionin "Te Vestë" qytetarët kanë bërë nderime te pllaka përkujtimore në vendin e rënies së Komandant Bardhit dhe më pas të Varrezat e Dëshmorëve të komunës së Kaçanikut. Përkrah komandant Bardhit të njëjtën ditë ka rënë edhe dëshmori Selim Shehu. Të gjitha aktivitetet janë mbajtur nën patronazhin e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku.

## Barnatoret urdhërohen për kujdestari natën

**13 maj.** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, pas konsultimeve të bëra me drejtorët e Ekzekutivit Komunal, ka lëshuar Urdhëresën Administrative



përmes së cilës urdhërohen të gjithë pronarët e barnatoreve farmaceutike në territorin e komunës tonë, që të mbajnë kujdestarinë natën. Vendimi është në përputhje me nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 2, paragrafi 2.5 i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01—05-5318/10 për përcaktimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e komunës së Kaçanikut si dhe të neni 73 të Statutit të Komunës.
Urdhëresa është lëshuar në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe kërkesat e tyre për furnizim me barna gjatë orëve të natës.

## Ndalohet eksploatimi ilegal i rërës

**17 maj.** Komuna i ka paralajmëruar të gjithë eksploatuesit ilegalë të rërës se në qoftë se këtë veprimtari nuk e ndërpresin vetë, do t'ua konfiskojë rërën. Këtë vendim, me numër 16-4210/11, e ka marrë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku. Në vendim thuhet se: "Konfiskohet rëra e eksploatuar në mënyrë ilegale në lumenj dhe toka bujqësore në komunën e Kaçanikut. Z. Bekim Troni, drejtor i Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka sqaruar se ky vendim është marrë për të parandaluar shkaktimin e erozionit të tokës përreth urave të lumenjve dhe objekteve të tjera përreth tyre, ndërsa vendimi është bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, në atë të Ujërave të Kosovës dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.



# Njësisë për menaxhimin e mbeturinave Pastërtia i shtohet edhe një kamion

**20 maj.** Njësisë komunale për menaxhimin e mbeturinave "Pastërtia" në Kaçanik i është shtuar edhe një kamion për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave, ndërkaq është blerë nga mjetet e grantit qeveritar.
Çelësat e kamionit në mënyrë simbolike nënkryetarit të Komunës, z. Heset Loku, ia ka dorëzuar z. Gazmend Bytyqi, kryeshef i Kompanisë Regjionale me seli në Ferizaj.
Shefi i njësisë së KRMM "Pastërtia" në Kaçanik, z. Ferat Malsiu, ka thënë se me këtë investim janë krijuar mundësitë e përfshirjes në sistemin e menaxhimit të mbeturinave të lokaliteteve: Biçec, Kovaçec dhe Nikaj.



# KKSB rinis takimet e rregullta

**23 maj.** Pas rreth shtatë muajsh nga takimi i fundit, Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi ka nisur mbajtjen e takimeve të rregullta mujore. Ashtu siç ishte paralajmëruar javën e kaluar, kryetari i Komunës, Xhabir Zharku, i ka

dhënë fund zhbllokimit të këtij këshilli, i cili me vendimin e tij ishte pezulluar me arsyetim "të ftohjes së raporteve Komunë-polici". Në një prononcim javën e kaluar zyrtarë komunalë kanë thënë se kohën e fundit janë të kënaqur me efikasitetin e policisë në këtë komunë, duke dhënë sinjale dhe pohime se KKSB do të rifunksionalizohet. Në takimin e mbajtur të hënën,



ndryshe nga takimet e mëhershme të KKSB-së, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Imer Thaçi, shef i Divizionit për Siguri në Bashkësi (MPB), ka përgëzuar Komunën për vazhdimin e takimeve, ndërsa ka njoftuar për strategjinë e sigurisë në bashkësi, të cilën është duke e hartuar Departamenti për Siguri i MPB-së. Ndërkaq, lidhur me gjendjen e sigurisë në komunën e Kaçanikut, togeri Jaser Jaha, u.d. i komandantit të Stacionit Policor, ka vlerësuar se është e mirë. "Nuk ka pasur ndonjë rast i cili e ka rrezikuar sigurinë e përgjithshme", ka theksuar togeri Jaha.

## LOGOS ndihmon në shtrirjen e bazës së tatimit në pronë

**23 maj.** Komuna jonë është përfituese e projektit të LOGOS-it, për regjistrimin e pronave të paregjistruara të cilat do të ndihmojnë në shtrirjen

e bazës tatimore si dhe në ngritjen e shkallës së inaksimit të tatimit në prone. Ky projekt financohet nga Qeveria Zvicerane dhe implementohet nga Fondacioni i këtij shteti INTERCOOPERATION. Sipas z. Mentor Rexhepi, zyrtar i projekteve të këtij fondacioni zviceran, ky projekt përfshinë trajnime të specializuara të zyrtarëve të tatimit në pronë dhe mbështetjen me mjete logjistike të tyre për punë në terren në regjistrimin e pronave të paregjistruara. Me këtë përkrahje është vlerësuar se arkëtimi i të hyrave nga tatimi në palujtshmëri mund të shtohet për 20 deri në 30 për qind. Menaxheri i Zyrës së Tatimit në Pronë, z. Xhelal Dema, ndihma e ofruar nga LOGOS-i ka një rëndësi të madhe për komunën tone, sepse do të shtohen të hyrat vetjake të cilat janë nevojshme për realizimin e projekteve kapitale.

## Në Biçec shënohet 12 vjetori i Betejës së 25 Majit

**25 maj.** Me një manifestim përkujtimor të mbajtur në fshatin Biçec, është shënuar 12-vjetori i Betejës së 25 Majit, me ç'rast janë nderuar dëshmorët e lirisë dhe martirët e luftës, të cilët ranë në altarin e lirisë më 9 prill, përkatësisht 25 maj 1999, në fshatrat Bob, Kovaçec, Biçec, Nikaj, Lirishtë, Vataj e Soponicë.

Në këtë përvjetor në të cilin morën pjesë shumë qytetarë nga komuna jonë dhe më gjerë, janë përkujtuar dëshmorët: Fadil Bunjaku, Habit Dullovi, Fatmir Horuni, Nazmi Osmani, Avdulla Baftiu, Sadik Guri, Qemal Guri e Kemal Kolshi.



Në emër të këshillit organizues, një fjalë rasti e ka mbajtur z. Rufki Dullovi, ndërsa kanë përshëndetur z. Besim Ilazi, djali i dëshmorit Qamil Ilazi-komandant Bardhi, pastaj z. Vehbi Koraqi, veteran i luftës së UÇK-së dhe znj. Besarta Osmani, e bija e dëshmorit Nazmi Osmani. Me këtë rast është shfaqur edhe një program kulturor-artistik me këngë e valle interpretuar nga SHKA "Rrezet e Sharrit" dhe z. Milaim Mezini e znj. Njomza Mezini. Para se të fillojë ky tubim, te pllakat përkujtimore në vendin e rënies së dëshmorëve dhe viktimave civile dhe te Varrezat e Dëshmorëve janë bërë homazhe dhe janë vendosur lule te freskëta.

## Prezantohet raporti i buxhetit janar-mars

**27 maj.** Kuvendi Komunal e ka aprovuar raportin e shpenzimeve buxhetore për tremujorin e parë të këtij viti. Këtij raporti opozita i ka bërë vërejtje e kritika për aspektin e realizimit të të hyrave vetjake, por edhe shpenzimeve të realizuara gjatë kësaj pjese të vitit fiskal. Fillimisht z. Fikri Vërbani, drejtor i Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, i ka bërë një përmbledhje këtij raporti. Z. Vërbani ka thënë se të hyrat vetjake buxhetore në tremujorin e parë janë



realizuar në lartësinë 90.414 euro, ndërkohë që janë shpenzuar 512.753 euro ose 10 për qind e tërësisë së buxhetit të planifikuar për sivjet. Prej këtyre shpenzimeve, 448.262 euro kanë shkuar për paga e mëditje, pastaj për shërbime e mallra 50.251 euro, për shërbime komunale 11.792 euro, për subvencione e transfere 2.448 euro, përderisa nga 1.4 milion eurot e planifikuara për investime kapitale, ende nuk janë alokuar. Në këtë seancë është aprovuar edhe Plani i veprimit rinor lokal 2011-2013, plan ky i hartuar nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal dhe i mbështetur nga organizata gjermane GTZ. Ky plan është prezantuar nga z. Arlind Hysa, kryetar i KVRL-së.

## Komuna përfiton grantin e MPMS-së

**27 maj.** Komuna ka përfituar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale një grant në vlerë 67.497 euro, grant i cili do të shfrytëzohet për realizimin e projektit: “Largimi i mbeturinave nga deponitë ilegale dhe pastrimi i përroskave”. Ky projekt është në kuadër programit të punëve publike për gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e varfërisë.
Sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit projekti duhet të përfundoj para datës 31 dhjetor 2011, ndërsa 70 për qind e të punësuarve (në kohëzgjatje tre muaj) duhet të jenë punëkërkues në listat e Zyrës Komunale të Punësimit.

## Sporti përkrahet me 17 mijë euro

**30 maj.** Komuna ka ndarë 17 mijë euro për klubet sportive të komunës tonë, klube të cilat janë aktive dhe pjesëmarrëse në kampionatet përkatëse të Kosovës. Nga ky alokim më së shumti ka përfituar KF Lepenci, të cilit i janë ndarë 12 mijë euro, pastaj KH Lepencit 2 mijë euro, klubit Taekwondo “Shqiponja”- 1 mijë euro, ekipit të pingpongut “Kaçaniku” - 1 mijë euro dhe skuadrës së futbollit të femrave “Kaçanikasja” - 1 mijë euro”. Vendimin për ndarjen e këtyre mjeteve e ka marrë ekzekutivi i Komunës.

# Nis “Java e Mjedisit”

**30 maj.** Për nder të Ditës Botërore të Mjedisit, në komunën tonë kanë nisur një seri aktivitetesh vullnetare për përmirësimin e ambientit. Aktivitetet janë organizuar nga dikasteret kompetente të ekzekutivit (DUKMM dhe DSHPE) në bashkëpunim me Grupin e Ambientalisët e Rinj, KRMM “Pastërtia” njësia në Kaçanik, dhe NKP “Lypeteni. Ndër aktivitetet e parapara për shënimin e kësaj jave mjedisore janë: Debat për ambientin, pastrimi i ambientit në hapësirën e Kalasë së Qytetit, vizitë dhe fabrikave “Silcapor” dhe “New Lepenci” (ndotës të ambientit në komunën tonë), të cilave do t’u dërgohen mesazhe kundër ndotjes së ajrit dhe ujit, pastaj të rinjtë do të përhapin mesazhe pozitive për mbrojtjen e mjedisit nëpër të gjitha lagjet e qyteti, pastrimi i bulevardit “Ismail Raka” si dhe i dy deponive ilegale të mbeturinave te Shtëpia e Kulturës dhe afër urës mbi lumin Neredime, pastrami i Varrezave të Dëshmorëve, I rrugës “Emin Duraku”..., mbjellja e luleve dhe ca bredhave në vendin e deponive të pastruara të qytetit dhe vendosja e shenjave për ndalim të hedhjes së mbeturinave.



# QERSHOR 2011

## Hapet Qendra e Regjistrimit të Bizneseve

**2 qershor.** Në kuadër të themelimi i qendrave komunale të biznesit në Kosovë, edhe në komunën tonë është hapur ky shërbim për qytetarët. Nëpërmjet një donacioni të Bankës Botërore, Qendra për regjistrimin e biznesit është hapur në objektin e Administratës Komunale. Shiritin e përurimit të kësaj qendre e kanë prerë z. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe z. Mejdi Pllashniku, kryeshef i Agjencisë për Regjistrimin të Bizneseve. Hapja e kësaj qendre krijon lehtësira për qytetarët, e veçanërisht për komunitetin e biznesit dhe se tash e tutje qytetarët nuk kanë nevojë të udhëtojnë në Prishtinë për regjistrim dhe modifikim të biznesit, sikurse ka ndodhur deri tani. Në komunën e tonë janë të regjistruara gjithsej 1.214 biznese, prej të cilave 850 janë aktive.



# Nënkryetari i Komunës vizitoi Turqinë

**3 qershor.** Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku ka marr pjesë në një konferencë 3 ditore në Bashkinë e Osmangazit në Bursa të Turqisë, ndërsa kanë marrë pjesë kryetarë komunash, politikanë dhe ekspertë nga më shumë se 50 shtete: nga Bashkimi Evropian, vendet kandidate për BE dhe nga Ballkani.

Temë kryesore e konferencës ishte roli i autoriteteve lokale në kuadër të zgjerimit të BE-së dhe politika evropiane e fqinjësisë. Sipas nënkryetarit Loku, qëllimi kryesor ishte nxitja e dialogut dhe bashkëpunimit në mes qyteteve të shteteve të BE-së dhe atyre të vendeve kandidate dhe Ballkani.



# Përmbyllet "Java e Mjedisit"

**3 qershor.** Java e Mjedisit në Kaçanik është përmbyllur me ndërtimin e miniparqeve në hapësirat të cilat më parë ishin deponi ilegale. Grupi i ambientalistëve të rinj bashkë me sektorë përkatës të ambientit dhe shërbimeve publike, në ditën përmbyllëse të aktiviteteve kanë ndërtuar një



minipark në afërsi të Pallatit të Kulturës në Kaçanik, duke mbëltuar lule e bredha. Z. Bujar Dullovi, inspektor i Mjedisit, ka thënë se të gjitha aktivitetet në kuadër të "Javës së Mjedisit", kanë pasur për qëllim edhe ndërgjegjësimin e njerëzve në lidhje me rëndësinë e mjedisit dhe krijimin e sa më shumë hapësirave të gjelbëruara. Z. Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës e Mbrojtjes së Mjedisit, është shprehur i kënaqur me angazhimin e të gjithë pjesëmarrësve të këtij aktiviteti, e në veçanti ka përgëzuar Grupin e ambientalistëve të rinj. Java e Mjedisit ka filluar më 30 maj, ndërsa të gjitha aktivitetet janë organizuar nga DUKMM-ja, DESHP-ja, DAK-ja dhe Grupi i Ambientalistëve të Rinj.

# CARITAS-i i Luksemburgut vazhdon me investimet

**5 qershor.** Fondacion CARITAS nga Luksemburgu në tri vjetët e ardhshme do të investojë 4.3 milionë euro në gjashtë komuna të regjionit të Gjilanit. Në mesin e përfituesve të këtij donacioni është edhe komuna jonë. Përfaqësues të kësaj organizate janë takuar me drejtues të pushtetit lokalë në Kaçanik dhe kanë prezantuar programin trevjeçar 2011-2013. Shefi i këtij misioni në

Kosovë, z. Gerhard Fischer, ka theksuar se mjetet financiare do të adresohen në projektet arsimore, shëndetësore dhe për gjenerimin e të ardhurave. Ai ka bërë të ditur se ky fondacion përveç projekteve me komuna, ka ndarë edhe një grant për projekte për katër komunitetet e këtyre gjashtë komunave, ndërsa përzgjedhja e projekteve do t'i nënshtrohet kritereve të konkurrencës.



## KKSB-ja aprovon planin e punës

**6 qershor.** Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi në Kaçanik e ka aprovuar Planin e veprimit për muajt e mbetur të këtij viti. Brenda shtatë muajve vijues KKSB ka planifikuar që t'i identifikojë dhe t'i adresojë te organet kompetente të gjitha çështjet të cilat rrezikojnë sigurinë e përgjithshme të qytetarëve, duke veçuar dukuritë e huliganizmit, narkomanisë, sigurinë në rrugë, etj. Zyrtarë të lartë policorë, gjendjen e sigurisë në këtë komunë e kanë paraqitur si të mirë. Togeri Jaser Jaha, u.d. i komandantit të Stacionit Policor, ka përmendur vetëm një rast të një aksidenti në punë të një qytetari. Në këtë kuptim në KKSB është kërkuar nga inspektorët e ndërtimit që të marrin masa ndaj kompanive ndërtimore, të cilat nuk i zbatojnë kriteret e sigurisë gjatë ndërtimeve. Po ashtu është shprehur shqetësimi i një qytetari,

sipas të cilit gjatë një bastisje dhe arrestimi javën e kaluar, policia ka tejkaluar kompetencat. Lidhur me këtë, togeri Jaha ka sqaruar se në këtë aksion kanë marrë pjesë njësi speciale (jo nga Stacioni Policor i Kaçanikut), ndërsa ka inkurajuar që për tejkalim eventual të kompetencave nga ana e policisë, qytetarët t'i denoncojnë rastet në Stacionin Policor në Kaçanik.



## Paralajmërohen qiraxhinjtë borxhlinj

**8 qershor.** Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Kaçanik u ka bërë thirrje pronarëve të lokaleve afariste, të cilët nuk kanë paguar borxhin e qirasë për shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe lokaleve në pronë komunale, që ta kryejnë këtë obligim më së largu deri të hënën e ardhshme, në të kundërtën këta borxhlinj do të sanksionohen me mbyllje të lokaleve, duke filluar një ditë pas skadimit të këtij apeli. Borxhi i qiraxhinjve të Komunës gjatë viteve paraprake, përfshirë edhe ngarkesën për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, është 57.102 euro. Gjatë këtij viti nga këta qiraxhinj janë arkëtuar vetëm 9.280 euro ose 16.25 % e borxhit të përgjithshëm.

# Shiu dëmton rrugët dhe kulturat bujqësore

**9 qershor.** Të reshurat e mëdha të shiut në komunën tonë kanë shkaktuar dëme materiale dhe ka sjellë telashe në qarkullimin e njerëzve dhe automjeteve. Për shkak të vërshimit të "Përroit të Rakocit" i cili derdhet në shtratin e lumit Neredime, nënkalimi i ulët i kësaj përroske në rrugën "Ismail Raka" në qytet, nga rëra dhe gurët e bartura nga sasia e madhe e ujit, e ka ngulfatur tërësisht. Dëme të konsiderueshme janë shkaktuar edhe në rrugën "Dëshmorët e Lirisë", e cila ishte në ndërtim e sipër, si dhe në atë "Ramadan Agushi". Përroska e kësaj të fundit e ka demoluar një tombinë (urë e vogël) dhe e ka gërryer rrugën. Në masë të konsiderueshme rrugët janë dëmtuar edhe në fshatrat Ivajë e Kotlinë. Dëme të mëdha ka shkaktuar edhe breshëri, ku përveç dëmeve në automjete, në fshatrat Ivajë, Kotlinë dhe Glloboçicë janë dëmtuar edhe kulturat bujqësore: misri, pemët, perimet etj. Për t'u marrë me pasojat e dëmeve, Komuna ka formuar Shtabin e Emergjencës. Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku dhe anëtarë të tjerë të këtij shtabi kanë dalë në terren për ta vëzhguar nga afër gjendjen e krijuar dhe përpjekjet për sanimin e kësaj gjendje.



# Kryetari Zharku ka pritur ministren e Integrimeve

**10 qershor.** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka pritur në një takim ministren e Integrimeve, znj. Vlora Çitaku. Kryetari Zharku e ka njoftuar ministren Çitaku me kapacitetet e komunës tonë për riatdhesimin dhe integrimin e qytetarëve tanë të cilët kthehen në vendlindje. Lidhur me riatdhesimin e kosovarëve, si një nga standardet për liberalizimin e vizave me BE-në, ministrja Çitaku ka vlerësuar se ky proces është një barrë e madhe edhe për komunën tuaj. Ajo ka thënë se për këtë qëllim Qeveria e Republikës së Kosovës e ka një fond në vlerë prej 3.5 milionë eurosh, për nevojat e



ushqimit, mobilimit dhe pagesës së qirave të përkohshme të të riatdhesuarve. Nga ana tjetër, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka premtuar ministres Çitaku se kapacitetet e institucioneve do të jenë në funksion të kryerjes së të gjitha shërbimeve për të riatdhesuarit në komunën tonë.

# Dëmi i vërshimeve, rreth një milion euro

**10 qershor.** Shtabi Komunal i Emergjencës, i themeluar si rrjedhojë e vërshimeve që kanë kapluar komunën tonë, ka dalë në terren për t'i vlerësuar dëmet e vërshimeve. SHKE ka vlerësuar se dëmet e vërshimeve kapin vlerën e rreth një milion eurove. Dëmi më i madh është shkaktuar në kulturat bujqësore, por edhe në infrastrukturën e rrugëve, e sidomos rrugën në ndërtim e sipër në drejtim të pllakës përkujtimore në Rakoc. Në një konferencë me gazetarë, drejtori i Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbimeve Publike, z. Rushan Ceka, ka thënë se prej dëmit të përgjithshëm, rreth 700 mijë euro kanë pësuar kulturat bujqësore, kurse rreth 300 mijë euro infrastruktura në një konferencë shtypi të premten pasdite. Ai ka shprehur shqetësimin se Komuna nuk ka fonde për t'i sanuar dëmet në rastet emergjente, sikurse është ky vërshim, mbetet të shpresohet në ndihmën e Qeverisë së Kosovës.



# Urimi i kryetarit Zharku për Ditën e Çlirimit të Kaçanikut

**11 qershor**. Të nderuar qytetarë!

Dita e Çlirimit të Kaçanikut është ditë e krenarisë sonë të madhe, por njëkohësisht edhe e dhimbjes dhe kujtimit për të gjithë ata që u sakrifikuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Në këtë ditë të shënuar nderojmë sakrificën e dëshmorëve dhe luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ideali i lirisë për të cilin ata u sakrifikuan, do të ndriçojë gjithmonë dhe do të jetë udhërrëfyes për ndërtimin e jetës së re për të gjithë ne. Kujtimi për dëshmorët është i përjetshëm.

Sot, në 12-vjetorin e Ditës së Çlirimit të komunës tonë, përkatësisht tri vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, jemi të obliguar që idealit të dëshmorëve t'ia japim kuptimin e plotë.

*Kaçanik, 11 Qershor 2011*
*Kryetari i Komunës së Kaçanikut*
*Xhabir Zharku*

# Kremtohet Dita e Çlirimit

**11 qershor.** Në oborrin e gjimnazit “Skënderbeu” në Kaçanik, është shënuar përvjetori i 12-të i Ditës së Çlirimit të komunës tonë. Në këtë tubim kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve komunale dhe qytetarë të shumtë. Në një fjalë rasti në këtë tubim festiv, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, është shprehur se populli ynë është i lirë, është krenar dhe meriton të festoj me dinjitet. Ai tha se nga kjo vatër arsimore (gjimnazi “Skënderbeu”) filloi edhe rrugëtimi për liri, nga ky vend nisën demonstratat e vitit 1981.
Tubimin e ka përshëndetur kryetari i OVL-UCK-së, z. Ejup Runjeva.
Ai mes tjerash tha se sot kemi shumë arsye të kremtojmë e gëzojmë së bashku Ditën e Çlirimit, por mos të harrojmë se kemi edhe shumë punë për të bërë. Për nderë të Ditës së Çlirimit janë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve dhe janë vendosur kurora lulesh.



# Festivalin “Kaçaniku 2011” e fiton “Vaçe Zela”

**11 qershor.** Ka përfunduar Festivali kombëtar të shoqërive dhe ansambleve kulturore artistike “Kaçaniku 2011”. Qendra Kulturore “Vaçe Zela” nga Lushnja e Shqipërisë është fituese e edicionit të 23-të të këtij festivalit. Lushnjarët kanë marrë edhe një çmim tjetër, atë për interpretim më të mirë të këngës. Edhe SHKA-ja me traditë 45 vjeçare “Josip Rela” nga Podujeva, si konkurrentja e parë e natës së dytë të festivalit, ka shfaqur vlera të larta artistike. Edhe kjo SHKA ka fituar dy çmime: atë të publikut dhe një mirënjohje të veçantë për orkestrën e saj. Vendin e dytë e ka zënë SHKA “Malësori” nga Gjonaj i Hasit të Prizrenit, ndërsa për vallen më të mirë është



shpërblyer grupi i valleve i SHKA “Shpresa” nga Veleshta e Strugës. Fituesit të vendit të parë i është dhuruar një pikturë me motive nga 17 shkurti 2008 – festimi i Ditës së Pavarësisë së Kosovës, në Kaçanik, ndërsa të dytit një pikturë me portretin e heroit kombëtar Skënderbeut si dhe çmimit të publikut po ashtu një pikturë me motive nga Kaçaniku. Vlerësimin e konkurrentëve të këtij festivali e kanë bërë juria profesioniste: kompozitori Sami Piraj (kryetar jurie), koreografi Dilaver Kryeziu dhe etnomuzikologu Rexhep Munishi. Pjesë e këtij evenimenti më të madh kulturor në Kaçanik

ishin edhe SHKA "Ibe Palikuqja" (Shkup), SHKA "Rexho Mulliqi" (Preshevë), ndërsa jashtë konkurrencës kanë marrë pjesë edhe SHKA "Gjilani" (fituese e festivalit të kaluar) dhe SHKA "Gryka e Kaçanikut" e SHKA "Shqiponja", si nikoqire të festivalit. Ky festival tradicional është organizuar nën patronazhin e kryetarit të Komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharkut, dhe është mbajtur për nder të 11 Qershorit – Ditës së Çlirimit të komunës së Kaçanikut.

## Darkë për mësimdhënësit

**16 qershor.** Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, ka shtruar edhe një darkë tashmë tradicionale për mësimdhënësit e komunës tonë. Qeverinë e Kosovës në këtë darkë e ka përfaqësuar ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë Buja, i cili i ka uruar mësimdhënësit kaçanikas për përfundimin e vitit shkollor, duke i quajtur ata si shtylla kryesore e shtetit të Kosovës. Ministri Buja i ka cilësuar mësimdhënësit si komunitet i cili nxori edhe kuadrot kryesorë të shtetit tonë. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka falënderuar punëtorët arsimorë për angazhimet e tyre dhe sukseset e arritura. Z. Zharku u ka thënë punonjësve arsimorë se suksesi i arritur ndoshta nuk është ai i dëshiruari, por ka shpresuar se asnjëherë nuk do të mungojë vullneti dhe angazhimi i tyre për rezultate edhe më të mira.



# Lepenci bëhet anëtar i elitës së futbollit kosovar

**16 qershor.** Klubi i futbollit Lepenci është bërë anëtar i ri i Superligës së Kosovës, pasi në ndeshjen e barazhit e cila u zhvillua në Mitrovicë, ka mundur skuadrën e Ballkanit të Suharekës me rezultat 1:0. Golin e fitores e ka shënuar Xhevdet Shabani në minutën 7'. Për të mbështetur ekipin e Lepencit, në Mitrovicë kanë udhëtuar mijëra tifoz, të prirë nga simpatizuesit fanatik të skuadrës kuqezi "Fikshat". Për ta përkrahur anëtarin e ri të Superligës, në Mitrovicë ka udhëtuar edhe kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, nënkryetari z. Heset Loku me bashkëpunëtorë. Përveç lojës së shkëlqyeshme fitoren e Lepencit e ka ndihmuar pa dyshim edhe përkrahja e pandërprerë e "Fikshave" të cilët kanë krijuar një atmosferë impozante në stadiumin "Adem Jashari". Festa e filluar në Mitrovicë, ka vazhduar edhe gjatë rrugës për në Kaçanik, ndërsa ka kulmuar në Bulevardin "Ismail Raka" ku kishin dalë qytetarë të shumtë për t'iu bashkuar festës.
Kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku, i ka uruar dhe përgëzuar të gjithë për suksesin e arritur, ndërsa në veçanti tifozët "Fikshat", lojtarët e Lepencit për lojë burrërore dhe angazhim maksimal si dhe udhëheqësit e klubit. Atmosfera festive mu në qendër të qytetit, ka vazhduar deri në orët e vona të mbrëmjes.



# KE ndan 10 mijë euro për SHFMU "Emin Duraku"

**21 qershor.** Komisioni Evropian ka shpërblyer kontributin dhe suksesin e nxënësve të shkollës fillore "Emin Duraku" në Kaçanik. Dhjetë mijë euro është shuma materiale të cilën një grup nxënësish të kësaj shkolle e kanë fituar me punën e tyre në një projekt të ambientit. Ky sukses ka rezultuar nga garat për ambient 'Play for all', i organizuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës dhe Qendra për arte vizuale "Multimedia", në bashkëpunim me MASHT- in. Ky ishte edhe shkasi që drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, z. Azem Guri, i ka bërë një pritje këtyre nxënësve.




Zëvendësdrejtori i kësaj shkolle, z. Lulzim Krasniqi, ka thënë se me këto mjete është planifikuar rregullimi i ambientit në hapësirën e jashtme të shkollës.

# MKRS-ja premton rinovimin e fushës së futbollit

**25 qershor.** Me rastin e hyrjes në Superligën e Kosovës, kryetari i Komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharku, ka shtruar një darkë për zyrtarët dhe futbollistët e KF Lepenci. Ai ka kërkuar nga klubi organizim më të madh për ndeshjet e Superligës, ndërsa tifozët "Fikshat" i ka lutur për disiplinë dhe anim korrekt të skuadrës së tyre. Në këtë darkë solemne ishte i pranishëm edhe zëvendësministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajdin Abazi. Kryetari Zharku nëpërmjet zëvendësministrit Abazi ka porositur Qeverinë e Kosovës,

për investime në përmirësimin e kushteve në stadiumin e Lepencit "Besnik Begunca". Ndërkaq, numri dy i MKRS-së, z. Hajdin Abazi, ka premtuar duke thënë se të paktën do të rinovohet fusha e futbollit. Në shenjë suksesi për hyrjen në elitën e futbollit kosovar, kryetari Zharku, futbollistëve, kryesisë dhe mbështetësve të KF Lepenci, u ka ndarë plaket me emblemën e Komunës.



## Nxënësit e shpërblyer, tri ditë në bregdetin shqiptar

**26 qershor.** Njëzetetre nxënës të shkollave fillore të komunës tonë, të cilët zunë vendet e para në garat komunale, janë shpërblyer më nga një pushim treditor në bregdetin shqiptar, përkatësisht në Durrës. Nxënësit e shpërblyer u përkasin klasave të pesta deri në të tetën, ndërsa për në Durrës do të shoqërohen edhe nga arsimtarët e lëndëve përkatëse dhe zyrtari komunal për arsim, z. Hafet Ceka. Nxënësit do të qëndrojnë gratis në vilën e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku, ndërsa shpenzimet tjera do t'i bartë Drejtoria Komunale e Arsimit, në mbështetje të kryetarit Zharku. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në një takim të mbajtur më 1 shtator 2010, vitin shkollor 2010-2011 e pat shpallur "Vit të cilësisë dhe disiplinës" dhe pat premtuar shpërblim për nxënësit dhe arsimtarët më të suksesshëm.

# KORRIK 2011

## Kryetari Zharku inspekton segmentet e asfaltuara të rrugës në Bob

**1 korrik** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka inspektuar tri segmentet e asfaltuara të rrugës në fshatin Bob. Kryetari Zharku ka thënë se asfaltimi i këtyre segmenteve rrugore shënon përmbylljen e këtij projekti të nisur më herët. “Komuna po bën përpjekje të vazhdueshme që t’u ofrojë kushte sa më të mira për jetë të gjitha komuniteteve duke investuar jo vetëm në infrastrukturën rrugore”, ka nënvizuar z.Zharku. Segmenti i parë i asfaltuar i rrugës në Bob është i gjatë 432 metra, i dyti 235 metra dhe i treti 240 metra (gjithsej 907 metra). Për realizimin e këtij projekti janë shpenzuar 61 mijë e 679 euro të buxhetit komunal.



## Përurohet ambulanca në fshatin Bob

**1 korrik** – Është përuruar objekti i ambulancës në fshatin Bob. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, pasi i ka përgëzuar banorët e fshatit për ambulancën, ka thënë se tashti e tutje pacientët e këtij lokaliteti do t'i kenë më afër disa nga shërbimet shëndetësore. Ndërkaq, drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik, dr.Ekrem Dullovi, e ka falënderuar Ministrinë e Shëndetësisë për investimin, ndërsa kryetarin Zharku për mbështetjen e projektit. Në ceremoninë përuruese i pranishëm ka qenë edhe z.Rrahman Sulejmani, zyrtar i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë. Ndërtimi i ambulancës në Bob ka kushtuar 48 mijë e 331 euro, ndërsa paratë i ka dhënë Ministria e Shëndetësisë.



## Komuna me sportel të veçantë për mërgimtarët

**4 korrik** – Ekzekutivi komunal është përcaktuar për funksionimin e një sporteli vetëm për palët mërgimtarë gjatë verës së sivjetme. "Nga sot, në zyrën pritëse të KK të Kaçanikut një sportel do të jetë në funksion vetëm për aplikim për dokumente nga palët mërgimtarë", ka theksuar



z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Ndërkaq, z.Jeton Topalli, drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, ka nënvizuar se sporteli i veçantë për kurbetçinjtë do t'i përmbush nevojat e tyre për marrje dokumentesh pa vonesa.

## KK-ja i thotë "Po" ndihmës për KF Lepenci dhe investimit në shkollën e fshatit Vataj

**5 korrik** - Kuvendi i Komunës i ka thënë "Po" propozimvendimit të ekzekutivit komunal për ta mbështetur financiarisht KF Lepenci pas hyrjes në Superligë. Këshilltarët e votuan propozimin për t'ia transferuar 30 mijë euro Lepencit. Këshilltarët vendosën edhe për transferimin e shumës prej 69 mijë e 667 euro për realizimin e projektit: "Ndërtimi i shkollës në fshatin Vataj". Në seancë është shqyrtuar edhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Komunale (KASHK) 2012-2014. Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, ka thënë se KASHK-ja është dokument bazë për hartimin e draftbuxheteve të 3 vjetëve në vijim. Ai ka thënë buxheti i vitit 2012 është paraparë në shumë prej 5.462.755 eurosh, ai i vitit 2013 në shumë prej 5.529.999 eurosh dhe buxheti i vitit 2014 në shumë prej 5.574.176 eurosh. Është sqaruar se pjesë e KASHK-së është edhe lista e propozuar e projekteve kapitale për periudhën 2012 – 2014. Ekzekutivi komunal fillimisht e ka propozuar listën me 53 projekte. Ndërkohë ajo është



pasuruar edhe me 6 projekte të propozuara nga Komiteti i Politikës dhe Financave, ndërsa propozime për përfshirje në listë projektesh të reja janë dëgjuar edhe në seancën e KK-së. Në mbledhje është thënë se lista mund të pasurohet edhe me propozime të reja nga debatet publike me qytetarë. KASHK-ja do t'i kthehet KK-së për miratim pas debateve të sipërpërmendura.

## Kryetari firmos vendimin për themelimin e komisionit që do ta hartojë padinë ndaj Serbisë

**6 korrik** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka firmosur vendimin për themelimin e komisionit komunal që do ta hartojë padinë kundër Serbisë për krimet e kryera ndaj njerëzve dhe dëmet e shkaktuara materiale në luftën e zhvilluar gjatë periudhës 1998-1999. Në përbërjen 7-anëtarësh të komisionit janë përfshirë emra nga ekzekutivi komunal, legjislativi dhe shoqëria civile. Anëtarë të komisionit janë emëruar: Heset Loku, nënkryetar i Komunës, Xhelal Gashi, kryesues i Kuvendit Komunal, Zekirja Loku, anëtar i Kuvendit, Florijeta Gashi, anëtare e Kuvendit, Sevdije Frangu, anëtare e Kuvendit, Hafide Kuka, zyrtare e arkivit të Komunës dhe Shemsedin Abazi, përfaqësues i shoqërisë civile. Komisioni ka shprehur gatishmërinë të bashkëpunojë me qytetarë, përfaqësues të institucioneve dhe OJQ-të për grumbullimin e sa më shumë materialeve faktografike të krimeve ndaj njerëzve dhe dëmeve të shkaktuara materiale nga forcat pushtuese serbe. Komisioni komunal për ngritjen e padisë ndaj Serbisë u bën apel të gjithë atyre që kanë dëshmi për krimet e shtetit serb që ato t'ia dorëzojnë komisionit.



## Komuna u dhuron serra 10 fermerëve

**6 korrik** - Komuna  i ka shpërblyer 10 fermerë me nga 1 serrë për kultivim perimesh. "Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë e ka publikuar listën me emrat e 10 fermerëve përfitues të nga një serre", ka bërë të ditur z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Ai ka sqaruar se vlera e një serre të dhuruar është 3.630 euro. "Serrat do t'u merren fermerëve që nuk kultivojnë perime në to qoftë edhe për një sezon të vetëm", ka theksuar zëdhënësi Dullovi. Është thënë se për 10 serrat e Komunës kanë aplikuar gjithsej 32 fermerë.

## KRVL-ja sensibilizon qytetarët për pjesëmarrje në debat

**6 korrik** - Anëtaret e Këshillit Rinor të Veprimit Lokal e kanë zhvilluar një fushatë për sensibilizimin e qytetarëve për pjesëmarrje në debatin publik të 8 korrikut. Në këtë fushatë, të rinjtë ua kanë shpërndarë qytetarëve broshurën me të dhënat për buxhetin e Komunës së Kaçanikut të vitit 2011, e përgatitur nga projekti Zvicër–Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS, që zbatohet nga fondacioni “Intercooperation”. Qytetarëve u janë dorëzuar edhe afishet dhe posterët e ilustruar për pjesëmarrje në debat. Pjesë e fushatë ka qenë edhe vendoja e posterëve në pikat më frekuentuese të qytetit.

## Mbahet debati i parë publik me qytetarë

**8 korrik** - Në funksion të informimit dhe pjesëmarrjes së gjerë dhe aktive të publikut dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, në pallatin e kulturës „Xheladin Kurtaj” Komuna e ka organizuar debatin e parë publik me qytetarë ku është diskutuar për buxhetin e sivjetmë komunal dhe shpenzimet e deritashme, sikundër edhe për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2012 – 2014 (buxheti i vitit 2012, me theks të veçantë). Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, pasi i ka  përshëndetur qytetarët e pranishëm, që kësaj here ishin në numër dukshëm më të madh, ka thënë se Komuna e Kaçanikut e ka

organizuar këtë debat në bashkëpunim me LOGOS-in dhe USAID/DEMI-in. Kryetari u ka thënë qytetarëve se ju mund të shprehni mendimet tuaja dhe mund të bëni propozime të ndryshme, por Kuvendi i Komunës është organi i cili merr vendime. "Ne kemi një buxhet të limituar, prandaj gjithnjë mundohemi t'i realizojmë projektet të cilat vlerësohen si më prioritare", ka nënvizuar z.Zharku. Ai në vazhdim ka theksuar se kemi një listë të prioriteteve për periudhën 3-vjeçare që aktualisht ka arritur në 70 projekte të propozuara. "Kjo listë mund të pasurohet edhe me propozime të tjera", ka thënë kryetari Zharku. Ai i ka njoftuar qytetarët edhe me lartësitë e fondeve të investimeve kapitale për 3 vjetët në vijim. "Për investime kapitale në vitin 2012 është paraparë shuma prej 1 milion e 112 mijë eurosh, për vitin 2013 shuma prej 1 milion e 183 mijë eurosh dhe për vitin 2014 shuma prej 1 milion e 228 mijë eurosh. Shuma në total për këtë periudhë 3-vjeçare është 3,5 milionë euro, pa i llogaritur donacionet eventuale nga donatorët qeveritarë dhe joqeveritarë", ka theksuar kryetari Zharku. Z.Bersan Disha, konsulent për buxhet i LOGOS-it, ka thënë se LOGOS-i po e përkrah Komunën e Kaçanikut në disa fusha. "Së fundi jemi duke realizuar projektin për hartimin e Planit Rregullues të qytetit Kaçanik dhe projekte tjera të cilat janë në fazën e zbatimit. Projekte të reja do të realizohen në bashkëpunim me Komunën", ka theksuar z.Disha. Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, u ka thënë qytetarëve se realizimi i buxhetit të sivjetmë në 6-mujorin e parë është bërë në shkallën prej 34 % ose 1 milion e 846 mijë euro, ndërsa të hyrat vetjake komunale në këtë periudhë janë realizuar në shkallë 40 % ose 183 mijë e 244 euro. Drejtori Vërbani ka nënvizuar se buxheti i planifikuar për investime



kapitale sivjet është në shumë prej 1 milion e 579 mijë euro. Ai e ka bërë edhe një prezantim të shkurtër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve Komunale 2012 – 2014. Sipas planifikimit, buxhetet në tri vitet e ardhshme do të kenë rritje prej 5 – 6,2 %. Në vazhdim pati një diskutim të hapur gjatë të cilit qytetarë të shumtë hapën çështje të ndryshme me interes për ta. Qytetarët prezantuan disa nga projektet më prioritare për lokalitetet e tyre. Kryetari i komunës, z. Zharku, u ka thënë qytetarëve se të gjitha këto propozime do të merren parasysh, ndërsa Komuna do të veprojë në kuadër të mundësive buxhetore dhe donacioneve eventuale. Shumë aktiv në debat kanë qenë anëtarët e Këshillit Rinor të Veprimit Lokal dhe Grupi i Ambientalistëve të Rinj të cilët kërkuan më shumë projekte për të rinjtë. Ata morën zotimin e ekzekutivit se do të mbështeten me mjete buxhetore projektet e tyre, ndërsa do të kërkohen edhe donatorë për realizimin e tyre.

## Korren hektarët e parë me grurë

**11 korrik** – Hektarët e pare me grurë janë korrur në fshatin Begracë, ndërsa rendimentet sillen rreth 3 mijë kilogramë për një hektar. Sivjet, në territorin e komunës së Kaçanikut janë mbjellur 610 hektarë me grurë. Për fushatën e sivjetme të korrje-shirjeve janë angazhuar gjithsej 17 autokombajna, ndërsa çmimi për një hektar grurë të korrur është 100 euro. Ky çmim është caktuar



nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Z. Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka theksuar se autokombajnerët që nuk e përfillin çmimin e caktuar nuk do të përfitojnë nga subvencionimi i MBPZHR-së për furnizim me derivate me çmim 30% më të lirë. Për përcjelljen e fushatës së korrje-shirjeve është themeluar komisioni komunal në përbërje: Zekirja Koxha, kryetar, Naser Kuka dhe Mustafë Loku, anëtarë.

## LOGOS-i i aftëson zyrtarët përgjegjës komunalë për shfrytëzimin e GIS-it

**13 korrik** - Projekti Zvicër-Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS, përmes një trajnimi të specializuar për Sistemin Gjeografik të Informatave-GIS, i mbajtur në Viti, i ka aftësuar zyrtarët përgjegjës komunalë të Urbanizmit dhe të sektorëve tjerë të Kaçanikut dhe të 6 komunave tjera partnere për hartimin dhe zbatimin më të lehtë të planeve zhvillimore komunale dhe të atyre rregulluese. Z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka thënë se Komuna e Kaçanikut tashmë ka filluar ta hartojë planin rregullues. Në këtë kontekst, ai ka nënvizuar se aftësimi i zyrtarëve për ta shfrytëzuar sistemin GIS është me rëndësi të veçantë në procesin e zbatimit Planit Zhvillimor Komunal dhe atij Urban, sikundër edhe në procesin e hartimit të Planit Rregullues të zonës së parë të qytetit.



# LOGOS-i mbështet financiarisht Zyrën e Informimit

**14 korrik** - Projekti Zvicër-Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS, do ta mbështes financiarisht Zyrën e Informimit të KK të Kaçanikut. "LOGOS-i do ta mbështesë Zyrën e Informimit me 2.000 euro", ka theksuar z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Sipas tij, donatori i sipërpërmendur është përcaktuar për t'i mbështetur financiarisht edhe zyrat e informimit të komunave partnere të rajonit të Gjilanit. Ndërkaq, z.Pascal Fendrich, zyrtar i LOGOS-it, ka thënë se mbështetja për zyrat e informimit të komunave partnere është në funksion të aftësimit të tyre që të gjitha zhvillimet me interes për publikun brenda institucioneve komunale t'u plasohen qytetarëve në kohë reale.



# Kryetari firmos propozimvendimin për themelimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm

**20 korrik** - Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, e ka firmosur propozimvendimin për themelimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm (KAB). Ai i ka propozuar Komitetit të Politikës dhe Financave që ta shqyrtojë atë dhe t'ia kalojë Kuvendit të Komunës për miratim. Propozimvendimi parasheh që të themelohet Komiteti i Auditimit të Brendshëm për Organizatën Buxhetore të Komunës së Kaçanikut në përbërje prej 3 ekspertësh të cilët nuk duhet të jenë të punësuar në administratën

komunale. KAB-ja e ka për detyrë që t'i ofrojë mbështetje menaxhmentit të Komunës, pastaj ta rishikojë dhe aprovojë strategjinë e auditimit dhe planet vjetore të auditimit. Përgjegjësi e këtij komiteti do të jetë edhe rishikimi i raporteve të Auditorit të Brendshëm dhe auditimeve të jashtme që bëhen nga Zyra e Auditorit Gjeneral (ZAGJ), shqyrtimin e të gjeturave dhe rekomandimet e dhëna etj. Themelimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm është rekomanduar nga ZAGJ-i në raportin e pasqyrave financiare Komunës së Kaçanikut të vitit 2010.

## Komuna angazhohet për standarde evropiane në mjedis

**21 korrik** - Çështjet mjedisore dhe menaxhimi i mbeturinave sipas standardeve evropiane janë trajtuar në bashkëbisedimin ndërmjet zyrtarëve të projektit të binjakëzimit - “Bashkëpunimi evropian për komuna të fuqishme – Planifikimi për ofrimin e shërbimeve”- z. Alan Packer e znj. Argurjana Sadiku dhe drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës e Mbrojtjes së Mjedisit, z. Bekim Troni. I pranishëm ka qenë edhe inspektori komunal mjedisor, z. Bujar Dullovi. Komuna e Kaçanikut më herët i ka identifikuar çështjet mjedisore si çështje për të cilat ka nevojë të ndihmohet për arritjen e standardeve evropiane. Z. Packer dhe znj. Sadiku i kanë thënë drejtorit Troni se në shtator apo tetor do të angazhohet një ekspert i kësaj



fushe i cili do të bashkëpunojë ngushtë me Komunën. Z.Troni i ka njoftuar zyrtarët e projektit të sipërpërmendur me sfidat me të cilat përballet sektori i mjedisit dhe përpjekjet e vazhdueshme për shërbime sa më cilësore. "Bashkëpunimi evropian për komuna të fuqishme – Planifikimi për ofrimin e shërbimeve" është projekt i Komisionit Evropian që synon të ndërtojë marrëdhënie të ngushta ndërmjet Britanisë së Madhe, Danimarkës dhe Kosovës. Nga projekti do të përfitojnë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe të gjitha komunat e Kosovës.

## Policia i njofton administratorët e lokaliteteve të komunës me metodologjinë e re të punës

**23 korrik** - Stacioni Policor i Kaçanikut e ka mbajtur një takim me administratorët e lokaliteteve të komunave Kaçanik dhe Han i Elezit në të cilin është debatuar për metodologjinë e re të punës të policisë. Krerë të Stacionit Policor të Kaçanikut dhe të Drejtorisë të Policisë Rajonale të Ferizajt kanë thënë se metodologjia e re e punës nënkupton policimin në bashkësi nëpërmjet operimit nëpër sektorët e ndarë. "Puna në sektorë është menduar si hap për të qenë më afër qytetarëve edhe me patrullime këmbë", ka thënë koloneli Izet Azizi, drejtor i Policisë Rajonale të Ferizajt. Në këtë rrafsh, togeri Jaser Jaha, u.d. i komandantit të Stacionit Policor të Kaçanikut, ka thënë se vartësit e tij do të operojnë në 4 sektorët e ndarë në Kaçanik dhe në 1 në Han të Elezit. Togeri Jaha i ka njoftuar administratorët me emrat e policëve të caktuar për punë nëpër sektorët e ndarë. Administratorët janë shprehur të gatshëm të bashkëpunojnë me policinë për çështjet e sigurisë.



# Caktohet lokacioni i urës së re mbi Neredime

**25 korrik** - Zyrtarë të Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe përfaqësues të kompanisë së kontraktuar e kanë caktuar lokacionin ku do të ndërtohet ura e re mbi lumin Neredime. Z.Bekim Troni, drejtori i DUKMM-së, ka thënë se projekti do të menaxhohet nga z. Fatos Koxha, inxhinier i ndërtimtarisë, i cili përfaqëson autoritetin kontraktues (Komuna), dhe nga z. Bajram Shefkiu, inxhinier i ndërtimtarisë, përfaqësues i LOGOS-it. Ura e re është kontraktuar në shumë prej 77.602 eurosh. LOGOS-i i ka alokuar 50 mijë euro, ndërsa Komuna 27.602 euro. Afati për ndërtimin e urës është 70 ditë pune.

# Mirënjohje për zyrtarin e lartë të KE-së para largimit nga Kosova

**26 korrik** - Shefit për operacione të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, z.Kjartan Bjornsson, i është dorëzuar një mirënjohje në shenjë falënderimi për bashkëpunimin dhe partneritetin me Komunën e Kaçanikut. Në emër të kryetarit të Komunës, z.Xhabir Zharku, mirënjohjen z.Bjornsson ia ka dorëzuar nënkryetari i Komunës, z.Heset Loku, në Novobërdë. Takimi i z.Bjornsson me kryetarët e komunave të sektorit të lindjes në Novobërdë është mbajtur në vigjilje të largimit të tij nga Kosova.



# USAID-i premton mbështetje për KVRL-në

**27 korrik** - USAID-i ka premtuar se do ta pajis zyrën e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) të Kaçanikut me kompjuter, printer dhe mjete të tjera të nevojshme për punë. Në takimin me z. Sali Salihu, këshilltar për qeverisje lokale i projektit Iniciativa për Komuna Efektive dhe Demokratike (DEMI) të USAID-it dhe znj. Melihate Limani, eksperte për rininë, anëtarët e KVRL-së i kanë shpalosur punët dhe aktivitet e deritashme të këshillit, sikundër edhe Planin e Veprimit dhe aktivitetet e planifikuara. Z. Salihu u ka thënë të rinjve se USAID/DEMI do të mbështes disa nga projektet e përfshira në Planin e Veprimit të KVRL-së. Ndërkaq, z. Arlind Hysa, kryetar i KVRL-së, ka thënë se pajisja me mjete të nevojshme për punë e zyrës dhe një fond për mbajtjen e mbledhjeve janë nevojat më emergjente për funksionimin e suksesshëm të këshillit.



## Riparohen librat e gjendjes civile të dëmtuara nga koha



**28 korrik** - Janë riparuar 97 libra të gjendjes civile të administratës komunale të cilat ishin dëmtuar nga koha. Z.Jeton Topalli, drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, ka thënë se janë riparuar e lidhur gjithsej 97 libra të gjendjes civile që u përkasin librave amë të të lindurve (LAL), atyre amë të të vdekurve (LAV) dhe librave amë të të martuarve (LAM). Ndërkaq, z. Ilir Teneqja, shef i sektorit të gjendjes civile, ka thënë se riparimi i tyre është bërë me qëllim të ruajtjes sa më të mirë si kopje origjinale.

## Legjislativi miratoi Rregulloren për transparencën komunale

**29 korrik** - Kuvendi i Komunës e ka miratuar Rregulloren për transparencë komunale dhe Raportin për realizimin e mjeteve buxhetore për periudhën janar - qershor 2011, ndërsa ka debatuar edhe për objektin banesor-afarist në afërsi të QKMF-së. Kuvendi e ka shtyrë për më vonë shqyrtimin e propozimvendimit për formimin e Komitetit të Auditimit. Draftrregullorja për transparencën komunale është miratuar pa asnjë vërejtje, ndërsa është thënë të jetë hartuar në përputhje me ligjet në fuqi dhe me Statutin e Komunës. Rregullorja synon shtimin e transparencës së legjislativit komunal, ekzekutivit dhe administratës komunale, por edhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumente zyrtare. Anëtarët e KK-së e kanë shqyrtuar dhe miratuar edhe Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën janar - qershor 2011. Raporti

përmban dy pjesë: pasqyrat financiare dhe komentet e shpjegimet. Raporti paraprakisht ishte certifikuar nga Ministria e Financave pasi ishin bërë barazimet e DEFZH-së me Departamentin e Thesarit. Sipas Raportit, buxheti i sivjetmë për periudhën e sipërpërmendur është realizuar në shkallën prej 58,1 %, ndërsa Komuna i ka pasur në dispozicion 3,3 milionë euro nga buxheti aktual në shumë prej 5,7 milionë euro. Gjatë 6-mujorit të parë të vitit janë shpenzuar 1,8 milion euro ose 32,5 % (10,8% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar). Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Finanacave dhe Zhvillimit, ka theksuar se buxheti aktual i rishikuar në shumë prej 5.845.821 eurosh ka shënuar rritje për 930 mijë euro ose 19,6 % në raport me buxhetin fillestar të miratuar (4.754.340 euro). Me kërkesë të grupit parlamentar të AAK-së është debatuar edhe për objektin banesor-afarist në afërsi të QKMF-së në Kaçanik. Z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i ka njoftuar anëtarët e Kuvendit lidhur me realizimin e punimeve në këtë objekt. Ai ka thënë se po zbatohet kontrata, ndërsa punimet po mbikëqyren nga drejtoria që ai e udhëheq. Ndërkaq, nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, ka rikujtuar se 20% e objektit në vijë vertikale është pronë e Komunës. Kryesuesi i Kuvendit, z. Xhelal Gashi, ka deklaruar se nuk ka dilema rreth ligjshmërisë së vendimit për lejimin e ndërtimit të këtij objekti, i marrë më 30.1.2009.



# *GUSHT 2011*

## Të riatdhesuarve u bëhet apel për t'u paraqitur në Komunë

**2 gusht** - Zyra për integrime evropiane (ZIE) në bashkëpunim me Zyrën për kthim dhe komunitete (ZKK) u kanë bërë apel personave të riatdhesuar që të paraqiten në Komunë për t'u njoftuar me të drejtat e tyre dhe mënyrën e integrimit në shoqëri. Koordinatorja për integrime evropiane, znj. Hidajete Guri, ka thënë se të riatdhesuarit mund të paraqiten në ZIE dhe ZKK për t'i marrë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me riintegrimin e tyre. Ajo ka sqaruar se regjistrimi i gjendjes civile dhe i familjes është parakusht themelor për qasjen në kujdesin shëndetësor, punësimin, mirëqenien sociale, pensionin, pronën dhe shërbimet tjera. Sektori i gjendjes civile është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha lindjeve, martesave dhe vdekjeve në regjistrat e gjendjes civile, sikundër edhe për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile për të riatdhesuarit. Pasi të pajisen me këto certifikata, të riatdhesuarit mund të aplikojnë në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil për letërnjoftime dhe pasaporta. Sikurse të gjithë qytetarët tjerë, të riatdhesuarit e gëzojnë të drejtën në kujdesin shëndetësor, qasjen në sistemin arsimor, paraqitjen në Zyrën Komunale të Punësimit, përfshirjen në skemat sociale, zgjidhjen e çështjes së banimit etj. Sipas Zyrës për riintegrim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sivjet, gjatë periudhës janar-mars, janë riatdhesuar 15 persona nga Komuna e Kaçanikut, ndërsa vjet 81.

# LOGOS-i dhe Komuna bisedojnë për ecurinë e projekteve të përbashkëta

**3 gusht** - LOGOS-i dhe Komuna kanë biseduar për ecurinë e zbatimit të projekteve të përbashkëta. Z. Pascal Fendrich, znj.Ermira Salihu dhe znj.Fatime Rrahmani, zyrtarë të LOGOS-it, janë takuar me zyrtarë komunalë nga të cilët kanë marrë informacione për rrjedhën e realizimit të projekteve të përbashkëta. "Sot jemi këtu për të parë nga afër evoluimin dhe zbatimin e projekteve që po i realizojmë në bashkëpunim me Komunën e Kaçanikut", ka thënë z.Fendrich. Ndërkaq, z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i ka njoftuar mysafirët për projektin e ndërtimit të urës mbi lumin Neredime dhe me atë për hartimin e Planit Rregullues Urban për zonën e parë të qytetit që po realizohen në partneritet me LOGOS-in. Drejtori Troni i ka njoftuar zyrtarët e LOGOS-it edhe me ecurinë e zbatimit të projekteve tjera të cilat janë në listë për t'u realizuar sivjet. Ndërsa z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, i ka njoftuar mysafirët lidhur me projektin për gjenerimin e të hyrave dhe botimin e broshurës për buxhetin e Komunës. "Realizimi i këtyre dy projekteve ka prodhuar efekte shumë pozitive", ka thënë ai. Në takim është thënë se LOGOS-i do ta mbështes financiarisht edhe Zyrën e Informimit. "Kjo zyrë do të mbështetet me 2 mijë euro", ka theksuar z.Fendrich.



# Nëntë aplikacione për projektin e "Caritasit" të Luksemburgut

**4 gusht** - Është përmbyllur afati për konkurrim në projektin e "Caritasit" të Luksemburgut për mbështetjen e komuniteteve, ndërsa janë pranuar 9 aplikacione nga komunitetet e Komunës së Kaçanikut. "'Caritasi' i Luksemburgut do t'i shqyrtojë të gjitha aplikacionet e pranuara", ka theksuar znj.Valbona Rexhepi, zv.shefe dhe menaxhere e programit të "Caritasit". Ajo ka shtuar se përfaqësuesit e Komunës së Kaçanikut, sikundër edhe ata të komunave në shënjestër, në gjysmën e dytë të shtatorit do të ftohen të marrin pjesë në komisionin selektues. "Caritasi" i Luksemburgut e ka hartuar një strategji të re të punës për periudhën 2011 – 2013, e cila parasheh mbështetje financiare për 6 komuna. Kaçaniku është pjesë e kësa strategjie. Buxheti për këtë periudhë 3-vjeçare është projektuar në shumë prej 3 milionë eurosh, ndërsa do të mbështeten 3 sektorë: shëndetësia, arsimi dhe gjenerimi i të hyrave. Në një takim të mbajtur më herët me përfaqësuesit e "Caritasit" te Luksemburgut qe thënë se Komuna duhet t'i identifikojë prioritetet në fushat e sipërpërmendura dhe t'i prezantojë projektet, ndërsa mënyra e përzgjedhjes është konkurruese. Z. Gerhard Fischer, shef i misionit, pati thënë se "Caritasi" Luksemburgut e ka miratuar edhe një grant për projekte me komunitete në shumë prej 1,3 milion eurosh, ndërsa do të përfitojnë 4 komunitete nga 6 komunat e rajonit të Gjilanit - përfshirë edhe Kaçanikun.

# DAK dhe GIZ arsimojnë kaçanikasit që e kanë braktisur shkollimin fillor

**4 gusht** - Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës në bashkëpunim me organizatën gjermane GIZ do t'i arsimojnë kaçanikasit që e kanë braktisur shkollimin fillor. "Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe GIZ-ja gjermane janë duke bashkëpunuar për realizmin e projektit: 'Arsimi joformal dhe oferta plotësuese për nxënësit që e kanë braktisur shkollimin e obligueshëm'", ka theksuar z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Ai ka bërë të ditur se udhëheqësi i projektit të sipërpërmendur, z.Robert Kroiss, e ka njoftuar

drejtorin e DAK-së, z.Azem Guri, se GIZ-ja e ka hartuar planveprimin dhe e ka projektuar buxhetin për realizmin e projektit. "Projekti parasheh organizimin e një kursi për ata që e kanë braktisur shkollimin fillor", ka sqaruar z.Dullovi. Është thënë se kursi do të nisë në tetor dhe do të zgjasë disa javë, ndërsa pas përfundimit të tij frekuentuesit do të pajisen me certifikata të cilat do të trajtohen si të barasvlershme me ato të arsimit fillor.



## Kryetarit i dorëzohet raporti i fushatës së korrje-shirjeve

**4 gusht** - Kryetarit të Komunës, z.Xhabir Zharku, i është dorëzuar raporti i fushatës së sivjetme të korrje-shirjeve. Raportin e komisionit komunal për përcjelljen e fushatës kryetarit ia ka dorëzuar z.Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në raport thuhet se në territorin e komunës së Kaçanikut janë korrur gjithsej 610 hektarë me grurë, 13 hektarë me tërshërë dhe 3 hektarë me thekër. Fushata e korrje-shirjeve pati filluar më 9 korrik, ndërsa është përmbyllur më 30 korrik. Të angazhuar në fushatë kanë qenë gjithsej 22 kombajnerë me çmimin prej 100 eurosh për hektar, ndërsa janë subvencionuar nga Ministria e Bujqësisë me 25 % të çmimit të derivateve. Në raport nënvizohet se rendimentet mesatare të

grurit kanë qenë 3.500 kilogramë për hektar, të thekrës 2.600 kg/ha dhe të tërshërës 2.200 kg/ha.

## Kryetari takon futbollistet e KF Kaçanikasja

**9 gusht-** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka takuar futbollistet e KF Kaçanikasja nga Kaçaniku. Klubi i sipërpërmendur e ka fituar turneun tradicional të futbollit “Norway Cup 2011” në Norvegji në të cilin garuan skuadra nga 51 shtete të botës. Kryetari Zharku i ka uruar futbollistet për suksesin e arritur, por edhe i ka inkurajuar që të vazhdojnë me punë e angazhim maksimal drejt sukseseve të reja. "Sivjet kemi ndarë një shumë mjetesh për sportet në komunën tonë, ndërsa gjatë vjetëve në vijim mbështetja do të jetë më e madhe", ka theksuar z. Zharku. Ndërkaq. z.Fatos Vishi, trajner i KF Kaçanikasja, njëherësh këshilltar për rini e spor t i Komunës së Kaçanikut, ka thënë se klubi e ka arritur suksesin e tij më të madh duke u bërë fitues i turneut tradicional “Norway Cup 2011” për

kategorinë e grupmoshave deri në 17 vjet. "Skuadra jonë është pritur nga kryetari i Oslos, pastaj i ka realizuar edhe disa vizita dhe ka marrë pjesë edhe në një turne futbolli në Danimarkë", ka shtuar z.Vishi.



# Kryetari Zharku takon komandantin e KFOR-it

**9 gusht** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka takuar në zyrën e tij kreun e KFOR-it, gjeneralin Erhard Buhler. Temë bosht e bashkëbisedimit Zharku-Buhler ka qenë gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut dhe zhvillimet e fundit në veri të Kosovës. Kryetari Zharku i ka thënë gjeneralit Buhler se gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut është mjaft e mirë. Mysafiri është njoftuar edhe për zhvillimet tjera në komunë. "Ne po mundohemi të bëjmë atë që është më e mira për qytetarët", ka thënë kryetari Zharku. Në këtë kontekst, ai ka folur për realizimin e projekteve infrastrukturore, ndërsa ka nënvizuar se tashmë janë asfaltuar 75 % e rrugëve. "Sivjet jemi fokusuar në realizimin e projekteve në bujqësi. Komuna ka ndarë një grant me të cilin po mbështetet ky sektor. Ideja është që të nxisim zhvillimin e bujqësisë, sepse vlerësojmë se është segment i rëndësishëm i zhvillimit të komunës sonë", ka theksuar z.Zharku. Ai e ka njoftuar komandantin e KFOR-it edhe me mundësitë dhe kapacitetet e zhvillimit të turizmit në komunën tonë. Gjenerali Buhler, pasi e ka përgëzuar kryetarin Zharku për arritjet në të gjitha rrafshet, ka rikujtuar se para 12 vjetësh për herë të parë kishte kaluar nëpër Kaçanik. "Nuk mund të flas për krahasime, sepse tashti 75% e rrugëve janë asfaltuar dhe janë shënuar edhe përparime të tjera", ka theksuar z.Buhler. Gjenerali Buhler dhe kryetari Zharku u janë përgjigjur edhe pyetjeve të gazetarëve në konferencë shtypi. "Në takim me kryetarin Zharku biseduam edhe për gjendjen aktuale në veri të Kosovës, ndërsa qëllimi i vizitës ishte që të marr opinione dhe përshtypje edhe nga përfaqësues politik të pjesës jugore të vendit", u ka thënë gazetarëve



z.Buhler. Gjendjen në veri të vendit ai e ka vlerësuar të qetë, por jostabile. "Natyrisht që kemi tensionime, ndërsa është me rëndësi që situata të kthehet në normalitet dhe që në pjesën veriore të kemi zbatim të ligjit. I falënderoj të gjithë qytetarët e pjesës jugore të cilët kanë shprehur besim në punën e KFOR-it. Porosia ime kryesore është se KFOR-i e ka gjendjen nën kontroll në veri të vendit dhe se qytetarët nuk duhet të brengosen. Unë besoj se do të mbizotërojë mençuria dhe barrikadat do të hiqen. Jam i vendosur që ta zbatojë rendin dhe ligjin edhe në këtë pjesë. Ne qytetarëve paqedashës nuk ua mohojmë të drejtën për të protestuar, mirëpo unë mendoj se organizatorë të këtyre bllokadave në veri janë strukturat kriminale dhe radikale", ka theksuar z.Buhler. Kryetari Zharku dhe gjenerali Buhler e kanë bërë edhe një shëtitje rrugëve të qytetit, ndërsa janë ndalur të vendi ku do të ndërtohet ura mbi lumin Neredime. Gjenerali Buhler më pas e ka pasur një takim me krerët e Stacionit Policor të Kaçanikut.

## Mesazhi i kryetarit për qytetarët me rastin e Ditës së Dëshmorëve

**10 gusht** - "Të nderuar qytetarë të komunës së Kaçanikut, sot është 10 Gushti - Dita e Dëshmorëve të Brigadës 162 'Agim Bjarami' të komunës së Kaçanikut. Kjo është një ditë e veçantë, e skalitur me emrat e heronjve dhe dëshmorëve të brigadës 162 'Agim Bjarami' të cilët e dhanë jetën për liri e pavarësi të vendit tonë. Në këtë ditë kujtojmë me krenari luftën e paepur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kujtojmë rënien e komandantit Agim Bajrami me bashkëluftëtarë e më pas edhe rënien e koman-dantit të brigadës 162 ‘Agim Bajrami’, Qamil Ilazi, dhe rënien e bashkë-luftëtarëve të tyre. Në këtë ditë të veçantë kujtojmë edhe të gjithë dëshmorët e hero-njtë e periudhave më të hershme të cilët luftuan për liri e bashkim kombëtar. Të nderuar qytetarë, 10 Gushti – Dita e Dëshmorëve nuk është vetëm një ditë për t'u kujtuar, por është një ditë që do të reflektojë gjithmonë heroizmin dhe sakrificën - sesi duhet luftuar e flijuar për atdhe e çështjen kombëtare. Lavdi dëshmorëve!"

Me respekt,
Kryetari i Komunës

Xhabir Zharku

# Kurora lulesh për dëshmorët në ditën e tyre

**10 gusht** - Aktivitetet për nder të 10 Gushtit – Ditës së Dëshmorëve të brigadës 162 "Agim Bajrami" kanë nisur me vendosje kurora lulesh te memoriali i Varrezave të Dëshmorëve. Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, më pas kurora lulesh ka vendosur te memoriali i komandantit Agim Bajrami dhe dy bashkëluftëtarët e tij, Besnik Begunca e Xheladin Kurtaj, në fshatin Gabrricë. Kurora lulesh pranë përmendores së komandantit Agim Bajrami dhe dy bashkëluftëtarëve tij kanë vendosur edhe OVL-ja e UÇK-së dhe shumë bashkëluftëtarë e qytetarë tjerë. Në vazhdim kryetari i Zharku me bashkëpunëtorë kurora lulesh kanë vendosur te shtatorja e lapidarit të komandantit Agim Bajrami në qendër të qytetit.



# Përurohen 3 rrugë të asfaltuara me mjete të buxhetit komunal

**10 gusht-** Në Ditën e Dëshmorëve të komunës së Kaçanikut janë përuruar 3 rrugë të asfaltuara me mjete të buxhetit komunal. Janë përuruar: rruga e asfaltuar në lagjet Lamaj, Cakaj dhe Tifeku të fshatit Vataj, ajo në lagjen Kukaj të fshatit Bob dhe rruga "Dëshmorët e Lirisë" në lokalitetin Rakoci të Kaçanikut. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe z.Nebi Lama, kryeplak i lagjes Lamaj, e kanë përuruar rrugën e re të asfaltuar që i lidhë lagjet Lamaj, Cakaj dhe Tifeku me rrugën Doganaj – Glloboçicë. Ndërsa shiritin përurues të rrugës në lagjen Kukaj e kanë prerë kryetari Zharku dhe z.Nazmi Kuka, banor i lagjes, njëherësh kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve. Përurimin solemn të rrugës "Dëshmorët e Lirisë" e kanë bërë kryetari Zharku, z.Ali Brruti, banor i lagjes, dhe znj.Arta Rakoci, bija e dëshmorit Adem Rakoci. "Me asfaltimin e këtyre rrugëve janë krijuar kushte për jetë më të mirë për të gjithë ju, qytetarë të nderuar", ka thënë kryetari Zharku në manifestimet përuruese. Ai u ka thënë qytetarëve të pranishëm se merita e parë për realizimin e këtyre projekteve u takon atyre të cilët e kanë dhënë jetën për lirinë e këtij vendi, e pastaj ju si komunitete. Z. Zharku është zotuar se asnjëherë nuk do të mungojë angazhimi i tij maksimal për krijimin e kushteve sa më të mira për të gjitha komunitetet e komunës sonë. Ai i ka ftuar qytetarët që t'i kryejnë obligimet ndaj Komunës, sepse mjetet e arkëtuara nga tatimpaguesit do t'u kthehen atyre nëpërmjet investimesh me interes për ta. "Patriotizmi ynë dje ishte lufta për çështjen kombëtare, ndërsa



patriotizmi ynë sot është që ne t'i kryejmë obligimet ndaj shtetit", ka deklaruar kryetari Zharku. Rruga e lagjeve Lamaj, Cakaj dhe Tifeku është asfaltuar në gjatësi prej 1.330 metrash, gjerësi prej 4 metrash dhe trashësi prej 11 centimetrash, ndërsa ka kushtuar 90.050 euro. Ajo e lagjes Kukaj është asfaltuar në gjatësi prej 1.185 m, gjerësi prej 4 m dhe trashësi prej 11 cm, kurse ka kushtuar 87.456 euro. Ndërsa rruga “Dëshmorët e Lirisë” është asfaltuar në gjatësi prej 478 m, gjerësi prej 5 m dhe trashësi prej 12 cm, ndërsa ka kushtuar 60.926 euro. Realizimi i 3 projekteve të sipërpërmendura është bërë me mjete të buxhetit komunal.





# Dëshmorët e lirisë përkujtohen edhe me akademi

**10 gusht** – Aktivitetet për shënimin e 10 Gushtit – Ditës së Dëshmorëve të komunës së Kaçanikut janë përmbyllur me akademi përkujtimore në pallatin e kulturës "Xheladin Kurtaj". Në fillim të fjalës së tij të rastit, kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, i ka përshëndetur të gjithë të pranishmit, ndërsa përshëndetje të veçantë i ka bërë nënës së komandantit Agim Bajrami, zonjës Elife, i cili ra heroikisht më 10 gusht 1998, bashkë me bashkëluftëtarët e tij – Besnik Begunca dhe Xheladin Kurtaj. Kryetari Zharku, duke e vlerësuar për qëndrimin e fortë shpirtëror pas rënies së djalit të saj dhe trajtimit si të saj edhe të dëshmorëve të tjerë, nënën e komandantit Agim Bajrami e ka cilësuar si "Nëna e Kaçanikut". "Duke e përshëndetur nënën e dëshmorit Agim Bajrami unë përshëndes edhe të gjitha nënat, nuset, motrat dhe fëmijët e të gjithë dëshmorëve", ka shtuar z. Zharku. Ndërsa duke folur për veprën heroike të dëshmorëve, kryetari ka thënë: "Të gjithë dëshmorët janë vëllezërit dhe prindërit tanë. Ata na e sollën lirinë, ata na mundësuan që ne sot të përurojmë rrugë, të ndërtojmë shkolla të reja, që fëmijët të mësojnë të lirë, të krijojmë institucionet të cilat i meritojmë". Për një zhvillim edhe më të madh të vendit, kryetari Zharku ka bërë ftesë për unitet, vigjilencë,



respekt për lirinë dhe për dëshmorët e familjet e tyre. Një fjalë rasti në akademi e ka mbajtur edhe z. Hajrush Kurtaj, ish-zëvendëskomandant i brigadës 162 "Agim Bajrami" të UÇK-së. "Në këso akademish përkujtimore ne të gjallët i nderojmë të rënët për lirinë tonë, ata të cilët janë bërë pjesë e shenjtë e kujtesës tonë historike", ka thënë z. Kurtaj. Është lexuar edhe telegrami të cilin e kishte dërguar nga Gjermania kryetari i OVL-së të UÇK-së, z. Ejup Runjeva, i cili gjendet për shërim atje. Akademia është përmbyllur me vallen e pavarësisë të cilën e kanë ekzekutuar valltarët e rinj të SHKA"Shqiponja" nga Kaçaniku. Të gjitha aktivitetet për shënimin e 10 Gushtit – Ditës së Dëshmorëve janë mbajtur nën patronazhin e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku.

## Policia dhe inspektorët komunalë në aksion për rregull në trafik

**12 gusht** – Policia Rajonale e trafikut të Ferizajt dhe inspektorët komunalë e kanë zhvilluar një aksion të përbashkët për vendosjen e rregullit në trafik. Aksioni është zhvilluar në kuadër të zbatimit të Planit operativ për kontroll në transportin publik. Janë inspektuar operatorët taksi dhe vendparkimet ilegale në hapësirat publike në territorin e Komunës së Kaçanikut. Mendu Krasniqi, shef i sektorit të shërbimeve publike dhe z.Besim Sallahu, inspektor komunal i trafikut, kanë thënë se shofe-rët e pakujdes-shëm janë ndë-shkuar me gjoba mandatore. Plani operativ për kontroll në transportin publik ka filluar të zbatohet më 20 qershor, ndërsa do të zgjasë 3 muaj.



# Ekipi ndërministror takon zyrtarët komunalë përgjegjës për të riatdhesuarit

**12 gusht** - Zbatimi i obligimeve të Komunës që dalin nga Strategjia dhe Plani i veprimit për riintegrimin në shoqëri të personave të riatdhesuar dhe vlerësimi i kapaciteteve të administratës komunale për përmbushjen e tyre, kanë qenë tema të bashkëbisedimit ndërmjet përfaqësuesve të Ekipit vlerësues ndërministror dhe zyrtarëve komunalë. Në takim kanë marrë pjesë edhe zyrtarë të Qendrës Komunale të Regjistrimit Civil, të Qendrës së Punës Sociale dhe të Zyrës Komunale të Punësimit. Ekipi ndërministror përfaqësohej nga z.Sylë Sefaj, këshilltar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe z.Artan Qollaku, zyrtar i lartë në Ministrinë e Integrimeve Evropiane. Takimi i Ekipit ndërministror me zyrtarët përgjegjës komunalë ishte edhe në funksion të koordinimit të aktiviteteve ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal për krijimin e parakushteve për përfshirjen e Kosovës në dialogun formal për liberalizim vizash me vendet e Bashkimit Evropian. Është propozuar themelimi i një ekipi komunal për zbatimin e obligimeve të Komunës që dalin nga Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar.



# Zëvendëskryeministri Kuçi mbështet punën e kryetarit Zharku

**15 gusht** - Zëvendëskryeministri i Kosovës, z.Hajredin Kuçi, i ka dhënë mbështetje punës së kryetarit të Komunës, z.Xhabir Zharku, gjatë vizitës që i ka bërë Kaçanikut. "Sot jam këtu, në Kaçanik, për të mbështetur punën tuaj të përkushtuar edhe përkundër presioneve dhe vështirësive që i keni. Qëllim i vizitës është që të mbështes punën tuaj edhe në emër të Qeverisë", ka deklaruar z.Kuçi në takimin me kryetarin Zharku. Pasi është falënderuar për vizitën, mysafiri është njoftuar nga nikoqiri për punët dhe angazhimet e pushtetit lokal në funksion të avancimit të shërbimeve për qytetarët dhe krijimit të kushteve për jetë sa më të mirë për të gjithë banorët e komunës. Kryetari e ka njoftuar z. Kuçi edhe me disa nga vendimet që i ka marr Komuna - atë për ndalimin e disa lojërave të fatit, vendimin për shkëputjen e kompanisë së ujit dhe kanalizimit "Lypeteni" nga kompania rajonale "Bifurkacioni", me seli në Ferizaj etj. "Tashti furnizimi me ujë është



përmirësuar dukshëm. Arkëtimi po bëhet në shkallën prej rreth 90 %, sepse qytetarët janë të kënaqur me shërbimet e ofruara", ka thënë z.Zharku. Kryetari e ka njoftuar zv.kryeministrin edhe me disa nga shqetësimet e ekzekutivit komunal. "Çështja e rrëshqitjes së dheut në lagjen 'Ramadan Agushi' ende nuk është zgjidhur. Ne e kemi prezantuar kërkesën te Qeveria dhe po presim ndihmën tuaj", i ka thënë kryetari z. Kuçi. Ndërsa e ka marrë premtimin se për këtë çështje Qeveria do të ndajë mjete nga fondi rezervë. "Ne duam që premtimet tona t'i realizojmë", është shprehur z. Kuçi, duke u përgjigjur në kërkesën e kryetarit për mbështetje të investimeve kapitale nga grantet qeveritare. Kryetari Zharku ka kërkuar që të ketë bashkëpunim më të ngushtë në relacionin pushtet lokal – ministri, ndërsa mysafiri e ka siguruar atë se ky bashkëpunim nuk do të mungojë. "Çdoherë do të jenë dyert e hapura, nga ajo e zyrës së kryeministrit e deri te ato të ministrive", është shprehur z. Kuçi. Zv.kryeministri Kuçi ka rikujtuar se gjatë këtij mandati qeverisës do të nisë edhe ndërtimi i autostradës Prishtinë-Han i Elezit e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit dhe të komunës së Kaçanikut.

## Lepenci debuton me fitore në Superligë

**21 gusht** - KF Lepenci e ka nisur mbarë debutimin në Superligën e Kosovës. Ka shënuar fitore minimale 1:0 ndaj të Gjilanit në xhiron e parë. Golin për Lepencin e ka shënuar futbollisti i ardhur nga Shqipëria, elbasanasi Besmir Xhika, në minutën e 38-të. Ai e ka shfrytëzuar shtatlartësinë e tij, duke u treguar më efikas se portieri mysafir në dyluftimin në ajër. Për shkak se stadiumi "Besnik Begunca" ende nuk i plotëson kushtet për ndeshjet e Superligës, Lepenci ndeshjen me Gjilanin e ka zhvilluar në stadiumin "Ismet Shabani" në Ferizaj. Zyrtarë të klubit kanë thënë se punimet për aftësimin e stadiumit "Besnik Begunca" sipas standardeve të Superligës do të përmbyllen para ndeshjes së dytë të Lepencit si vendës, kundër Prishtinës.

# Dyzet blegtorë përfitojnë nga një aparat për mjelje lopësh

**24 gusht** - Kemajl Teneqja, nga fshati Stagovë, është njëri nga 40 fermerët që janë përzgjedhur nga Komuna për t'u pajisur me aparate për mjelje lopësh. Përfituesit e aparateve i ka përgëzuar edhe nënkryetari i Komunës, z.Heset Loku. Vlerësohet se në komunën e Kaçanikut ekzistojnë 125 fermerë me më shumë se 5 lopë qumështore, ndërkohë që për të përfituar nga ky donacion



kishin aplikuar 62 sish. Krahas donacionit për furnizimin me serra, kjo është përkrahja e dytë që u bëhet fermerëve kaçanikas sivjet. z.Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka rikujtuar se është 100 mijë euro vlera e subvencioneve të Komunës për fermerët sivjet.

# Nis ndërtimi i urës mbi lumin Neredime

**26 gusht**- Kanë nisur punimet për ndërtimin e urës mbi lumin Neredime që do të ndërtohet përskaj "Urës së Konakut". Ky projekt është duke u financuar nga programi i Qeverisë zvicerane: "Përkrahja e qeverisjes lokale dhe decentralizimit"- LOGOS dhe Komuna e Kaçanikut. LOGOS-i i ka alokuar 50

mijë euro, ndërsa Komuna 27.602 euro. Z. Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës, ka theksuar se ura do të jetë e gjatë 17 metra, e gjerë 6 metra dhe në të dyja anët do të ketë nga një shteg për këmbësorë me gjerësi prej 1,65 metra.

## Urimi i kryetarit për Fitër Bajramin

29 gusht - "Qytetarë të nderuar, vëllezër e motra,
Kam kënaqësinë që në emrin tim dhe të administratës komunale të ju uroj festën e Fitër Bajramit dhe bashkë me ju të ndajë gëzimin dhe dashurinë që sjell për ne kjo festë e madhërishme. Uroj që ditët e Festës t'i kaloni sa më mirë, në mesin e më të dashurve tuaj. Fitër Bajrami është festë e paqes, solidaritetit dhe harmonisë për të gjithë besimtarët myslimanë dhe na vjen pas shumë ditësh agjërimi, përkushtimi dhe falënderimi ndaj Krijuesit, duke ngjallur midis njerëzve ndjenjën fisnike të mbështetjes dhe solidaritetit vëllazëror. Edhe me këtë rast kujtojmë të gjithë ata që u sakrifikuan për lirinë e Kosovës, të gjithë dëshmorët, ata që dhanë më të shtrenjtën, jetën e tyre, që ne të festojmë sot të lirë. Në veçanti i uroj dhe i përgëzoj familjet e dëshmorëve, që edhe në këto ditë feste të ndihen krenarë për gjakun e derdhur të më të dashurve të tyre që solli lirinë dhe pavarësinë e Kosovës".

Me respekt,
Xhabir Zharku,
Kryetar i Komunës

# Mesazh urimi i kryetarit me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor

**31 gusht** - "Të dashur nxënës, të nderuar arsimtarë, personel teknik e prindër,

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emrin tim dhe të gjithë qytetarëve të komunës së Kaçanikut të ju uroj për fillimin e vitit të ri shkollor 2011/2012. Nesër, një armatë e tërë nxënësish, pas pushimeve verore, do t'u rikthehen bankave shkollore për ta vazhduar betejën e madhe për thellimin dhe nxënien e njohurive të reja në institucionet tona arsimore. Mësuesit meritojnë mirënjohje për punën e palodhshme që po e bëjnë, për misionin e tyre fisnik në edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj. Jam i bindur se edhe me përkrahjen e institucioneve qendrore do t'i arrijmë synimet tona të përbashkëta për ngritjen e mëtejme të sistemit arsimor në përgjithësi. Në veçanti i uroj dhe i përgëzoj nxënësit e klasave të para duke iu dëshiruar hyrje të suksesshme në botën e madhe të diturisë. Uroj që edhe ky vit shkollor të jetë vit i mbarë dhe i sukseseve të përbashkëta".

Përzemërsisht,
Kryetari i Komunës,
Xhabir Zharku

# SHTATOR 2011

## Nis mbarë viti shkollor 2011/2012

**1 shtator** - Procesi mësimor ka nisur mbarë në të gjitha shkollat e komunës së Kaçanikut. Gëzimin dhe emocionet e ditës së parë të shkollës më nxënësit dhe arsimtarët i kanë ndarë nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, z. Azem Guri. Ata janë takuar me nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës 9-vjeçare "Agim Bajrami" në fshatin Stagovë dhe me ata të gjimnazit "Skënderbeu" në Kaçanik. Drejtori i shkollës "Agim Bajrami", z. Xhelal Mani, u ka thënë mysafirëve se çdo gjë ka qenë e gatshme për fillimin e vitit të ri shkollor 2011/'12. Njëjtë është shprehur edhe drejtori i gjimnazit "Skënderbeu", z. Ibush Vishi. Drejtori Vishi ka shtuar se është bërë edhe sistemimi i nxënësve në 8 paralelet e klasave të dhjeta, në 2 paralelet e drejtimit matematikë–informatikë, në 3 paralele të drejtimit të shkencave natyrore dhe në 3 paralele të drejtimit të shkencave shoqërore.



Procesi mësimor në komunën e Kaçanikut zhvillohet në 4 nivele arsimore: në atë parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë - në gjithsej 12 shkolla amë 9-vjeçare dhe 15 paralele të ndara fizike, pastaj në 2 shkolla të mesme dhe në 1 qendër të edukimit parafillor. Numri i përgjithshëm i nxënësve në këtë vit shkollor është rreth 8 mijë e 200 (rreth 500 në ciklin parafillor, 5 mijë e 800 në atë 9-vjeçar dhe rreth 1 mijë e 850 në atë të mesëm). Sivjet, për herë të parë në bankat e shkollave fillore janë ulur rreth 550 nxënës të klasave të para.

## Kryetari inspekton rrjedhën e punëve në 3 projekte infrastrukturore

**6 shtator** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Bekim Troni, dhe menaxheri i projekteve, z. Fatos Koxha, i ka inspektuar punimet për realizimin e 3 projekteve infrastrukturore. "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Gajre", "Ndërtimi i urës mbi lumin Neredime" dhe "Rregullimi i



gjelbërimit në rrugën 'Ismail Raka'", kanë qenë në fokusin e interesimit të kryetarit Zharku. Projekti në Gajre parasheh ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës në gjatësi prej 2 mijë metrash dhe gjerësi prej 5 metrash, sikundër edhe ndërtimin e bankinave në të dyja krahët e saj me gjerësi prej 0,50 metrash. Trashësia e shtresës së asfaltit do të jetë 7 cm, ndërsa do të vendosen edhe mbrojtëset metalike. Për realizimin e këtij projekti Komuna i ka alokuar 134 mijë e 370 euro. Kryetari Zharku nga afër e ka përcjellur edhe betonimin e themeleve të urës mbi Neredime. Ura do të ndërtohet në gjatësi prej 17 metrash dhe gjerësi prej 6 metrash, plus shtegu për këmbësorë në gjerësi 3,30 metrash. Ky projekt i kontraktuar në shumë prej 77 mijë e 602 eurosh është duke u realizuar me bashkëfinancim të LOGOS-it dhe Komunës së Kaçanikut. Projekti LOGOS i Qeverisë zvicerane i ka alokuar 50 mijë euro, ndërsa Komuna 27 mijë e 602 euro. Kryetari Zharku dhe shoqëruesit e tij e kanë vizituar edhe vendpunishten në rrugën "Ismail Raka" ku aktualisht është duke u realizuar projekti për rregullimin e gjelbërimit. Projekti parasheh vendosjen e dheut cilësor dhe mbëltimin e palmave të llojit "Bismarckia nobilis" të cilat janë të rezistueshme në temperatura të ulëta. Përveç palmave do të mbëltohen edhe pisha dhe barë slloven, ndërsa do të ndërtohen edhe minikopshte. Gjelbërimi do të bëhet në tëre gjatësinë e rrugës prej 892 metrash, ndërsa pjesë e projektit është edhe instalimi i sistemit të ujitjes për hapësirën e gjelbëruar. Për realizimin e këtij projekti Komuna i ka alokuar 66 mijë e 573 euro.

## Komisioni Evropian - 74.233 euro për Kaçanikun

**7 shtator** - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Prishtinë ia ka alokuar Komunës së Kaçanikut 74.233 euro nga programi "Kosova e bukur". Ndërsa kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka nënshkruar vendimin për realizimin e projektit me mjetet e dhuruara. Projekti parasheh ndërtimin e shëtitores në krahun e majtë të lumit Neredime, pastaj gjelbërimin e hapësirave publike para shumëkatësheve përballë Stacionit të Autobusëve dhe ndërtimin e një parkimi për automjete në afërsi të lumit Lepenc. Për realizimin e këtij projekti Komuna do të participojë me 5 % të shumës së kontraktuar. Programi "Kosova e bukur" financohet nga BE-ja, menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian dhe zbatohet nga Organizata

Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në partneritet me Këshillin Danez për Refugjatë (DRC). Projekti ka për qëllim promovimin e mundësive të reja të punësimit dhe përmirësimin e infrastrukturës urbane në Kosovë, ndërsa do të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe sociale në komunë përmes gjenerimit të mundësive për punësim në kompanitë publike lokale dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

## Përurohet stadiumi i rinovuar i Lepencit

**7 shtator** - Para ndeshjes Lepenci-Prishtina është bërë përurimi i stadiumit të rinovuar "Besnik Begunca". Panon e dëshmorit Besnik Begunca, emrin e të cilit e mban stadiumi i qytetit në Kaçanik, e kanë shpalosur kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, dy vajzat e dëshmorit, Eljesa dhe Blendina, dhe dy përfaqësues të "Fikshave". Ndërsa prerjen e shiritit përurues të objektit të ri të teshatores e kanë bërë kryetari Zharku, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, z. Fadil Vokrri, dhe kryetari i KF Lepenci, z. Saqip Berisha. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka dhuruar një mirënjohje z.Vokrri. Në fjalën e tij të rastit, kryetari Zharku ka theksuar se stadiumi ynë e mban emrin e dëshmorit Besnik Begunca, kurse ky fakt ne na bën të ndjehemi krenarë.



"Dëshmorët flijuan jetët e tyre për lirinë që po e gëzojmë ne sot", ka theksuar ndër të tjera kryetari Zharku. Ai u ka bërë ftesë futbollistëve për lojë fer, ndërsa "Fikshave" për anim korrekt. Të pranishmit i ka përshëndetur edhe z.Vokrri. Projekti për rinovimin e stadiumit të qytetit e ka përfshirë ndërtimin e objektit të ri të teshatores, ndërtimin e murit rrethues në gjatësi prej 70 metrash, zgjerimin e fushës së futbollit dhe vazhdimin e ndërtimit të ulëseve. Për realizimin e këtij projekti Komuna e Kaçanikut i ka dhënë 30 mijë euro, ndërsa kanë ndihmuar edhe bizneset lokale.

## Lepenci zhvillon ndeshjen e parë në stadium të vet

**7 shtator** - KF Lepenci e ka zhvilluar ndeshjen e parë në stadiumin e rinovuar "Besnik Begunca" në kuadër të garave të Raiffeisen Superligës. Rrokullisjen e parë simbolike të topit e kanë bërë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, dhe kryetari i FFK-së, z. Fadil Vokrri. Ndeshja ndërmjet Lepecit dhe Prishtinës është përmbyllur me fitoren e mysafirëve (0:2). Ndeshja ishte fer, ndërsa tifozët e Lepencit "Fikshat" krijuan atmosferë impozante në stadium. Animi i tyre ishte tejet korrekt.



# Mbahet dëgjimi i dytë publik për draftbuxhetet e viteve 2012-2014

**9 shtator** - Në funksion të informimit dhe pjesëmarrjes së gjerë dhe aktive të publikut e në pajtim me legjislacionin në fuqi, në pallatin e kulturës "Xheladin Kurtaj" Komuna e ka organizuar debatin e dytë publik me qytetarë me temë: "Draftbuxhetet e Komunës për vitet 2012 – 2014, me theks të veçantë për atë të 2012-s". Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ka saktësuar së buxheti i planifikuar për vitin 2012 është projektuar në shumë prej 5 milionë e 457 mijë e 755 eurosh. Ai ka sqaruar se në totalin e buxhetit granti qeveritar kontribuon me 4.864.625 euro (89,1%), ndërsa të hyrat vetjake me 593.130 euro (9%). Për paga dhe mëditje do të shpenzohet 68,9 % e buxhetit (3.761.520 euro), për investime kapitale 21,6% (1.180.190 euro), për mallra dhe shërbime 7,4% (402.045 euro), për shpenzime komunale 1,5 % (84.000 euro) dhe për subvencione e transfero 0,5% (30.000 euro). Sipas planifikimit, buxhetet në tri vitet e ardhshme do të kenë rritje prej 5 – 6,2 %. Buxheti i 2012-s është projektuar në shumë prej 5.457.755 eurosh, ai i 2013-s në shumë prej 5.529.000 eurosh dhe ai i 2014-s në shumë prej 5.574.174 eurosh. Me pyetjet dhe propozimet e tyre qytetarët e pranishëm i kanë kontribuar shtjellimit të temës së debatit. Një qytetar ka kërkuar të dijë se a është paraparë fond për dhënie bursash studentëve



të dalluar, ndërsa Azem Guri, drejtori Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, ka rikujtuar se komunat janë përgjegjëse vetëm për ciklet parafillore, fillore dhe të mesme të arsimit. "Komuna është duke investuar në transportin e nxënësve skamnorë të shkollave të mesme", ka theksuar z.Guri. Nexhadi Luta, qytetar nga fshati Ivajë, ka kërkuar të dijë se a është paraparë fond për intervenime në situata emergjente, ndërsa ka marrë përgjigje negative. "Komunave nuk u lejohet themelimi i fondeve të tilla", ka theksuar z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Në këtë kontekst, ai ka shtuar se Komuna ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të intervenojë nga fondi i saj rezervë për stabilizimin e sipërfaqes së përfshirë nga rrëshqitja e dheut në lagjen "Ramadan Agushi" dhe për sanimin e dëmeve të shkaktuar nga stuhia me shi e breshër e qershorit të sivjetmë. Z.Shukri Luta, këshilltar komunal, është shprehur i pakënaqur me lartësitë e buxheteve të planifikuara. Ai ka thënë se është e pamjaftueshme edhe shuma e planifikuar për investime kapitale. Znj. Sevdije Frangu, anëtare e Kuvendit Komunal, ka kërkuar të dijë se a janë alokuar mjete për vazhdimin e ndërtimit të Varrezave të Dëshmorëve. "Sivjet janë alokuar 50 mijë euro për Varrezat e dëshmorëve, ndërsa projekti është në fazën e tenderimit", i ka thënë asaj z.Vërbani. Znj.Arlinda Çaka, përfaqësuese e Ambientalistëve të Rinj, është interesuar për fondet për rininë; qytetari Fisnik Zharku për të hyrat vetjake sivjet, ndërsa z.Gajur Leka, nga Glloboçica, ka theksuar se do të ishte mirë që debate me qytetarë të organizohen edhe nëpër fshatra. Qytetarët kanë bërë kërkesa edhe me shkrim për përfshirje projektesh të reja kapitale në buxhet. "Të gjitha kërkesat e bëra do të merren në shqyrtim, ndërsa në listën aktuale janë përfshirë 60 projekte kapitale", ka thënë drejtori Vërbani.

## Kryetari takon zëvendësministrin e MPB-së

**12 shtator** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka pasur një takim pune me zëvendësministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, z.Izmi Zeka, dhe z.Arben Kalaja, drejtor i Departamentit të Qeverisjes të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, ndërsa është biseduar për nevojën e themelimit të Zyrës për kthim dhe komunitete (ZKK). Kryetari Zharku ua ka sqaruar mysafirëve se ZKK-ja nuk është themeluar deri tashti për mungesë buxheti, ndërsa ka nënvizuar se punët në këtë rrafsh nuk kanë ngecur pasi janë kryer

nga dy zyrtarë komunalë - ai për kthim dhe komunitete dhe koordinatorja për integrime evropiane. Zëvendësministri Zeka ka thënë se themelimi i ZKK-ve është njëri nga standardet e parapara për plotësim në procesin e liberalizimit të vizave.



## Nis "Java e Rinisë së Kaçanikut"

**14 shtator** - Me moton: "Kosova është e re", kanë nisur aktivitetet e parapara në kuadër të "Javës së Rinisë të Kaçanikut". Këto aktivitetete do të organizohen nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Këshilli i Veprimit Rinor Lokal në Kaçanik, ndërsa do të mbështeten nga OSBE-ja dhe USAID-i. Në aktivitetin e parë të zhvilluar, Grupi i Ambientalistëve të Rinj e ka organizuar një aksion pastrimi të hapësirave përreth Pallatit të Kulturës dhe një pjesë të rrugës "Ismail Raka". Këtij aksioni i janë bashkëngjitur edhe disa pjesëtarë të KFOR-it, të cilët së bashku me ambientalistët pastruan edhe disa pjesë të qytetit. Përmes këtij aksioni, grupi i ambientalistëve ka shpërfaqur synimin që të krijojë një mjedis të pastër në hapësirat ku gravitojnë të rinjtë, siç është Pallati i Kulturës, pastaj të sensibilizoj opinionin për dëshirën e të rinjve për një mjedis të pastër për mësim, punë e argëtim.

# Kuiz për demokracinë sot e çdo ditë

**15 shtator** - Në pallatin e kulturës "Xheladin Kurtaj" është mbajtur kuiz diturie mes ekipesh të dy shkollave të mesme të Kaçanikut me temë: "Demokracia sot dhe çdo ditë". Ndërsa fitues është shpallur ekipi i shkollës së mesme profesionale "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka", i cili për një nuancë u tregua më i mirë se ekipi i gjimnazit "Skënderbeu". OSBE-ja i ka shpërblyer me komplete librash të dy shkollat, ndërsa e ka financuar edhe një koktej rasti. Z. Jeton Lika, zyrtar i Zyrës së OSBE-së në Kaçanik, i ka inkurajuar të rinjtë që të punojnë për një shoqëri demokratike, të hapur e tolerante. Kuizi është organizuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, ndërsa është mbajtur në kuadër të aktiviteteve për shënimin e "Javës së Rinisë së Kaçanikut".



# Kryetari kërkon nga MKRS-ja mbështetje financiare për projektet e Komunës

**15 shtator** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, është takuar me zëvendësministrin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sporteve, z. Hajdin Abazi, ndërsa kanë biseduar për nevojat dhe kërkesat e Komunës së Kaçanikut për mbështetje të projekteve në sferën e sporteve, të kulturës dhe atë të trashëgimisë kulturore. Kryetari Zharku i ka thënë mysafirit se pas inkuadrimit në Superligën e Kosovës, KF Lepenci ka nevojë të ngutshme për rinovimin e stadiumit. "Ne i kemi bërë disa rinovime të domosdoshme, por ka ende shumë për t'u bërë. Ne kemi nevojë për mbështetje financiare nga niveli qendror meqë buxheti ynë është i limituar", ka theksuar z. Zharku. Kryetari Zharku ka kërkuar mbështetje financiare nga MKRS-ja edhe për 2 festivalet tradicionale që organizohen në Kaçanik - festivalin e fëmijëve dhe atë të shoqërive dhe ansambleve kulturore-artistike "Kaçaniku". Kryetari Zharku e ka artikuluar edhe kërkesën për ndërtimin e një palestre sportesh në Kaçanik, ndërsa ka kërkuar mbështetje edhe për projektet për rininë dhe ato për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Ndërkaq, zëvendësministri Abazi ka deklaruar se të gjitha nevojat dhe kërkesat e Komunës suaj do t'i përcillen ministrit të MKRS-së, z. Memli Krasniqi. Ai ka nënvizuar se nuk do të mungojë angazhimi i tij për përkrahjen e projekteve të Komunës së Kaçanikut. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, z. Azem



Guri, i cili ishte i pranishëm në takim, ka thënë se ne edhe në të kaluarën ia kemi përcjellur MKRS-së projektet që kanë nevojë për mbështetje, ndërsa do t'i përcillen kërkesat me projektet e specifikuara edhe për vitin 2012.

## OSBE-ja dhuron libra për bibliotekën publike

**16 shtator** – OSBE-ja ia ka dhuruar një numër librash bibliotekës publike të qytetit në kuadër të zbatimit të projektit: "Biblioteka, vendi për të gjithë". Z.Ulrich Biffar, drejtor rajonal i OSBE-së, librat në vlerë prej 500 eurosh ia ka dorëzuar z. Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës. Gjatë këtij aktiviteti janë deklamuar edhe poezi nga letrarët e rinj të Kaçanikut, ndërsa piktorët e rinj përmes punimesh të tyre kanë dhënë mesazhe për rëndësinë e librit. Znj.Fatlume Guri, koordinatore e Grupit të Ambientalistëve të Rinj, një pikturë të punuar nga piktorët e rinj ia ka dhuruar z. Biffar. Drejtori rajonal i OSBE-së, z. Biffar, është shprehur të jetë impresionuar me tërë atë që ka parë e dëgjuar. Ai ka thënë se OSBE-ja do t’i shikojë mundësitë për të mbështetur aktivitetet e të rinjve kaçanikas edhe në të ardhmen. Aktivitetet e sipërpërmendura janë mbajtur në kuadër të shënimit të "Javës së Rinisë të Kaçanikut".



# Urologët e Kosovës mbajnë sesion shkencor në Kaçanik

**16 shtator** – Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Urologëve, Shoqata e Urologëve të Kosovës (SHUK) e ka mbajtur një sesion shkencor në Kaçanik. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka falënderuar SHUK-në që e ka përzgjedhur Kaçanikun për mbajtjen e sesionit, ndërsa pjesëmarrësve u ka dëshiruar punë të mbarë. "Shëndeti është mbi të gjitha, prandaj besoj se edhe temat që do të trajtohen këtu do të kontribuojnë në thellimin e njohurive të reja në fushën tuaj", u ka thënë të pranishmëve kryetari Zharku. Urologët i kanë trajtuar dy tema: "Tumori i testisit" dhe "Tumoret e veshkave". Kryetari i SHUK-së, prof.dr.Lutfi Dervishi, e ka falënderuar kryetarin e Komunës për mbështetjen e sesionit dhe praninë e tij në të. Shoqata e Urologëve të Kosovës vepron në kuadër të Shoqatës se Urologëve të Evropës. Organizimin e sesionit shkencor në Kaçanik e kanë mundësuar Komuna e Kaçanikut dhe mr.sci.Xhevdet Çuni, urolog nga Kaçaniku.



## LOGOS-i dhe Komuna firmosin marrëveshjen për mbështetjen e Zyrës së Informimit

**19 shtator** – Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, dhe menaxheri i projektit LOGOS, z. Norbert Piljs, në Novobërdë, e kanë nënshkruar marrëveshjen për mbështetjen financiare të Zyrës së Informimit të KK të Kaçanikut. Sipas marrëveshjes së firmosur, projekti Zvicër-Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim – LOGOS, do të bëjë transferin e shumës prej 2 mijë eurosh në buxhetin e Komunës së Kaçanikut për mbështetjen e aktiviteteve në fushën e informimit publik. Në dokumentin e firmosur janë specifikuar kushtet dhe llojet e aktiviteteve për të cilat mund të shpenzohen paratë e dhuruara.



## Përmbyllet "Java e Rinisë së Kaçanikut"

**19 shtator** - Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, i ka shpallur të hapura aktivitetet e ditës përmbyllëse të "Javës së Rinisë së Kaçanikut", ndërsa i pranishëm ka qenë edhe zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sporteve, z.Hajdin Abazi. Pasi i ka përgëzuar të rinjtë për aktivitetet e zhvilluara, kryetari Zharku u ka thënë atyre se janë bërë sakrifica të mëdha që ju sot të jeni të lire të punoni, të veproni dhe të zhvilloni talentet tuaja. "Ne në rininë tonë kishim angazhime të tjera, ndërsa sot falë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë krijuar kushte që të rinjtë të afirmohen e



prosperojnë lirshëm në të gjitha fushat", ka nënvizuar z.Zharku. Ndërkaq, zv.ministri Abazi u ka thënë të rinjve se lufta jonë dje ishte luftë me pushkë, ndërsa lufta e juaj sot është luftë për dije. Në ditën përmbyllëse të javës së tyre, të rinjtë kanë zhvilluar aktivitetet të shumta kulturore, sportive dhe argëtuese. Këto aktivitete janë organizuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Këshilli Rinor i Veprimit Lokal (KRVL).

## Mbahet takimi i Këshillit Koordinues të LOGOS-it

**20 shtator** - Në Novobërdë është mbajtur takimi i Këshillit Koordinues të projektit Zvicër–Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS, në të cilin krahas përfaqësuesve të Ministrisë së Pushtetit Lokal, Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Zyrës për Bashkëpunim të Zvicrës në Kosovë, kanë marrë pjesë edhe kryetarët apo nënkryetarët e komunave partnere nga Novobërda, Kaçaniku, Kamenica, Ranillugu, Parteshi, Kllokoti, Vitia e Hani i Elezit. Udhëheqësja e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim, znj.Marie Marchand, ka thënë se bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet projektit LOGOS dhe komunave partnere në realizmin e projekteve të ndryshme është i një rëndësie të veçantë për implementimin e projekteve të ndryshme që janë në interes të qytetarëve dhe në këtë drejtim këto takime i ndihmojnë zbatimit më me sukses të këtyre projekteve. Kurse zëvendësministri i Pushtetit Lokal, z.Basri Musmurati, e ka vlerësuar lartë bashkëpunimin e LOGOS-it me komunat, duke potencuar se përmes projekteve të përbashkëta që po realizohen komunat po përfitojnë projekte për qytetarët e tyre. Ai ka kërkuar nga komunat një angazhim edhe më të shtuar që projektet që

implementohen në bashkëpunim me LOGOS-in të realizohen me sukses. Ndërsa z.Norbert Piljs, koordinator i projektit LOGOS, ka thënë se në fazën e dytë të këtij projekti komunat partnere po ndihmon në hartimin e planeve zhvillimore komunale dhe urbane, planet rregullative, në rritjen e shkallës së arkëtimi të të hyrave vetjake, hartimin e rregulloreve për qeverisje në nivel nënkomunal, barazi gjinore, ngritje të kapaciteteve për zyrat e informimit publik, planifikim të buxhetit, menaxhim të mbeturinave të ngurta, operacionalizim të zyrave pritëse si dhe përmes fondit investiv në projekte të ndryshme të infrastrukturës. Përfaqësuesit e komunave partnere kanë thënë se për komunat që përfaqësojnë është shumë me interes bashkëpunimi me LOGOS-in, pasi ky projekt po ndihmon si në ngritje të kapaciteteve humane të komunave ashtu edhe në projekte investive. Z.Heset Loku, nënkryetar i Komunës së Kaçanikut, ka thënë se në bashkëpunim me projektin LOGOS është bërë një punë e mirë në komunën e Kaçanikut, pasi krahas planifikimit të buxhetit, ku është shënuar një pjesëmarrje e lartë e qytetarëve, ky projekt ka ndihmuar edhe në regjistrimin e pronave të reja ku janë arritur rezultate inkurajuese si dhe në projekte tjera.

## Maturantët - ekskursion në Shqipëri

**21 shtator** - Gjithsej 180 maturantë të gjimnazit "Skënderbeu" dhe 150 të shkollës së mesme profesionale "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka", të shoqëruar nga mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, kanë udhëtuar për ekskursion 5-ditor në Shqipëri. Ekskursioni është organizuar nga drejtoritë e shkollave në përputhje me udhëzimin administrativ të MASHT-it. Maturantët do të vizitojnë Durrësin, Tiranën, Krujën, Lezhën dhe Vlorën. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, z. Azem Guri, u ka dëshiruar maturantëve qëndrim të këndshëm në Shqipëri.

## Mbahet panairi tradicional i gjedhit "Kaçaniku 2011"

**25 shtator** - I organizuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në fshatin Koxhaj është mbajtur panairi i gjedhit "Kaçaniku 2011", i treti radhazi. Z.Nuhi Provoliu, drejtor i DBPZHR-së, e ka shpallur të hapur panairin. Në fjalën e tij të rastit, drejtori Provoliu i ka inkurajuar fermerët që edhe në të ardhmen të kultivojnë sa më shumë gjedhe të racës produktive.

Ndërkaq, prof.dr.Hajrip Mehmeti, profesor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës, ka thënë se të gjitha kafshët e ekspozuara janë elitare. Z. Bajram Imeri, drejtor i Departamentit të Blegtorisë të MBPZHR-së, ka theksuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe mot do ta mbështesë sektorin e blegtorisë duke subvencionuar lopët qumështore, mështqerrat dhe kafshët e imta. Fituesit e panairit i ka përzgjedhur komisioni vlerësues në përbërje: prof.dr.Hajrip Mehmeti, z.Bajram Ymeri dhe z.Florim Shabani, zyrtar i MBPZHR-së. Në konkurrencën e racës produktive vendi i parë i ka takuar lopës së fermerit Muharrem Deda, vendi i dytë asaj të Mustafë Lamës, ndërsa vendi i tretë i ka takuar lopës së fermerit Kurtish Baftiu. Në konkurrencën e racës vendore "Metis", vendi i parë i ka takuar lopës së pronarit Imri Selimi, vendi i dytë asaj të Gani Koxhës, kurse i treti lopës së pronarit Flamur Berisha. Në konkurrencën e mëshqerrave, më e mirë është zgjedhur ajo e pronarit Nejazi Sopa, vendi i dytë i ka takuar mëshqerrës së fermerit Qefser Sopa, ndërsa në vendin e tretë është radhitur ajo e fermerit Sabri Mani. Në kategorinë e demave, vendi i parë i ka takuar atij të fermerit Muharrem Deda, vendi dytë demit të Osman Dedës, ndërsa vendi i tretë demit të pronarit Mustafë Gabrrica. Vendet e para janë shpërblyer me nga 200 euro, vendet e dyta me nga 100 euro, kurse vendet e treta me nga 50 euro. Është përzgjedhur edhe tufa më e mirë e deleve prej 10 krerësh dhe deshët me të mirë. Tufë më e mirë e deleve është përzgjedhur ajo e pronarit Muhamet Koxha, kurse dashi më i mirë është zgjedhur ai i pronarit Naser Hasaj. Vendet e para në këto kategori u shpërblyen me nga 150 euro, vendet e dyta me nga 80 euro, kurse vendet e treta me nga 50 euro.



# Mbëltohen fidanë palmash përskaj rrugës "Ismail Raka"

**26 shtator** - Përskaj rrugës "Ismail Raka" janë mbëltuar 23 fidanë palmash të llojit "Bismarckia nobilis". Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, nga afër e ka përcjellur mbëltimin e palmave. Z.Zharku ka theksuar se, përveç shërbimeve administrative, pastaj atyre publike dhe investimeve në infrastrukturën fizike, ne po mundohemi që të krijojmë sa më shumë hapësira të gjelbëruara publike. Ndërkaq, z.Betim Shala, menaxher i projektit, ka thënë se ndërkohë është bërë edhe rregullimi i shiritave të gjelbërimit për mbjelljen e barit slloven "Opatia". Ai ka rikujtuar se do të mbëltohen edhe 46 pisha të llojit "Smark", do të ndërtohen edhe disa minikopshte dhe do të instalohet sistemi i ujitjes. Mbëltimi i palmave është pjesë e projektit: "Rregullimi i gjelbërimit në rrugën 'Ismail Raka'". Gjelbërimi do të bëhet në tërë gjatësinë e rrugës prej 892 metrash, ndërsa për realizimin e këtij projekti Komuna i ka alokuar 66 mijë e 573 euro.



## "Caritasi" i Luksemburgut përzgjedh fshatin Elezaj për zhvillimin e komunitetit

**27 shtator** - "Caritasi" i Luksemburgut e ka njoftuar kryetarin e Komunës, z. Xhabir Zharku, se fshati Elezaj është përzgjedhur për realizimin e projektit për zhvillim të komunitetit. Nëpërmjet letrës së nënshkruar nga shefi i misionit në Kosovë, z.Gerhard Fischer, "Caritasi" ka kërkuar pajtim me shkrim nga Komuna e Kaçanikut për realizimin e projektit në fshatin Elezaj. Ndërkaq, në letërpërgjigjen e tij, kryetari Zharku e ka falënderuar "Caritasin"e Luksmeburgut dhe z. Fischer, ndërsa e ka shprehur zotimin e Komunës për përmbushjen e obligimeve që do të dalin nga marrëveshja e përbashkët për realizimin e projektit në fshatin Elezaj. Z.Gerhard Fischer, në një takim të mbajtur më herët në Kaçanik, pati thënë se "Caritasi", përveç projekteve me komunat, ka alokuar edhe një grant për projekte me komunitetet në vlerë prej 1,3 milion eurosh nga i cili do të përfitojnë 4 komunitete të 6 komunave të rajonit të Gjilanit.

## EPOK aftëson zyrtarët për performansë të lartë komunale

**28 shtator** - Ekipi për Përmirësimin e Performansës së Organizatës Komunale (EPOK) dhe zyrtarë të projektit Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI), e kanë zhvilluar një punëtori 1-ditore me zyrtarë komunalë lidhur me zhvillimin e shkathtësive për menaxhimin e ndryshimeve. E pranishme në punëtori kanë qenë edhe znj.Ginka Kapitanova, drejtoreshë e programit, e cila shoqërohej nga



znj.Kathy Aniston, eksperte e lartë, z. Halit Kadriu, këshilltar i lartë, dhe z. Sali Salihu, këshilltar për qeverisje i DEMI-it. Gjatë punëtorisë zyrtarët komunalë i shpalosën shkathtësitë fascilituese dhe udhëheqjen e ndryshimeve në modulin e parë, ndërsa në atë të dytin dy ekipet e ndara në grupe punuese kanë hartuar plane veprimi për modulin e dytë - Ndikimi Strategjik. Projekti për Përmirësimin e Organizatës Komunale (EPOK) mbështetet nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe është pjesë e programit Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI). USAID-i përmes këtij programi po instalon një instrument për performansë të lartë në organizatën komunale.

## Legjislativi miraton buxhetin e 2012-s dhe Rregulloren e tatimit në pronë

**29 shtator** - Kuvendi e ka miratuar buxhetin e Komunës të vitit fiskal 2012 dhe Rregulloren e re të tatimit në pronë për vitin e ardhshëm. Është miratuar edhe propozimvendimi për rialokimin e 28.148 eurove nga ndarjet buxhetore të vitit 2011 në kategorinë e projekteve kapitale. Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, ka thënë se nga viti 2004 nuk ka pasur harmonizim dhe ndryshim të tarifave dhe vlerësim të pronave, prandaj ekzekutivi i komunës e ka hartuar këtë draftrregullore me



rritje të çmimit sipas vlerës së tregut për metër katror dhe me ngritje të shkallës tatimore. Drejtori Vërbani ka saktësuar se te shtëpitë dhe banesat

është propozuar ngritja e shkallës nga 0,10 % në 0,12 %, ndërsa te pronat komerciale dhe industriale nga 0,20 % në 0,25 %. Pas shqyrtimit të gjithanshëm, kryesuesi i Kuvendit, z. Xhelal Gashi, ka dalë me propozimin që të mos ketë ngritje të shkallës tatimore, por vetëm rritje të çmimit sipas vlerës së tregut për metër katror. Ky propozim ka kaluar me shumicë votash. Këshilltarët e kanë miratuar edhe buxhetin e Komunës të vitit 2012 dhe vlerësimet për periudhën 2013-2014. Buxheti i 2012-s është miratuar në shumë prej 5.457.754 eurosh. Është thënë se mot për shpenzime operative janë paraparë 4.277.565 euro, kurse për investime kapitale 1.180.190 euro. Buxheti i 2013-s është projektuar në shumë prej 5.528.999 eurosh, ndërsa ai i 2014-s në shumë prej 5.574.176 eurosh.

## Nis zbatimi i projektit për sinjalistikën e rrugëve

**30 shtator** - Kanë nisur punimet për realizimin e projektit: "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i disa rrugëve në komunën e Kaçanikut". Menaxheri i projektit, z. Mendu Krasniqi, shef sektori në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka thënë se ka filluar shenjëzimi horizontal i rrugës Bob - Doganaj në gjatësi 5,5 kilometrash ku është duke u bërë vija ndarëse. Ai ka sqaruar se projekti parasheh bërjen me vija ndarëse edhe të rrugëve të qytetit dhe vendosjen e shenjave vertikale për ndalimin e ndaljes dhe parkimit, sikundër edhe për kufizim shpejtësie. Për realizimin e këtij projekti janë alokuar 6 mijë e 291 euro të buxhetit komunal.



TETOR 2011

## Në rrugën "Ismail Raka" mbëltohen pisha "Smark"

**3 tetor** - Përskaj rrugës "Ismail Raka" janë mbëltuar 46 fidanë pishash të llojit "Smark" dhe është instaluar rrjeti i sistemit të ujitjes. Këto punë të kryera janë pjesë e projektit: "Rregullimi i gjelbërimit në rrugën 'Ismail Raka'", ndërsa për finalizimin e fazës së parë të tij ka mbetur vetëm edhe vendosja e rrethojës mbrojtëse të gjelbërimit. Menaxheri i projektit, z. Betim Shala, ka rikujtuar se më herët janë mbëltuar edhe 23 copë palma të llojit "Bismarckia nobilis", pastaj është mbjellur barë slloven i llojit "Opatia" dhe



është bërë rregullimi i shiritave të gjelbërimit. Faza e dytë e projektit do të realizohet mot, ndërsa është paraparë vendosja e shportave nga betoni dhe ulëseve, sikundër edhe ndërtimi i minikopshteve me lule dhe mbëltimi i 88 copë pishash të quajtura të argjendta. Për realizimin e dy fazave të projektit të sipërpërmendur janë alokuar 66 mijë e 573 euro të buxhetit komunal.

## Kryetari takon ambasadorin norvegjez

**4 tetor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka pasur takim miqësor me ambasadorin e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë, z. Jan Braathu. Kryetari Zharku e ka falënderuar ambasadorin për vizitën e tij në Kaçanik, ndërsa i ka thënë atij se edhe kjo vizitë juaja është dëshmi e miqësisë sonë me popullin norvegjez. Në këtë kontekst, ai ka rikujtuar se shumë familje kaçanikase jetojnë në Norvegji dhe në shtetet skandinave. "Ne po bashkëpunojmë me bashkësinë ndërkombëtare edhe në planin e ndërtimit të një shteti multietnik, ndërsa praktikat e vendeve skandinave janë një shembull i mirë në këtë rrafsh", ka nënvizuar kryetari Zharku. Ndërsa duke folur për liberalizimin e vizave, z. Zharku ka deklaruar se heqja e vizave dhe lëvizja e lirë do t'i bëj të mendojnë ndryshe edhe serbët dhe do të ndikojë që edhe



ata ta pranojnë shtetin e Kosovës. Ndërkaq, ambasadori norvegjez Braathu i ka thënë kryetarit Zharku se mënyra më e mirë për të krijuar ura bashkëpunimi është njohja e njerëzve nga afër, prandaj edhe ardhja ime këtu për t'u takuar me ju është në funksion të krijimit të relacioneve miqësore dhe bashkëpunuese. Duke folur për të arriturat e shtetit të Kosovës, z.Braathu ka thënë se Kosova ka bërë shumë progres, por ka ende shumë për t'u bërë në ndërtimin e shtetit. "Ju keni nevojë për shumë ndihmë nga bashkësia ndërkombëtare", ka theksuar z. Braathu. Ambasadori norvegjez dhe kryetari i Komunës janë takuar edhe me futbollistet e KF Kaçanikasja, të cilat më herët e fituan turneun tradicional "Norway Cup 2011" në konkurrencë me skuadra nga 51 shtete të botës. Z.Fatos Vishi, këshilltar për rini dhe sporte, mysafirëve ua ka shpalosur historikun e KF Kaçanikasja dhe sukseset e arritura. Ai ka thënë se klubi është themeluar në vitin 2008, ndërsa nga 2010-a garon në Superligën e Kosovës. Kryetari Zharku dhe ambasadori Braathu kanë theksuar se ekipi i futbollit të femrave ka qenë një ambasador i shtetit të Kosovës duke prezantuar një imazh të mirë për Kosovën, ndërsa kanë premtuar mbështetje edhe në të ardhmen për këtë skuadër. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në shenjë nderi dhe respekti, i ka dhuruar një pikturë ambasadorit norvegjez në Kosovë, z. Jan Braathu.

## Kryetari dënon vrasjen e drejtorit të Arsimit të Prishtinës

**4 tetor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka dënuar ashpër vrasjen e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës, z.Remzi Salihu. Kryetari ka artikuluar indinjatën e thellë edhe në emër të qytetarëve të komunës së Kaçanikut, ndërsa familjes Salihu dhe kryetarit të Komunës së Prishtinës, z. Isa Mustafa, u ka shprehur ngushëllimet e thella dhe të sinqerta. Kryetari Zharku u ka bërë ftesë organeve të hetuesisë dhe të drejtësisë që sa më parë ta zbardhin rastin. Z.Zharku ka rikujtuar se raste të kërcënimit edhe me armë të zyrtarëve ka pasur edhe në komunën tonë, ndërsa nga organet përgjegjëse ka ri kërkuar që të merren më seriozisht me këto raste.

# QKMF-së i dorëzohet furgoni i blerë për pacientët që i nënshtrohen hemodializës

**7 tetor** - Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, ia ka dorëzuar dr. Ekrem Dullovit, drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjarë (QKMF), çelësat e furgonit të blerë për pacientët që i nënshtrohen hemodializës. "E kam vlerësuar si shumë të nevojshme blerjen e automjetit transportues për pacientët që i nënshtrohen hemodializës për shkak se bëjnë udhëtim jashtëzakonisht të mundimshëm në relacionin Kaçanik-Spitali i Gjilanit dhe anasjelltas", u ka thënë punonjësve të QKMF-së kryetari Zharku. Për të mundësuar blerjen e furgonit për pacientët që i nënshtrohen hemodializës, kryetari Zharku ka hequr dorë nga blerja e planifikuar e automjetit të tij zyrtar në shumë prej 45 mijë eurosh, ndërsa është përcaktuar për blerjen e një tjetri në shumë prej 28 mijë e 500 eurosh. Shumën e mbetur prej 16 mijë e 500 eurosh z.Zharku e pati dedikuar për blerjen e furgonit. Kryetari Zharku edhe me këtë rast e ka shprehur shqetësimin e tij për rrugën e gjatë që bëjnë



pacientët që i nënshtrohen hemodializës. "Ne ende nuk kemi bërë zgjidhje përfundimtare për këtë kategori pacientësh. Zgjidhja do të ishte që këta pacientë të trajtohen sa më afër për t'i ikur udhëtimit të gjatë e të mundimshëm", ka thënë kryetari Zharku. Ndërkaq, drejtori i QKMF-së, dr. Ekrem Dullovi, e ka falënderuar kryetarin e Komunës për blerjen e furgonit shumë të nevojshëm për pacientët. Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, ka thënë se furgoni është blerë me 20 mijë e 800 euro të buxhetit komunal. Ndërsa Misim Sopa, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka thënë se janë 13 pacientë kaçanikas që i nënshtrohen hemodializës në Spitalin e Gjilanit.

## Nis realizimi i projektit të financuar nga "Kosova e bukur"

**14 tetor** - Ka nisur realizimi i projektit të financuar nga "Kosova e bukur". Ky projekt parasheh ndërtimin e shëtitores së munguar në krahun e majtë të lumit Neredime, rregullimin e gjelbërimit dhe parkimin për automjete në rrugën "Vëllezërit Çaka", sikundër edhe shtigjet lidhëse për shumëkatëshet



përballë Stacionit të Autobusëve. Shëtitorja do të ndërtohet me kubëza betoni në gjatësi prej 685 metrash dhe gjerësi prej 3 metrash - nga Ura e Konakut e deri te Ura e Hazirit, ndërsa do të mbëltohen edhe bimë dekoruese. Shëtitorja do të bëhet edhe me ndriçim publik, shporta mbeturinash dhe oaza për pushim. Projekti i sipërpërmendur është kontraktuar në shumë prej 78 mijë e 141 eurosh. Për realizimin e tij Bashkimi Evropian i ka alokuar 74 mijë 234 euro, ndërsa Komuna 3.907 euro ose 5 % të shumës së kontraktuar. Projekti "Kosova e bukur" financohet nga BE-ja dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, ndërsa zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në partneritet me Këshillin Danez për Refugjatë (DRC). Z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka thënë kompania e kontraktuar i ka angazhuar 20 punëkërkues nga Zyra Komunale e Punësimit në përputhje me qëllimin e projektit, i cili promovon mundësi të reja të punësimit dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe të gjendjes ekonomike.

## Kryetari dhe nënkryetari nisen për vizitë në Mooseedorf të Zvicrës

**14 tetor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, dhe nënkryetari, z. Heset Loku, kanë udhëtuar për një vizitë 3-ditore në Mooseedorf të Zvicrës me ftesë të kryetarit të kësaj komune, z. Peter Bill. Para nisjes, kryetari Zharku ka thënë se qëllimi i vizitës sonë është avancimi dhe thellimi i mëtutjes hëm i bashkëp unimit në mes dy



komunave tona mike. "Kjo vizitë ka për qëllim edhe shprehjen e gatishmërisë dhe vullnetit tonë për vazhdimin e partneritetit institucional dhe vizitave reciproke", ka shtuar z.Zharku. Mooseedorf është komunë që i takon rrethit dhe kantonit administrativ të Bernës. Marrëveshja e partneritetit ndërmjet komunave Kaçanik dhe Mooseedorf është firmosur më 2001, ndërsa janë realizuar vizita të ndërsjella ndërkohë.

## Mooseedorf premton mbështetje për projektet e Kaçanikut



**16 tetor** - Komuna e Mooseedorfit është e gatshme të mbështesë financiarisht projektet e Komunës së Kaçanikut. Kështu kanë deklaruar z.Peter Bill, kryetari i Komunës së Mooseedorfit, dhe njeriu i dytë i kësaj Komune, z.Peter Scholl, në takim me kryetarin e Komunës, z.Xhabir Zharku,



dhe nënkryetarin z.Heset Loku. Është thënë se Mooseedorfi do të marrë vendim eventual për financim vetëm pasi t'i ketë pranuar dhe shqyrtuar projektet e dorëzuara nga Komuna e Kaçanikut. Mooseedorfi dhe Kaçaniku kanë raporte të mira miqësore, ndërsa është folur edhe për nevojën e formalizimit të binjakëzimit. Kryetari Zharku dhe nënkryetari Loku kanë qëndruar në Mooseedorf nga 14-16 tetor, me ftesë të z.Bill. Gjatë qëndrimit në Mooseedorf z.Zharku dhe z.Loku janë njoftuar edhe me funksionimin e administratës komunale. Pjesë e agjendës së qëndrimit 3-ditor atje kanë qenë edhe vizita dhe takime të tjera.

## Debatohet për draftin e Rregullores për bashkëpunimin Komunë-lokalitete

**17 tetor** - Është mbajtur debati për draftin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Kaçanikut. Z.Heset Loku, nënkryetar i Komunës, ka thënë se hartimi i Rregullores ka qenë nevojë, ndërsa me miratimin e saj në Kuvend do të krijohen mundësi për bashkëpunim edhe më të mirë të Komunës me lagjet urbane dhe fshatrat. "Ne po krijojmë një hallkë të bashkëpunimit, por të jemi të qartë se me këtë dokument nuk po e krijojmë nivelin e tretë qeverisës", ka nënvizuar z.Loku. Ai ka rikujtuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës i njeh vetëm dy nivele qeverisëse - atë qendror dhe nivelin komunal. Ndërkaq, z. Pascal Fendrich, zyrtar i projektit Zvicër- Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim - LOGOS, ka thënë se Rregullorja krijon mundësi për bashkëpunim të avancuar ndërmjet Komunës dhe lokaliteteve, kurse të pranishmit i ka ftuar që të japin sugjerime dhe propozime për ta plotësuar draftin e hartuar. Z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, njëherësh anëtar i komisionit për hartimin e Rregullores, e ka shpalosur përmbajtjen e neneve të saj. Ai ka thënë se anëtarë të komisionit hartues janë edhe z. Jeton Topalli, drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe znj. Fitore Krivanjeva-Daci, zyrtare ligjore. Z.Shukri Luta, shef i Grupit parlamentar të AAK-së në Kuvendin e Komunës, ka propozuar që të shqyrtohen mundësitë për kompensimin e kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane. I të njëjtit mendim ka qenë edhe z. Zekirja Loku, shef i Grupit parlamentar të PDK-së. Ai ka thënë se

administratorët lokal kanë dhënë kontribut të çmuar që nga paslufta e këndej. Z.Nexhadi Luta, administrator i fshatit Ivajë, ka propozuar të rritet numri i anëtarëve të këshillave, ndërsa ka kërkuar që në Rregullore të saktësohet edhe mënyra e kompensimit të kryetarëve të këshillave. Propozimin për kompensimin e kryetarëve e kanë mbështetur edhe folës tjerë. Nënkryetari i Komunës, z. Loku, ka thënë se duhet të vazhdohet të punohet në baza vullnetare për shkak se në buxhetin e 2012-s nuk është planifikuar financimi i këshillave të lokaliteteve të Komunës, ndërsa e ka lënë të hapur mundësinë që kryetarët e tyre të kompensohen për pjesëmarrje në takime që i organizon Komuna me ta. Rregullorja për bashkëpunimin e Komunës me lagjet urbane, vendbanimet dhe fshatrat pritet të shqyrtohet në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës, ndërsa hartimi i saj është mbështetur nga LOGOS-i.



## Vlerësohet Rregullorja për shkollat e mesme të larta

**18 tetor** - Në pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj" është mbajtur debati për Rregulloren e hartuar për shkollat e mesme të larta e cila i përcakton të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e nxënësve. Z. Azem Guri, drejtor i Drejtorisë

së Arsimit e Kulturës, ka thënë se Rregullorja është harmonizuar me Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës i miratuar në shtator të këtij viti. "Në këtë dokument janë paraparë edhe masat disiplinore për



mungesa të paarsyeshme dhe shkelje të kodit të mirësjelljes, procedurat për vërtetimin e përgjegjësive, zhvillimi i procedurave disiplinore, e drejta për ankesë, kompensimi material për dëmin e shkaktuar etj.", ka nënvizuar z.Guri. Ndërkaq, znj.Fatlume Guri, përfaqësuese e Grupit të Ambientalistëve të Rinj, ka kërkuar që të definohet edhe çështja e bartjes së uniformave të nxënësve. Z.Bafti Loku, drejtor i SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka", ka thënë se Rregullorja e re i saktëson edhe masat ndëshkuese ndaj nxënësve të padisiplinuar me çka do të ndikojë pozitivisht në procesin mësimor. Z.Ibush Vishi, drejtor i gjimnazit "Skënderbeu", ka thënë se masat ekzistuese ndëshkimore për nxënësit që bëjnë shkelje të rënda nuk kanë prodhuar rezultate meqë kanë qenë shumë të buta, ndërsa masat e ashpërsuara të përfshira në Rregulloren e re do të kenë efekt parandalues në këtë rrafsh. Profesori Murtez Neziraj ka thënë se na duhet shkollë e fortë, e bazuar në disiplinë dhe punë. Gjatë debatit kanë dalur në pah edhe disa problematika që po e përcjellin sistemin arsimor në komunën tone, ndërsa ishte vlerësim i të gjithë folësve se me miratimin e kësaj Rregullore do të korrigjohen shumë mangësi dhe të meta. Rregullorja e hartuar do të jetë në agjendën e seancës së radhës të legjislativit komunal për shqyrtim dhe miratim.

## Nis mësimi joformal për personat pa shkollë fillore të mbaruar

**19 tetor** - Ka nisur mësimi joformal për personat të cilët nuk e kanë mbaruar shkollimin fillor. Mësimin plotësues për nxënësit të cilët e kanë braktisur shkollimin e obliguar e kanë mundësuar Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe organizata gjermane GIZ (Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar), nëpërmjet projektit: "Arsimimi joformal dhe oferta plotësuese për nxënësit që e kanë braktisur shkollimin e obligueshëm fillor". Drejtori i DAK-së, z. Azem Guri, ka thënë se 23 persona janë pranuar për vijimin e mësimit në shkollën fillore "Ali Asllani" të fshatit Doganaj. Drejtori Guri ka shtuar se me këta persona, që do t'i ndjekin mësimet e klasave VIII dhe IX, do të punojnë 5 arsimtarë të cilët janë përzgjedhur me konkurs. Z.Guri ka pohuar se shumë shpejt do të nisë edhe mësimi për klasët VI dhe VII. Udhëheqësi i projektit të sipërpërmendur, z.Robert Kroiss, ka thënë se GIZ-ja e ka marrë përsipër financimin e arsimtarëve dhe transportin për vijuesit e mësimit. Pas përfundimit të kursit, frekuentuesit e tij do të pajisen me certifikata të cilat do të cilësohen si të barasvlershme me ato të arsimit fillor.

## Themelohet komisioni për kyçjet në ujësjellësin e Kaçanikut të Vjetër dhe Begracës

**20 tetor** – Është themeluar komisioni i përbashkët i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës dhe NPK "Lypeteni" për verifikimin e kyçjeve në rrjetin e ujësjellësit të fshatrave Kaçanik i Vjetër dhe Begracë. Z.Rushan Ceka, drejtor DSHPE-së, ka thënë se komisioni i përbashkët 3-anëtarësh do t'i verifikojë kyçjet në rrjetin sekondar të ujësjellësit. Komisioni do t'i lejojë vetëm kyçjet të cilat janë në harmoni me kriteret e Zyrës Rregullative për Ujë dhe Mbeturina. Në ditën e parë të punës komisioni e ka bërë verifikimin e 14 kyçjeve, ndërsa nuk ka hasur në aso të parregullta. Drejtori Ceka ka theksuar se komisioni do ta kryejë punën e vet brenda 15 ditëve në vijim, ndërsa më pas do të funksionalizohet rrjeti i ujësjellësit.

## Drejtoria e Bujqësisë subvencionon 20 fermerë për plantacione mollësh

**20 tetor** - Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do t'i subvencionojë 20 fermerë për ngritjen e plantacioneve të mollëve, ndërsa subvencionimi është projektuar në shumë prej rreth 1 mijë eurosh për secilin nga përfituesit. "Ndërkohë është përmbyllur konkursi, ndërsa kanë aplikuar gjithsej 20 fermerë", ka theksuar z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Ndërkaq, z.Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka pohuar se përfitues të subvencionimit do të mund të jenë të gjithë aplikuesit në konkurs nëse i plotësojnë kushtet e kërkuara. "Për të qenë përfitues ata duhet të kenë sipërfaqe të pandarë prej 40 arësh, të jenë të rrethuara dhe të gatshme për mbjelljen e fidanëve të mollëve", ka sqaruar z.Provoliu. Është thënë se përparësi do të kenë aplikuesit që kanë sipërfaqe me sistem të instaluar të ujitjes.

## Nis zbatimi i projektit për pastrimin e përrenjve dhe largimin e mbeturinave

**25 tetor** - Ka nisur zbatimi i projektit për pastrimin e përrenjve dhe heqjen e mbeturinave nga deponitë ilegale në komunën e Kaçanikut. Për realizimin e



tij janë angazhuar 47 punëtorë - 39 nga Zyra Komunale e Punësimit dhe 8 nga kompania e kontraktuar. Z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka thënë se projekti i sipërpërmendur është kontraktuar në shumë prej 52 mijë e 805 eurosh. Drejtori Ceka ka sqaruar se 60 % e mjeteve ose 31 mijë e 683 euro janë të dedikuara për punëtorët të cilët do të marrin paga mujore në shuma prej 200 eurosh. Ai ka nënvizuar se fillimisht do të bëhet pastrimi i shtratit të lumit Neredime, ndërsa në vijim do të pastrohen shtretërit e përrenjve dhe do të bëhet largimi i mbeturinave nga deponitë ilegale. Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Kaçanikut dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për realizimin e projektit: "Largimi i mbeturinave nga deponitë ilegale dhe pastrimi i përrenjve", qe nënshkruar më 27 maj. Mjetet janë akorduar nga programi i punëve publike për gjenerimin e punësimit dhe zbutjen e varfërisë i Bankës Botërore. Në memorandum thuhet se projekti duhet të përfundojë më 31 dhjetor.

## IKDE-ja premton mbështetje për avancimin e shërbimeve për qytetarët

**26 tetor** - Inciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (IKDE) - program i USAID-it, ka premtuar ta ndihmojë Komunën e Kaçanikut për avancimin e shërbimeve administrative për qytetarët. Drejtori i Administratës së Përgjithshme, z. Jeton Topalli, është takuar me zyrtarë të IKDE-së, ndërsa kanë diskutuar për cilësinë e shërbimeve administrative që i ofron Komuna dhe për funksionimin e qendrës për shërbim të qytetarëve (zyra pritëse), pastaj për funksionimin e zyrave të vendit në terren dhe për mundësinë e avancimit të punës së tyre me përpjekje të përbashkëta. Z. Topalli i ka njoftuar mysafirët për nivelin e punës që bëhet në qendrën për shërbim të qytetarëve dhe nevojat për avancimin e saj. Shefi i njësisë për administratë lokale i IKDE-së, z. Lachezar Rosenov, ka artikuluar kënaqësinë e tij për faktin se qendra e sipërpërmendur në disa aspekte aplikon praktika shumë efikase, kurse në disa të tjera ekziston hapësirë për përmirësim. Z. Rosenov shprehu gatishmërinë për ta ndihmuar Komunën e Kaçanikut në përmirësimin e shërbimeve administrative nëpërmjet mbështetjes financiare dhe asaj teknike.

# Banka Botërore dhe Komuna e bëjnë shkollën e Ivajës me kabinet të informatikës

**27 tetor** - Në shkollën fillore "Dituria" të fshatit Ivajë është përuruar kabineti i informatikës, ndërsa i pranishëm ishte edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, z. Azem Guri. "Bërjen e kësaj shkolle me kabinet të informatikës e ka mundësuar projekti për zhvillimin institucional të arsimit (IDEP), ndërsa është financuar nga Banka Botërore dhe Komuna", ka theksuar z.Guri. Ndërkaq, drejtori i "Diturisë", z. Qazim Livoreka, ka thënë se është 5.825 euro shuma e përgjithshme e investuar në kabinetin e informatikës. Ai ka saktësuar se Banka Botërore i ka dhënë 5.525 euro, ndërsa Komuna ka participuar me 5 % të shumës së investuar. Z.Livoreka ka thënë se kabineti i ri është pajisur me inventar dhe aparate të teknologjisë informative (kompjuterë, projektor, fotokopjues dhe skanues). Është thënë se kabineti i informatikës do të ndikojë në ngritjen e cilësisë në mësim. Ekipi Komunal për Grante Shkollore, të cilit i prinë drejtori Guri, e pati përzgjedhur shkollën e Ivajës për të qenë përfituese e grantit të Bankës Botërore për ngritjen e cilësisë në arsim. Përzgjedhja qe bërë në përputhje me kriteret e Këshillit Qendror për Aprovimin e Granteve.



# KK-ja miraton Rregulloren për shkollat e mesme dhe ndryshimet në atë për transparencën

**31 tetor**- Kuvendi i Komunës e ka miratuar propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transparencën komunale dhe Rregulloren për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta. Ndërsa e ka shqyrtuar propozimvendimin për caktimin e lokacionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për nevoja bujqësore, pastaj draftin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe informatën për vitin shkollor 2010/2011. Z.Hajrush Dullovi, shef i Zyrës së Informimit, ka thënë se KK-ja më herët e pati miratuar Rregulloren për transparencën komunale, ndërsa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të saj, ka propozuar plotësime dhe ndryshime në dokumentin e aprovuar. Këshilltarët e pranishëm në seancë njëzëri kanë votuar për aprovimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të kërkuara nga MAPL-ja, ndërsa



e kanë miratuar edhe Rregulloren për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e nxënësve të shkollave të mesme të larta. Për më vonë është shtyrë miratimi i propozimvendimit për caktimin e lokacionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për nevoja bujqësore, sikundër edhe miratimi i draftit të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Kaçanikut. Z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, njëherësh anëtar i komisionit për hartimin e Rregullores, ka thënë se LOGOS-i e ka dorëzuar një material shtesë për plotësimin e dokumentit dhe ka kërkuar që të përfshihet në draftin e hartuar. Ndërkaq, z. Pascal Fendrich, përgjegjës për monitorim dhe vlerësim i projektit LOGOS, i pranishëm ne seancë, ka propozuar që të diskutohet drafti i propozuar i Rregullores, ndërsa miratimi i saj të shtyhet për më vonë pasi të jenë përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e propozuara ndërkohë. Këshilltarët e kanë miratuar kërkesën për shtyrje të miratimit të Rregullores së sipërpërmendur e cila është hartuar në bashkëpunim me LOGOS-in.

## I pari i Komunës - aplikuesi i parë për pasaportë biometrike

**31 tetor** - Kryetari i Komunës, Xhabir Zharku, ka aplikuar i pari për pasaportë biometrike në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil. Kryetari Zharku ka



deklaruar se të qenit e tij i pari që aplikon për pasaportë biometrike është një mesazh për nxitjen e qytetarëve që të pajisjen me këtë dokument shumë të rëndësishëm. "Unë i nxis qytetarët e komunës sonë që të aplikojnë për pasaportë biometrike, sepse pajisja me këtë dokument është njëri ndër kushtet për liberalizim vizash me vendet e Bashkimit Evropian", ka theksuar z.Zharku. Ndërkaq, zyrtarë të QKRC-së së Kaçanikut, kanë sqaruar se për aplikim do të zbatohen procedurat e parapara në Udhëzimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr.16/2011. Udhëzimi parasheh që aplikuesi për pasaportë biometrike duhet të dorëzojë fotokopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, certifikatën e shtetësisë dhe të bëjë pagesën e cila është e kategorizuar.

# NËNTOR 2011

## Kryetari takohet me delegacionin e gjimnazit të Stromstadit

**1 nëntor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka pasur një takim miqësor me delegacionin 9-anëtarësh të gjimnazit të Stromstadit nga Suedia i cili kryesohej nga z. Paul Karlson, përgjegjës për marrëdhënie me jashtë i gjimnazit të sipërpërmendur, dhe z. Elez Neziraj, profesor i gjimnazit. Shtatë anëtarët tjerë të delegacionit ishin nxënës të gjimnazit. Kryetari Zharku i ka njoftuar mysafirët nga shteti mik i Suedisë me funksionimin e administratës komunale, ambientet e punës dhe hapësirën ku punon ai. "Ne kemi instaluar një administratë transparente dhe efektive, ndërsa synim yni është avancimi i mëtutjeshëm i shërbimeve për qytetarët duke rritur përgjegjësinë dhe disiplinën në punë", u ka thënë mysafirëve z.Zharku. Ai ka folur edhe për luftën çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. "Lufta jonë ishte e kushtëzuar dhe nuk ishte e drejtuar kundër popullit serb, por kishte për qëllim çlirimin e vendit. Ne sot jemi të lirë edhe falë ndihmës së faktorit ndërkombëtar që e mbështeti luftën tonë të drejtë", ka deklaruar kryetari Zharku. Drejtori i



Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, z. Azem Guri, i ka njoftuar mysafirët me sistemin e arsimit në komunën tonë, duke u ndërlidhur edhe me periudhën e paraluftës dhe format e zhvillimit të arsimit atëbotë. Z.Guri ka thënë se gjatë luftës janë vrarë 18 punëtorë të arsimit dhe 13 nxënës, ndërsa janë djegur dhe dëmtuar 19 objekte shkollore. Duke folur për gjendjen e arsimit në ditët e sotme, ai ka thënë se aktualisht i kemi 12 shkolla të plota fillore, 2 të mesme dhe një qendër parashkollore me 7.456 nxënës dhe 494 nxënës të ciklit parashkollor. Ndërkaq, z. Karlson e ka falënderuar kryetarin Zharku për pritjen shumë të ngrohtë e miqësore. "Ndihem vërtetë i nderuar që e takova kryetarin", është shprehur z.Karlson. Pasi e ka uruar kryetarin për arritjet, z.Karlson ka shtuar: "Vërtetë po e shoh se jeni shumë të motivuar për ngritjen e cilësisë dhe përgjegjësisë në punë". Në shenjë respekti, kryetari Zharku ia ka dhuruar z. Karlson një pikturë të Kalasë së Krujës. Delegacioni i gjimnazit të Stromstadit e ka vizituar edhe gjimnazin "Skënderbeu" dhe Varrezat e Dëshmorëve. Miqtë nga Stromstadi kanë qëndruar për vizitë disaditore në Kaçanik në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy gjimnazeve - atij të Stromstadit dhe gjimnazit "Skënderbeu". Iniciativa për bashkëpunim ndërmjet këtyre dy gjimnazeve qe miratuar më 4 nëntor të vitit të kaluar, gjatë qëndrimit në Kaçanik të përfaqësuesve të gjimnazit të Stromstadit.

## Komuna dhe IKDE-ja themelojnë grupin punues për sinjalistikën rrugore

**1 nëntor** - Është themeluar grupi punues për përmirësimin e shenjëzimit horizontal dhe vertikal në rrugët dhe lokacionet ku gjenden objekte të trashëgimisë kulturore-historike që administrohen nga Komuna. Grupi, i kryesuar nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, z. Rushan Ceka, ndërkohë e ka nisur punën për hartimin e planit veprues me ndihmën e ekspertëve të programit Iniciativa për Komuna Efektive dhe Demokratike (IKDE) të USAID-it. Plani do të hartohet në përputhje me praktikat bashkëkohore amerikane për përmirësimin e shërbimeve, të njohura si SIAP (Service Improvement Action Plan). Në bashkëpunim IKDE-në, grupi punues e ka përfunduar analizën e gjendjes aktuale, pastaj i ka caktuar objektivat e planit si dhe e ka identifikuar strategjinë e grumbullimit të të dhënave, indikatorët e performansës dhe rezultatet e pritura. "Është një grup gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e zyrtarëve komunalë, profesionistëve

të kësaj fushe dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile që po punon duke u këshilluar me ekspertët e IKDE-së. Puna është duke ecur sipas dinamikës së paraparë dhe plani pritet të marrë formën përfundimtare në mesin e dhjetorit", ka theksuar z. Ceka. Plani, sipas praktikes SIAP, mundëson një pjesëmarrje të shtuar të qytetarëve dhe të shoqërisë civile në procesin e planifikimit, kurse zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i tij bëhet sipas teknikave të matjes së arritshmërisë. "Plani veprues për përmirësim e shërbimit është mjet i menaxhimit që bazohet mbi konceptet dhe teknikat e menaxhimit të performansës dhe fokusohet para së gjithash në nevojat e qytetarëve që pranojnë atë shërbim. Për këtë arsye, në procesin e planifikimit Komuna do të shfrytëzojë edhe metoda adekuate për hulumtimin e mendimit të qytetarëve mbi shërbimin e pranuar", ka thënë z.Sali Salihu, këshilltar për qeverisje lokale i programit IKDE të USAID-it. Në dy vjetët e fundit Komuna i ka shpenzuar rreth 30.000 euro në shenjëzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve nën administrimin e saj. Në vitet në vijim investimet në këtë rrafsh do të shtohen për faktin se, përpos ekspertizës dhe ndihmës teknike, IKDE-ja do të jetë partnere edhe në realizimin e planit nëpërmjet mbështetjes financiare.

## LOGOS-i i alokon 81 mijë euro për 9 komuna - përfshirë edhe Kaçanikun

2 nëntor - Projekti Zvicër-Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS, që zbatohet nga fondacioni "Helvetas-Intercooperation" dhe financohet nga Qeveria zvicerane, në Gjilan, e ka nënshkruar marrëveshjen e financimit të 9 projekteve për barazi gjinore dhe ka prezantuar 9 projekte për mbështetje të zyrave të informimit publik të 9 komunave të Kosovës Juglindore (Kamenicë, Novobërdë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Viti, Kaçanik, Hani i Elezit dhe Shterpcë). Në kuadër të marrëveshjeve të financimit për projektet e barazisë gjinore, LOGOS-i për komunat partnere të Kosovës Juglindore i ka alokura 63 mijë euro, ndërsa secila ka përfituar nga një grant prej 7 mijë eurosh. Kurse për projektet në mbështetje të zyrave të informimit publik janë alokuar 18 mijë euro, nga 2 mijë euro për secilën komunë. Projektet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore do të zbatohen nga zyrat komunale të barazisë gjinore dhe OJQ-të lokale, kurse projektet për mbështetje të zyrave të informimit publik do të zbatohen nga vetë këto zyra.

Koordinatori i projektit LOGOS, z.Norbert Pijls, ka thënë se Qeveria zvicerane është e interesuar që fondet e saj t'i shpenzojë për zhvillimin e demokracisë lokale dhe në këtë drejtim LOGOS-i mbështet projektet që kanë të bëjnë me avancimin e punës së zyrave për informim publik dhe zyrat për barazi gjinore. "Avancimi i punës së zyrave për informim dhe i atyre për barazi gjinore është me rëndësi për LOGOS-in, ndërsa këto zyra dhe OJQ-të që mbështeten me këto fonde do t'i shpenzojnë mjetet aty ku e shohin më të arsyeshme dhe ku nevojat janë më të mëdha", ka thënë z.Pijls. Ndërkaq, znj.Merita Barileve, zyrtare për projektet e LOGOS-it, ka thënë se LOGOS-i, përveç mbështetjes që është duke i dhënë komunave partnere në projekte investive, planifikim të buxhetit, planifikim strategjik, menaxhim të mbeturinave, të hyrave vetjake dhe në fusha tjera, një vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe barazisë gjinore dhe për këtë qëllim janë alokuar 63 mijë euro. Zyrtari tjetër i LOGOS-it, z. Pascal Fendrich, ka thënë se përmes fondeve të dedikuara për zyrat e informimit publik do të mbështeten aktivitetet e këtyre zyrave të planifikuara në planet e punës dhe që janë në interes të informimit të qytetarëve për zhvillimet në komuna. Z.Vedat Dema, zyrtar për barazi gjinore i KK të Kaçanikut, ka thënë se LOGOS-i është përcaktuar për ta financuar projektin: "Fuqizimi i gruas në procesin e vendimmarrjes". Ndërsa z.Hajrush Dullovi, shef i Zyrës së Informimit Publik, ka rikujtuar se LOGOS-i e ka mbështetur me 2 mijë euro edhe këtë Zyrë.



# OSBE-ja ndihmon futbollistet e klubit Kaçanikasja

**3 nëntor** - OSBE-ja i ka ndihmuar futbollistet e klubit Kaçanikasja me rekuizita sportive. Drejtori i Zyrës rajonale të OSBE-së në Gjilan, Z. Ulrich Biffar, ia ka dorëzuar z.Fatos Vishi, trajner i ekipit Kaçanikasja, një sasi këpucësh futbolli dhe topash. Është thënë se ky donacion është pjesë e një projekti të OSBE-së për përkrahjen e të rinjve dhe femrave në aktivitetet shoqërore. Z.Biffar i ka përgëzuar futbollistet e këtij klubi dhe trajnerin për sukseset e arritura në kampionatin e Kosovës dhe në turnetë ndërkombëtarë. Ai i ka inkurajuar futbollistet dhe trajnerin Vishi që të vazhdojnë me këtë përkushtim në funksion të arritjes së rezultateve edhe më të mira. Trajneri i ekipit, z.Fatos Vishi, e ka falënderuar OSBE-në për donacionin i cili, sipas tij, do ta përmirësojë gjendjen e klubit sa i përket pajisjeve dhe rekuizitave sportive.



# Kryetari viziton serrat dhe plantacionet e disa fermerëve

**3 nëntor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nuhi Provoliu, i ka vizituar disa serra perimesh dhe plantacione pemësh. Fermeri Sulejman Runjeva, nga fshati Runjevë, në serrën e tij kishte mbjellur marullë të gjelbër.

Sipas tij, pritet që ky produkt të dalë në treg pas një muaji. Fermeri tjetër, Naim Hysa, nga fshati Stagovë, në serrën e tij kishte mbjellur qepë. Drejtori Provoliu ka thënë se kohë më parë fermerët janë aftësuar për kultivim perimesh në sipërfaqe të mbyllura (serra). Kryetari Zharku e ka vizituar edhe plantacionin e mollëve të fermerit Fehmi Bunjaku në fshatin Biçec. Ai i kishte mbjellur 500 fidanë mollësh varietetesh të ndryshme në një sipërfaqe prej 0,40 hektarësh. Kryetari Zharku e ka vizituar edhe bodrumin e mollëve të pronarit Sulejman Kovaçi, i cili sivjet i kishte vjelur 70 tonë fruta mollësh varietetesh të ndryshme. Sivjet, Komuna e Kaçanikut u ka dhuruar nga një serrë për mbjellje perimesh 10 fermerëve dhe ka subvencionuar mbjelljen e nga 500 fidanëve të mollës për 20 fermerë të tjerë. Z. Zharku, pasi e ka vlerësuar lartë realizimin e këtyre projekteve, ka thënë se Komuna e Kaçanikut edhe për vitin e ardhshëm i ka alokuar 100 mijë euro për realizim projektesh të ngjashme në bujqësi.



## Kryetari inspekton punimet në rrugën e Kovaçecit

**3 nëntor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Bekim Troni, i ka inspektuar punimet në rrugën e fshatit Kovaçec. Kryetari Zharku e ka përcjellur nga afër zgjerimin e trupit të rrugës dhe nivelimin e saj. Z.Zharku ka thënë se ndërtimi i kësaj rruge përveç që e lehtëson lëvizjen e njerëzve dhe automjeteve, krijon edhe mundësi për lidhje rrugore me lagjet tjera. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në gjatësi prej 1.500 metrash dhe gjerësi prej 5 metrash është planifikuar të realizohet në dy faza. Aktualisht është duke u ndërtuar kanali i hapur nga betoni i armiruar për mbledhjen e ujërave atmosferik, pastaj gërmimi sipërfaqësor për nivelimin e rrugës dhe punimi i

lëshesave dhe disa punë të tjera. Për kryerjen e këtyre punëve do të shpenzohen gjithsej 90 mijë euro, ndërsa në fazan e dytë, që do të realizohet vitin e ardhshëm, do të bëhet asfaltimi i rrugës në gjerësi prej 5 metrash dhe trashësi prej 12 centimetrash (8+4). Për realizimin e dy fazave të projektit Komuna do t'i shpenzojë 244 mijë e 916 euro.



## Përurohet aneksi i shkollës në fshatin Nikaj

**4 nëntor** - Në fshatin Nikaj është bërë përurimi i aneksit të shkollës. Prerjen e shiritit përurues e kanë bërë kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, drejtori i shkollës, z. Burim Bunjaku dhe z.Faik Guri, baba i dëshmorit Feriz Guri. Pasi i



ka përgëzuar nxënësit, arsimtarët dhe prindërit e pranishëm për aneksin, z.Zharku ka thënë se zgjerimi dhe përmirësimi i hapësirës së shkollës ka krijuar kushte më të mira për ngritjen e cilësisë në mësim. Kryetari Zharku e ka falënderuar edhe popullin mik amerikan për mbështetjen financiare jo vetëm të këtij projekti. Kryetari Zharku ka vlerësuar se ende ka shumë për t'u bërë për kompletimin e infrastrukturës së shkollës. "Ndërtimin e një kopshti për nxënësit e kësaj shkolle mund të bëhet edhe me punë vullnetare", ka theksuar z.Zharku. Drejtori i shkollës, z.Burim Bunjaku, ka pohuar se ankesi që po pëurohet ka krijuar kushte më të mira për mësimnxënie për 152 nxënësit e paraleles së ndarë fizike në fshatin Nikaj të SHF"Jusuf Gërvalla". Drejtori Bunjaku e ka falënderuar USAID-in dhe Komunën për finacimin e projektit, ndërsa MASHT-in për pajisjen me inventar të ri të objektit shkollor. Për kontributin e dhënë, drejtoria e shkollës i ka nderuar me mirënjohje kryetarin Zharku, USAID-in, MASHT-in dhe punëkryesin. Objektit ekzistues të shkollës në fshatin Nikaj i janë shtuar gjithsej 360 metra katrorë (3 dhoma mësimi, tualetet dhe ngrohja qendrore). Për ndërtimin e aneksit të shkollës janë investuar 134 mijë euro. Projekti është realizuar me bashkëfinancim të USAID-it (82 mijë euro) dhe Komuna së Kaçanikut (52 mijë euro), kurse është zbatuar nga CHF International. Kjo organizatë është implementuese e projekteve të programit: "Infrastruktura e vogël për arsim në Kosovë" që financohet nga fondi i USAID-it në bashkëpunim me komunat.

## Shkollave të mesme u dorëzohet Rregullorja e miratuar

**4 nëntor** - Në dy ceremoni të ndara, dy shkollave të mesme të komunës së Kaçanikut u është dorëzuar Rregullorja për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e nxënësve të shkollave të mesme të larta. Z. Xhelal Gashi, kryesues i Kuvendit të Komunës, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, z. Azem Guri, dhe zyrtari për arsim të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, z. Avni Krasniqi, solemnisht ia ka dorëzuar Rregulloren z. Fahredin Gula, administrator i SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka", dhe z. Ibush Vishi, drejtor i gjimnazit "Skënderbeu". Z.Gashi u ka thënë të pranishmëve se Rregullorja është miratuar në seancën e 9-të të Kuvendit të Komunës, e mbajtur më 31 tetor. Z. Gashi u shpreh i bindur se Rregullorja e miratuar do të ndikojë në rritjen e disiplinës dhe cilësisë në mësim në shkollat e mesme. Rregullorja për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e

nxënësve të shkollave të mesme të larta përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, pastaj shkeljet e detyrave dhe rregullave për nxënësit, masat disiplinore, procedurat për vërtetimin e përgjegjësive, zhvillimin e procedurave disiplinore, të drejtën për ankesë, kompensimin për dëmin e shkaktuar etj.



## Kryetari uron besimtarët myslimanë për Bajramin e Vogël

**4 nëntor** – "Qytetarë të nderuar,
Gëzuar Kurban Bajramin, festën kur manifestohet sakrifica dhe devotshmëria ndaj Zotit. Kjo festë ngjallë midis njerëzve ndjenjën fisnike të mbështetjes dhe solidaritetit vëllazëror dhe i nxit të jenë gjithmonë të gatshëm për sakrifica për të mirën e përgjithshme. Festa e Bajramit në familjet tona sjell lumturi e gëzime vëllazërore me më të afërmit, fqinjët dhe të gjithë të tjerët. Edhe në këtë ditë feste me krenari kujtojmë të gjithë ata që u sakrifikuan për lirinë e Kosovës - të gjithë dëshmorët, ata që dhanë më të shtrenjtën, jetën e tyre, që ne të festojmë sot të lirë."

Përzemërsisht,
Kryetari i Komunës
Xhabir Zharku

# USAID-i prezanton Indeksin e Konkurrencës për Komunën e Kaçanikut

**8 nëntor** – Nëpërmjet projektit: "Programi për Përmirësimin e Mjedisit Afarist", USAID-i e ka prezantuar Indeksin e Konkurrencës për Komunën e Kaçanikut. Z.Hajdin Ramadani, koordinator i projektit të sipërpërmendur, ka thënë se Indeksi i Konkurrencës së komunave paraqet një matje të cilësisë së qeverisjes ekonomike lokale lidhur me krijimin e mjedisit afarist nëpërmjet anketës së bërë me bizneset që operojnë në komunat e Kosovës. Sipas anketës, Komuna e Kaçanikut renditet e 14-ta në mesin e 33 komunave të Republikës së Kosovës. Nënkryetari i Komunës, z.Heset Loku, ka vlerësuar se renditja e komunës sonë në vendin e 14-të nuk është reale. Ai ka thënë se po të ishte bërë një vlerësim më real Komuna e Kaçanikut do të radhitej më lartë, ndërsa e ka përgëzuar USAID-in për realizimin e projektit. "Nëpërmjet rekomandimeve të prezantuara ne shohim arritjet dhe identifikojmë pikat e dobëta në mënyrë që të fokusohemi në përmirësimin e tyre dhe rritjen e performancës", ka thënë z.Loku. Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, ka thënë se ekzekutivi do të hartojë një plan veprimi për pjesën e rekomandimeve. Indeksi i Konkurrencës të Komunave të Kosovës është mbështetur në perceptimet e pronarëve të bizneseve.



# Ministrja Çitaku viziton Kaçanikun për të riatdhesuarit

10 nëntor - Ministrja e Ministrisë së Integrimeve Evropiane, znj.Vlora Çitaku, e shoqëruar nga shefat e zyrave ndërlidhëse greke e sllovake në Kosovë, Dimitris Moschopoulus dhe Henrik Markus, janë takuar me kryetarin e Komunës, z.Xhabir Zharku, dhe zyrtarët e Zyrës për Integrime Evropiane, Kthim dhe Komunitete. Vizita e znj.Çitaku është thënë të jetë në funksion të bisedimit për sfidat e komunave në procesin e riintegrimit të personave te riatdhesuar, pas vlerësimit pozitiv që Komisioni Evropian i ka bërë grupit punues te MIE-së dhe Ministrisë së Punëve te Brendshme. Kryetari i Komunës, z. Zharku, e ka falënderuar ministren Çitaku për bashkëpunimin e saj me Komunën e Kaçanikut. Për faktin se procesi i riintegrimit të personave të riatdhesuar është shumë i rëndësishëm, kryetari është shprehur se Komuna është munduar t'i kryejë me përpikëri detyrimet e saj. "Mendoj se kemi bërë një punë të mirë për qytetarët tanë jo vetëm për shkak se një gjë e tillë është kërkuar si standard, por e ndiejmë veten të obliguar që t'u ofrohet ndihma e nevojshme qytetarëve tanë të riatdhesuar në rrafshin shëndetësor, arsimor dhe atë të pajisjes me dokumente", ka thënë kryetari Zharku. Ai ka nënvizuar se të riatdhesuarit do të kenë përparësi ndaj qytetarëve të tjerë për riintegrimin sa më të shpejtë të tyre në shoqëri. Ministrja Çitaku e ka falënderuar kryetarin Zharku për përkushtimin e tij personal në përmbushjen



e të gjitha kritereve që dalin nga agjenda evropiane dhe për punën e jashtëzakonshme që është duke e bërë Komuna e Kaçanikut për riintegrimin e të riatdhesuarve. Ndërkaq, shefi i Zyrës ndërlidhëse greke, z. Dimitris Moschopoulus, ka thënë se Greqia e mbështet fuqishëm perspektivën evropiane të Kosovës dhe të tërë rajonit. Znj. Hidajete Guri, udhëheqëse e Zyrës për Integrime Evropiane, Kthim dhe Komunitete (ZIKK), e ka njoftuar ministren Çitaku me punën dhe aktivitetin e kësaj zyre. Ajo ka thënë se sipas statistikave, gjatë vitit 2010 në komunën e Kaçanikut janë kthyer 77 persona, ndërsa deri në korrik të këtij viti edhe 32 të tjerë. Znj. Guri ka thënë se zyrtarë të ZIKK-së kanë bërë vizita në terren në funksion të njoftimit të të riatdhesuarve me të drejtat e tyre.

## Kryetarit i dorëzohet pasaporta biometrike



**11 nëntor** - Në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil ka nisur dorëzimi i pasaportave bimetrike, ndërsa kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, i pari është pajisur me kësi dokumenti. Kryetarit Zharku pasaportën ia ka dorëzuar z. Bajram Dogani, zyrtar i QKRC-së. Pas marrjes së pasaportës, z. Zharku u ka thënë gazetarëve dhe zyrtarëve të pranishëm se pasaportën po e merr në kohë rekorde, vetëm një javë pas aplikimit. Ai kërkoi nga zyrtarët e QKRC që të vazhdohet me këtë dinamikë të dorëzimit të pasaportave biometrike aplikuesve nga komuna jonë. Është thënë të jetë i kënaqshëm interesimi i qytetarëve kaçanikas për t'u pajisur me pasaporta të reja. Është rikujtuar se pasaportat biometrike janë njëri nga kushtet e kërkuara për plotësim në procesin e liberalizimit të vizave me vendet e Bashkimit Evropian.

# Asfaltohet rruga në fshatin Gajre

**14 nëntor** - Është asfaltuar rruga e fshatit Gajre. Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, nënkryetari i Komunës, z.Heset Loku, shefi i Zyrës së Prokurimit, z.Zeqir Selmani, dhe menaxheri i projektit, z.Fatos Koxha, e kanë përcjellur nga afër shtruarjen me asfalt të rrugës. Kryetari Zharku dhe shoqëruesit e tij e kanë përshkuar këmbë pothuajse tëre gjatësinë prej dy kilometrash të rrugës, me ç'rast janë njoftuar me detajet e projektit. Projekti për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës në Gajre parasheh asfaltimin e saj në gjatësi 2 mijë metrash, gjerësi prej 5 metrash dhe trashësi të asfaltit prej 7 centimetrash. Po ashtu, në projekt figuron edhe ndërtimi i bankinave në të dy krahët e rrugës me gjerësi prej 0,50 metrash dhe ndërtimi i lëshesave për largimin e ujërave atmosferik. Për realizimin e këtij projekti, nga buxheti i Komunës janë alokuar 134 mijë e 370 euro.



## Drejtori Ceka merr pjesë në takimin e ekspertëve të deponive në Bursa

**15 nëntor** - Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, z. Rushan Ceka, ka udhëtuar për në Bursa të Turqisë ku nesër (16 nëntor) do të mbahet takimi i ekspertëve të Evropës Juglindore për menaxhimin e deponive të mbeturinave. Drejtuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, është formuar një grup punues i përbëre nga ekspertë lokalë të asociacioneve përkatëse të komunave të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Kroacisë, Bullgarisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Grupi i ekspertëve ka nxjerrë disa të dhëna të rëndësishme, të cilat do të prezantohen para akterëve gjatë takimit në Bursa. Gjatë këtij takimi do të diskutohen edhe zgjidhjet e mundshme të problemeve lidhur me menaxhimin e deponive. Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), mbështetur nga Fondi i hapur rajonal për Evropën Juglindore, e ka iniciuar projektin me fokus në menaxhimin e deponive të mbeturinave. Aktualisht shumë prej deponive të mbeturinave në rajon nuk operojnë si duhet duke shkaktuar pasoja negative për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

## Komuna dhe LOGOS - debat publik për Planin rregullues të qytetit

16 nëntor - Komuna dhe projekti Zvicër – Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS kanë mbajtur debat me qytetarë për Planin rregullues të zonës së parë të qytetit Kaçanik. Të pranishëm ishin edhe kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, dhe koordinatori i LOGOS-it, z. Norbert Pijls. Kryetari Zharku ka thënë se Plani rregullues për zonën e pare të qytetit është dokument i rëndësishëm për shkak se përcakton kahet gjithëpërfshirëse të zhvillimit. "Ky dokument do të jetë në përputhje me interesat e qytetarëve që jetojnë në këtë zonë, por edhe të të gjithë qytetarëve të komunës së Kaçanikut", ka theksuar z.Zharku. Ai e ka falënderuar LOGOS-in për mbështetjen e këtij projekti dhe projekteve të tjera në Komunën e Kaçanikut, që është duke i përkrahur jo vetëm financiarisht. Ndërkaq, z. Pijls, ka nënvizuar se ky është rasti i parë në Kosovë që Plani rregullues hartohet nga

Komuna me pjesëmarrje të drejtpërdrejt të qytetarëve. Koordinatori i LOGOS-it të pranishmëve ua ka rikujtuar edhe projektet tjera që i ka realizuar dhe që janë në realizim e sipër në komunën e Kaçanikut. Në këtë kontekst, z. Pijls ka theksuar se LOGOS-i e ka financuar ndërtimin e trotuarit në rrugën "Vëllezërit Çaka", ndërtimin e urës mbi lumin Neredime etj., ndërsa të një rëndësie të veçantë e ka vlerësuar mbështetjen për hartimin e Planit rregullues urban për qytetin e Kaçanikut. Znj. Suzana Goranci, zyrtare e Departamentit të Planifikimit Hapësinor të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka thënë se Komuna e Kaçanikut më herët e ka hartuar dhe miratuar Planin Zhvillimor Komunal dhe Planin Zhvillimor Urban, ndërsa tashti e ka marrë pëlqimin nga MMPH-ja për hartimin e Planit rregullues. "Ne e kemi mbështetur Komunën me këshilla e ndihmë profesionale", ka thënë znj.Goranci. Ajo e ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm hartimin e Planit me pjesëmarrjen e drejtpërdrejt të qytetarëve. Z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka prezantuar punën e finalizuar të fazës së parë, përkatësisht profilin e Planit rregullues për zonën e parë të qytetit. Në vijim rreth 160 qytetarët e pranishëm janë ndarë në 4 grupe punuese: grupi për demografi dhe çështje civile, grupi për zhvillim ekonomik, grupi për infrastrukturë dhe grupi për shfrytëzimin e tokës dhe mjedis. Ata kanë dhënë propozime konkrete për vizionin dhe përmbajtjen e planit, ndërsa propozimet e tyre janë vlerësuar edhe nga koordinatori i LOGOS-it, z.Norbert Pijls.



# EULUP dhe Komuna diskutojnë për planifikim hapësinor rural

**21 nëntor** – Ekspertë të projektit EULUP (Mbështetja e Mëtutjeshme e Shfrytëzimit të Tokave) dhe zyrtarë komunalë, në një punëtori të organizuar kanë debatuar për planifikimin hapësinor rural, saktësisht për informimin dhe planifikimin më të mirë të zonave rurale në funksion të ruajtjes dhe menaxhimit tokës bujqësore. Znj. Neda Nordin, eksperte për mjedis dhe planifikim e EULUP-it, ka prezantuar pasqyrat e bazës për planifikim hapësinor rural. Ajo ka thënë se Kosova është duke humbur tokën më produktive bujqësore për shkak të ndërtimeve të pakontrolluara, ndërsa ka përmendur edhe sfida të tjera. Znj.Nordin ka thënë se planet zhvillimore komunale nuk i kushtojnë vëmendje adekuate planifikimit hapësinor rural. Sipas saj, planifikimi hapësinor nuk përfshinë vetitë e brendshme të tokës dhe nuk shfrytëzohet si duhet sistemi GIS për planifikim. Ndërkaq, z. Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, ka thënë se nëpërmjet këtij projekti Komuna e Kaçanikut i ka ngritur kapacitetet teknike të zyrtarëve komunalë lidhur me ruajtjen dhe menaxhimin e tokave bujqësore. "Ky projekt do të krijojë një bazë të mirë edhe për rifreskimin e planeve zhvillimore komunale në rrafshin e bujqësisë, mjedisit dhe planeve të ndërtimit, ndërsa është krijuar një bazë e gjerë e të dhënave të sistemit GIS dhe hartash të tokave që mundëson menaxhim më të avancuar", ka thënë z.Provoliu. Projekti EULUP synon të bëjë shtimin e vazhdueshëm të produktivitetit dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore nëpërmjet reformave dhe planifikimit të qëndrueshëm hapësinor. Projekti



financohet nga Bashkimi Evropiane dhe menaxhohet nga Zyra e Komisionit Evropian, ndërsa zbatohet nga MBPZHR-ja dhe GFA Consulting Group GmbH/BVVG.

## Hartohet drafti parafinal i planit të veprimit për sinjalistikën rrugore

23 nëntor - Është hartuar drafti parafinal i planit të veprimit për sinjalistikën rrugore. Grupi punues i Komunës, i përbërë nga zyrtarë komunalë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, në bashkëpunim me projektin Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) të USAID-it, janë duke punuar bashkërisht për hartimin e planit të veprimit për përmirësimin e shenjëzimit horizontal dhe vertikal të rrugëve në komunën e Kaçanikut. Draftin parafinal të planit e ka prezantuar z. Edlir Vokopola, konsulent i DEMI-it, ndërsa në procesin e hartimit të tij kanë kontribuar edhe z.Sali Salihu dhe z.Nehat Ramadani, po ashtu konsulentë të DEMI-it. Versioni final i planit për shenjëzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve do të përgatitet gjatë një punëtorie 2-ditore që do të mbahet në dhjetor, ndërsa pastaj do të nisë zbatimi i tij. Për hartimin e këtij plani USAID-i nëpërmjet projektit DEMI është duke ofruar ndihmë teknike e profesionale, ndërsa bashkë me Komunën do ta bashkëfinancojnë zbatimin e tij. Z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka thënë se sivjet Komuna e Kaçanikut i ka investuar 20 mijë euro për përmirësimin e sinjlistikës rrugore, ndërsa për mot i ka planifikuar edhe 10 mijë euro.



# Diskutohet ecuria e hartimit të Planit rregullues urban

**24 nëntor** - Ecuria e hartimit të Planit rregullues urban për zonën e parë të qytetit të Kaçanikut është diskutuar në takimin e Grupit punues për përpilimin e tij. Grupi punues përbëhet nga zyrtarë komunalë, ekspertë të jashtëm dhe z.Dritan Shutina, ekspert i projektit Zvicër-Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS. Në takim është diskutuar edhe për prioritetet e propozuara nga qytetarët në debatin publik të mbajtur ditë më parë me temë: "Plani Rregullues për zonën e parë të qytetit të Kaçanikut". Z.Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe z. Shutina e kanë vlerësuar të suksesshëm debatin. Duke folur për prioritet e artikuluara në debat, drejtori Troni ka thënë se pjesa dërrmuese e propozimeve do të përfshihen në draftin e Planit.



# Me aktivitete të shumta shënohet 28 Nëntori

**28 nëntor** - Aktivitetet për shënimin e 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit, Ditëlindjes së Komandantit legjendar Adem Jashari dhe daljes publike të UÇK-së, kanë nisur me homazhe te Varrezat e Dëshmorëve. Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, me bashkëpunëtorë, dhe përfaqësues të OVL të UÇK-së kanë vendosur kurora lulesh dhe i kanë nderuar dëshmorët me një minutë heshtje. Aktivitetet për shënimin e festave të sipërpërmendura kanë vazhduar me mbajtjen e akademisë solemne në pallatin e kulturës “Xheladin Kurtaj”. Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, ka thënë se 28 Nëntori është dita e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, ditëlindja e Komandantit legjendar Adem Jashari dhe dita e paraqitjes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Këto janë ngjarje që i dhanë shpirt historisë sonë, janë festa të krenarisë sonë kombëtare", ka theksuar z.Loku në fjalën e tij të mbajtur në akademi. Ai ka shtuar se në këtë ditë me respekt dhe nderim të thellë i përkujtojmë të gjithë ata që luftuan dhe u flijuan për lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Z.Loku i ka përmendur edhe projektet që u përuruan e të cilat madhështuan festat. Folësi i radhës në akademi, z. Hajrush Kurtaj, zëvendëskomandant i brigadës 162”Agim Bajrami”, ka thënë se flamuri ynë për herë të parë valoi në Krujën e Skënderbeut e më pas në Vlorën heroike



të Ismail Qemalit. “Nëntori i dytë për fat të keq nuk e gëzoi Kosovën e gjakosur, por flamuri ynë qëndroi i patundur në ballë të çetave çlirimtare” , ka thënë z. Kurtaj. Ai ka nënvizuar se trojeve tona u buzëqeshi fati më 28 Nëntor të vitit 1955, kur në Prekaz lindi Adem Jashari, dhe më 28 nëntor të vitit 1997, kur UÇK-ja doli publikisht. "Amaneti i dëshmorëve ishte bashkimi kombëtar, prandaj të punojmë me vendosmëri dhe të bashkuar për arritjen e këtij ideali”, ka theksuar z. Kurtaj. Naser Kuka, ish-i burgosur politik, ka prezantuar një fjalë rasti për përvjetorin e 17-të të rënies së dëshmorit Ismail Raka. "Pikërisht 17 vjet më parë u mbyt me torturë nga regjimi i atëhershëm dëshmori Ismail Raka. Ai ra me besimin e plotë se një ditë Kosova do të bëhej e lirë dhe e pavarur", ka theksuar z. Kuka. Ai e ka përshkruar dëshmorin si fjalëpak, por të shoqërueshëm, të dashur dhe me plot respekt në rrethin ku ai bënte punë ilegale për çështjen kombëtare. "Në raste kur e kërkonte nevoja dinte të merrte zjarr, bëhej flakë dhe ishte i pakompromis për atë që e konsideronte të drejtë. Angazhimi i tij në çështjen e Kosovës zë vend të rëndësishëm në lëvizjen çlirimtare, prandaj rënia e tij ishte humbje e madhe për lëvizjen çlirimtare", ka shtuar z. Kuka. Veprën e dëshmorit Raka ai e ka cilësuar një margaritar të çmuar në historinë e popullit tonë. Në kuadër të aktiviteteve të shumta për shënimin e festave është hapur edhe një ekspozitë në të cilën janë ekspozuar vizatime të nxënësve të shkollës fillore "Emin Duraku" me temë: "28 Nëntori – Dita e Flamurit", ndërsa janë përuruar edhe dy projekte infrastrukturore.

## Festat madhështohen me përurim projektesh të finalizuara

**28 nëntor** – Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e festave të 28 Nëntorit janë përuruar dy projekte kapitale. Në fshatin Gajre i është prerë shiriti përurues rrugës së asfaltuar, ndërsa në qytet është përuruar ura mbi lumin Neredime. Asfaltimi i rrugës së sipërpërmendur është pjesë e projektit për asfaltimin e segmentit rruga magjistrale-Gajre-Ivajë. Asfaltimi i rrugës magjistrale-Gajre ka kushtuar 134.370 euro, ndërsa është financuar nga buxheti komunal. Shiritin e rrugës së Gajres e kanë prerë: z. Heset Loku, nënkryetar i Komunës, z. Xhelal Gashi, kryesues i KK-së dhe z. Fadil Çallaku, veteran i UÇK-së nga fshati Gajre. Kryetari Zharku ka thënë se kjo rrugë e

asfaltuar është vetëm fillimi i realizimit të projektit të rrugës magjistrale-Gajre-Ivajë. Ai ka deklaruar se asfaltimi i kësaj rruge e lehtëson qarkullimin e automjeteve dhe njerëzve, ndërsa meritat e para për realizmin edhe të këtij projekti ua ka atribuar dëshmorëve dhe luftës së UÇK-së, për faktin se, siç është shprehur ai, liria erdhi në saje të rënies heroike të dëshmorëve, të cilët i kujtojmë me pietet të lartë, dhe luftës së UÇK-së që hapi rrugë për çlirimin e vendit dhe krijimin e kushteve për jetë më të mirë për të gjithë qytetarët. Z.Muhamet Mulaku, administrator i Gajrës, e ka falënderuar Komunën për investimin në këtë projekt me rëndësi jetike për banorët e fshatit. Në shenjë mirënjohjeje, banorët e Gajres kryetarin Zharku e kanë nderuar me dy dhurata. Ndërkaq, përurimin e urës e kanë bërë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, koordinatori i LOGOS-it, z. Norbert Pijls dhe z. Shkëlzen Raka, djali i dëshmorit Ismail Raka. Ky projekt është bashkinvestim i LOGOS-it dhe Komunës së Kaçanikut. Për ndërtimin e urës, projekti LOGOS, që financohet nga taksapaguesit zviceraë, i ka investuar 50 mijë euro, ndërsa Komuna 27.602 euro. Ura e ndërtuar është e gjatë 17 metra, e gjerë 6 metra, ndërsa ka edhe ndriçim dhe shtigje për këmbësorë në të dyja anët e saj. Në fjalën e



tij, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka falënderuar LOGOS-in dhe popullin zviceran për këtë investim, por edhe popullin amerikan për ndihmat e vazhdueshme para, gjatë dhe pas luftës. Koordinatori i LOGOS-it, z.Pijls, ka theksuar se Qeveria zvicerane ka investuar në këtë projekt, ndërsa urën e ka ndërtuar Komuna e Kaçanikut. "Ne kemi punuar me disa komuna të rajonit të Gjilanit, por Komuna e Kaçanikut është ajo e cila i bën punët më mirë dhe më shpejtë", ka komplimentuar z. Pijls.



## KK-ja miraton raportin e shpenzimeve 9-mujore

**30 nëntor** - Në seancën e dhjetë të rregullt të Kuvendit të Komunës është shqyrtuar dhe miratuar raporti për realizimin e mjeteve buxhetore për periudhën janar – shtator 2011. Është miratuar edhe propozimvendimi për rritjen prej 19.032 eurosh të buxhetit të sivjetmë të Komunës. Mjetet që i janë shtuar buxhetit janë arkëtuar nga mësimi joformal në SHMP "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka". Z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e ka shpalosur raportin 9-mujor të shpenzimeve. Ai ka thënë se raporti është harmonizuar me Departamentin e Thesarit sipas standardeve ndërkombëtare dhe i është përcjellur Ministrisë së Financave

(MF) brenda afatit. "MF-ja nuk ka pasur asnjë vërejtje në raportin e dorëzuar", ka theksuar drejtori Vërbani. Ai ka nënvizuar se edhe sivjet është shënuar trend rritës i buxhetit krahasuar me vitet paraprake. "Buxheti aktual në shumë prej 5.735.428 eurosh është për 5 % ose 274.235 euro më i lartë se ai fillestar, i miratuar në shtatorin e vitit të kaluar në shumë prej 5.461.193 euro", ka theksuar z. Vërbani. Ai ka thënë se buxheti për periudhën janar-shtator është realizuar në shkallë prej 79,1 % në proporcion me mjetet në dispozicion (të alokuara) në shumë prej 4.539.309 eurosh. Ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është shënuar rritje prej 23,2 %. Shikuar sipas kategorive ekonomike, për paga dhe mëditje janë shpenzuar gjithsej 2.324.868 euro, për mallra dhe shërbime 238.009 euro, për shërbime komunale 56.151 euro, për subvencione dhe transferime 57.363 euro dhe për investime kapitale 854.668 euro ose 24,2 % e totalit të buxhetit. Sipas raportit të sipërpërmendur, shpenzues më i madh i buxhetit është sektori i arsimit me 50 %, ndërsa pas tij vijnë sektorët e administratës (38,2 %) dhe shëndetësisë (11,8 %).



# DHJETOR 2011

## Shërbimi i ofiqarisë bëhet me Libër unik protokolli

**1 dhjetor** - Shërbimi i ofiqarisë i KK të Kaçanikut është bërë me Libër unik të protokollit. Në 5 zyrat e vendit në terren është instaluar softueri i rrjetit të intranetit që e ka mundësuar krijimin e librit. Z.Jeton Topalli, drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, ka thënë se libri është një hap drejt krijimit të një administrate moderne standardesh evropiane. "Libri unik i protokollit është një komponentë shumë e rëndësishme për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimit të integruar", ka nënvizuar ai. Ndërkaq, z.Bejtulla Dalloshi, përgjegjës për teknologjinë informative, ka sqaruar se instalimi i softuerit të sipërpërmendur është bërë në përputhje me Planin e veprimit të Ministrisë së Administratës Publike për zbatimin e Strategjisë për qeverisje elektronike 2009-2015. "Kjo strategji synon zëvendësimin e shërbimeve tradicionale me aso elektronike", ka thënë z.Dalloshi.



# Përurohet rruga 7,5 kilometërshe e Kotlinës

**3 dhjetor** - Është përuruar rruga e asfaltuar që e lidh fshatin Kotlinë me magjistralen Prishtinë - Shkup. Shiritin përurues e kanë prerë: z.Fehmi Mujota, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, z.Xhabir Zharku, kryetar i Komunës dhe z. Nuredin Kuçi, baba i dëshmorit Xhemajl Kuçi. Ministri Mujota ka thënë se Kotlina e ka merituar këtë rrugë të asfaltuar. "Kur Kosova kishte nevojë për ndihmën e këtyre njerëzve, banorët e Kotlinës kanë qenë të gjithë të mobilizuar. Ishin të gjithë në shërbim për lirinë e atdheut. Kotlina e pritjeve të mëdha, Kotlina e ushtarëve të lirisë, e dëshmorëve, e martirëve dhe e invalidëve të luftës, e ka merituar një projekt të tillë", ka deklaruar z.Mujota. Ai ka nënvizuar se rruga e asfaltuar ka krijuar kushte që Kotlinës t'i kthehet perspektiva dhe banorët të qëndrojnë në fshatin e tyre. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka përgëzuar banorët e Kotlinës për rrugën e asfaltuar, ndërsa Qeverinë e Kosovës e ka falënderuar për mbështetjen financiare të projektit. Kryetari Zharku e ka falënderuar ish-ministrin e Ministrisë së Transportit dhe Postë-telekomunikacionit, z. Fatmir Limaj, për angazhimin e tij për fillimin e asfaltimit të rrugës dhe ministrin aktual, z. Mujota, për finalizimin e projektit. "Besoj se Qeveria e Kosovës do të na mbështes edhe në projekte tjera", është shprehur z.Zharku. Në këtë kontekst, ai e ka përmendur rrugën Gajre-Ivajë-Shtrazë. "Segmentin e parë të kësaj rruge e kemi përfunduar me mjete të buxhetit komunal, ndërsa



shpresoj se krejt rrugën do ta finalizojmë edhe me mbështetje të Qeverisë", ka thënë kryetari Zharku. Folësi i radhës në ceremoninë përuruese, nënkryetari i Komunës, z.Heset Loku, banor i fshatit, e ka falënderuar kryetarin Zharku dhe ministrin Mujota për mbështjen e projektit për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës së Kotlinës. "Para 12 vjetësh ky fshat ishte tërësisht i shkatërruar, ndërsa sot po i gëzohemi rrugës së asfaltuar dhe arritjeve të tjera", ka theksuar z.Loku. Rruga e Kotlinës është asfaltuar në gjatësi prej 7.500 metrash dhe gjerësi prej 5 metrash. Asfalti është shtruar në trashësi prej 8 centimetrash, ndërsa në të dyja anët e rrugës janë punuar bankinat me zhavorr dhe lëshesa të ujit në disa pika. Për realizmin e këtij projekti MTPT-ja i ka investuar 1 milion e 50 mijë euro, ndërsa Komuna 164.570 euro. Ministri Mujota dhe kryetari Zharku, bashkë me shoqëruesit e tyre, pas përurimit të rrugës u kanë bërë homazhe kotlinasve të rënë për liri. Gjatë luftës në altarin e lirisë kanë rënë 15 dëshmorë dhe janë martirizuar 14 civilë nga Kotlina.

## Rinovohet QKMF-ja dhe 7 ambulanca në terren



**6 dhjetor** - Kanë vazhduar punimet për rinovimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik dhe 7 ambulancave në terren. Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Misim Sopa, i ka inspektuar punimet për rinovimin e ambulancave në Doganaj, Stagovë dhe Begracë. Drejtori Sopa ka thënë se aktualisht janë duke u rinovuar edhe ambulancat në Glloboçicë, Biçec, Dubravë, Bob dhe QKMF-ja në Kaçanik. Ndërkaq, znj.Jehona Dërvishi, menaxhere

e projektit, ka thënë se po bëhet rinovimi i pjesshëm i këtyre objekteve. Znj. Dërvishi ka nënvizuar se punët po zhvillohen sipas dinamikës së përcaktuar. Për rinovimin e objekteve të sipërpërmendura, nga buxheti i sektorit komunal të Shëndetësisë janë alokuar 25 mijë e 213 euro.

## GIZ-i i dhuron gjenerator shkollës së Kaçanikut të Vjetër

**7 dhjetor** - Shoqata gjermane GIZ (Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman) ia ka dhuruar shkollës fillore "Qamil Ilazi" të Kaçanikut të Vjetër një gjenerator me fuqi 16,5 kwh për ta furnizuar me energji kabinetin e informatikës dhe jo vetëm atë. Drejtori i shkollës, z.Fadil Krasniqi, e ka falënderuar GIZ-in për ndihmën, ndërsa donacionin e ka vlerësuar rezultat të bashkëpunimit shumë të mirë të shkollës me organizatën e sipërpërmendur. Është thënë se gjeneratori ka kapacitet të mjaftueshëm, ndërsa GIZ-i i kishte shpenzuar 5 mijë e 500 euro për blerjen e tij. Drejtori Krasniqi ka rikujtuar se "Caritasi" i Luksemburgut e ka pajisur kabinetin me 22 kompjuterë dhe i ka ndërtuar fushat sportive, ndërsa GIZ-i vjet e ka pajisur kabinetin me inventar, videoprojektor, laptop, printer etj.



# DAK-ja i jep notë pozitive drejtorëve të shkollave për buxhetet

**8 dhjetor** - Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës e ka vlerësuar me notë pozitive operimin e drejtorëve me buxhetet e shkollave. Në takimin e kreut të DAK-së, z. Azem Guri, me drejtorët e shkollave të komunës është diskutuar për realizimin e buxheteve të sivjetme të shkollave dhe planifikimet për vitin e ardhshëm. Z. Guri është shprehur të jetë i kënaqur me realizimin e buxheteve të shkollave nga drejtorët. "Buxhetet e shkollave në total kanë qenë në shumë prej 2.583.946 eurosh, ndërsa unë jam i kënaqur me menaxhimin e këtyre mjeteve nga drejtorët", ka thënë z. Guri në takim. Është thënë se 2011-ta ka qenë viti i dytë i operimit të drejtorëve të shkollave me buxhetet e alokuara për secilën nga 15 shkollat në territorin e komunës. Për pagat e 553 të punësuarve në shkollat e komunës janë shpenzuar 2.414.929 euro, për mallra dhe shërbime 144.146 euro dhe për shërbime komunale 24.872 euro. Z. Guri ka kërkuar nga drejtorët e pranishëm në takim raport javor për mungesat e arsyeshme dhe të paarsyeshme të mësimdhënësve.



# Projekti i binjakëzimit mbështet Komunën në çështjet mjedisore

**9 dhjetor** - Projekti i binjakëzimit: "Bashkëpunimi evropian për komuna më të fuqishme - planifikimi për ofrimin e shërbimeve", do ta mbështesë Komunën e Kaçanikut në çështje mjedisore dhe menaxhimin e mbeturinave. Kështu ka thënë z.Patric O'Brien, ekspert për çështje të mjedisit i projektit të sipërpërmendur, në takim me kreun e Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Bekim Troni. "Komunës do t'i ofrohet mbështetje profesionale dhe teknike", ka theksuar z.O'Brien, i cili shoqërohej nga znj.Argurjana Sadiku. Ndërkaq, z.Troni ka shpalosur aktivitetet e sektorit të mjedisit në funksion të përmirësimit të gjendjes në këtë rrafsh, ndërsa ka artikuluar shqetësimin e tij për ndotjen e ajrit dhe të ujërave të lumenjve. "Neredimja është shndërruar në kanalizim të ujërave të zeza që vijnë nga Ferizaj, ndërsa ndotës të ajrit dhe të lumit Lepenc janë fabrikat 'New Lepenci' dhe 'Silcapor'", ka theksuar z.Troni. Aspekte të kontributit vullnetar të të rinjve për një mjedis të pastër ka shpalosur znj.Fatlume Guri, koordinatore e Ambientalistëve të Rinj të Kaçanikut. Projekti: "Bashkëpunimi evropian për komuna më të fuqishme - planifikimi për ofrimin e shërbimeve" është i Komisionit Evropian, ndërsa synon të ndërtojë marrëdhënie të ngushta ndërmjet Britanisë së Madhe e Danimarkës me Kosovën. Përfitues të këtij projekti janë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe të gjitha komunat e Kosovës.



# "Caritas"-i i Luksemburgut dhe Komuna firmosin marrëveshjen për bashkëfinancim në Elezaj



**12 dhjetor** – "Caritasi" i Luksemburgut dhe Komuna e kanë firmosur marrëveshjen për bashkëfinancim të projekteve të fshatit Elezaj në shumë prej 400 mijë e 342 eurosh. Në prani të Këshillit të zhvillimit të komunitetit të fshatit, marrëveshjen e kanë firmosur z.Heset Loku, nënkryetar i Komunës, dhe znj.Valbonë Rexhepi, zyrtare vendëse e "CarLux"-it. Z.Loku e ka falënderuar "CarLux"-in dhe Qeverinë e Luksemburgut për krejt investimet në komunën e Kaçanikut. Ndërkaq, znj.Rexhepi, ka thënë se investimet e mjeteve të alokuara do të bëhen në sektorët e edukimit, të shëndetësisë dhe të gjenerimit të të hyrave. Për realizimin e projekteve "CarLux"-i i ka alokuar 316.460 euro ose 70% të totalit të mjeteve, ndërsa Komuna 83.882 euro (30%). Z.Ramadush Osmani, administrator i fshatit Elezaj, e ka falënderuar "CarLux"-in dhe Komunën për financimin e projekteve me interes për komunitetin e fshatit. Më herët, shefi i misionit të "CarLux"-it në Kosovë, z.Gerhard Fischer, pati thënë se përveç projekteve me komunat është miratuar edhe një fond prej 1,3 milion eurosh për mbështetjen e komuniteteve të 4 fshatrave të 6 komunave të rajonit të Gjilanit. Kaçaniku ka figuruar në listën e komunave pretenduese për të qenë përfituese nga fondi i sipërpërmendur.

## Shkolla e Glloboçicës përfituese e grantit të Bankës Botërore

**12 dhjetor** - Shkolla fillore "Gafurr Luma" e fshatit Glloboçicë është shpallur fituese e grantit prej 5 mijë e 110 eurosh të "Projektit për Zhvillimin Institucional të Arsimit në Kosovë", që zbatohet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe financohet nga Banka Botërore. Marrëveshjen për alokimin e mjeteve të grantit e kanë nënshkruar: z.Xhavit Dakaj, sekretar i përhershëm në MASHT-it, z.Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës dhe z.Qazim Ceka, drejtor i shkollës. Sipas marrëveshjes, projekti i shkollës me paratë e grantit duhet të finalizohet deri më 30 mars 2012. Z. Guri ka rikujtuar se në fazën e parë grante shkollore patën përfituar SHMP "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka" dhe SHF"Dituria" e Ivajës.



## Përurohen projektet e "Kosovës së bukur"

**14 dhjetor** - Janë përuruar 2 projekte infrastrukturore të programit "Kosova e bukur" të Komisionit Evropian. Është përuruar shëtitorja e ndërtuar përskaj krahut të majtë të lumit Neredime dhe fusha e sporteve e SHF"Emin Duraku". Shiritin përurues të shëtitores e kanë prerë: z.Xhabir Zharku,

kryetar i Komunës, z.Nenad Rashiq, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Christof Stock, shef i operacioneve të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë dhe z.Jorge Baca, shef i misionit të IOM-it në Kosovë. Z.Xhabir Zharku, kryetar i Komunës, e ka falënderuar KE-në për investimin, ndërsa ka artikuluar kërkesën për investime të reja në Kaçanik nga ky donator. Z.Zharku ka nënvizuar se pos që e ka zbukuruar Kaçanikun, shëtitorjja e re ka qenë projekt me efekt zbutës në rrafshin e papunësisë.

"Më lejoni të falënderoj donatorin, Qeverinë e Kosovës në krye me z.Thaçi dhe ministrin Rashiq për kontributin e dhënë për zbutjen e papunësisë", ka thënë kryetari Zharku. Ndërkaq, z.Stock ka rikujtuar se projektet e "Kosovës së bukur" janë projektuar në funksion të avancimit të infrastrukturës urbane dhe zbutjes së varfërisë përmes gjenerimit të vendeve të punës. "Ky projekt i ka punësuar edhe disa të papunë, ndërsa besoj se përvoja e akumuluar këtu atyre do t'iu ndihmojë edhe për punësim në të ardhmen", ka thënë z.Stock.



Ministri Rashiq ka deklaruar se papunësia do të vazhdojë të jetë sfidë edhe në të ardhmen. "Për zhvillim ekonomik dhe punësim institucionet janë duke i ndërmarrë dhe do t'i ndërmarrin hapat e duhur", ka thënë z.Rashiq. Ndërkaq, z.Jorge Baca, ka theksuar se projekti i shëtitores u ka mundësuar punësim sezonal 30 vetave. "Njëzet prej tyre janë përzgjedhur nga lista e punëkërkuesve të regjistruar në Zyrën Komunale të Punësimit në Kaçanik", ka nënvizuar Baca. Në shenjë mirënjohjeje, kryetari Zharku ia ka dhuruar

emblemën e Komunës z.Stock. "Kjo është një dhuratë e çmueshme të cilën do ta ruaj në një kend te zyrës sime dhe do ta kujtoj përherë Kaçanikun", ka thënë z.Stock. Për realizimin e këtij projekti janë shpenzuar gjithsej 64.709 euro. Komuna ka participuar me 3.607 euro ose 5 % e shumës së projektit, ndërsa 61.038 euro i ka investuar Komisioni Evropian. Projekti është zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në partneritet me Këshillin Danez për Refugjat (DRC). Është përuruar edhe fusha sportive multifunksionëshe e SHF"Emin Duraku". Shiritin përurues e kanë prerë: z.Xhabir Zharku, z.Nenad Rashiq, z.Christof Stock dhe z.Lulzim Krasniqi, u.d i drejtorit të shkollës. Drejtori Krasniqi ka thënë se fushën sportive do ta shfrytëzojnë më se 1.700 nxënës. Në emër të kolektivit të shkollës,z.Krasniqi ia ka dhuruar z.Stock i ka uruar nxënësit për fushën e sportive dhe idetë brilante që i kanë shfaqur në garën e quajtur "Për një ambient më të mirë", e organizuar nga SOS fshatrat e Kosovës. Rrokullisjen e parë simbolike të topit në fushën e re e kanë bërë kryetari Zharku, ministri Rashiq dhe z. Stock. Për realizimin e këtij projekti janë investuar gjithsej 82 mijë euro - donacion i Komisionit Evropian.

## Kryetari takon shefin e operacioneve të ZNKE-së

**14 dhjetor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka zhvilluar një takim pune me z. Christof Stock, shef i operacioneve të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE) në Kosovë. Takimi është mbajtur pas përurimit të shëtitores përskaj Neredimes dhe fushës multifunksionëshe të sporteve të SHF"Emin Duraku", ndërsa është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë edhe në të ardhmen. Kryetari ka artikuluar kërkesën e tij për realizim projektesh të tilla edhe në të ardhmen. Në këtë kontekst, ai ka nënvizuar se Komuna është e interesuar për zgjerimin e parkut të qytetit dhe rregullimin e hapësirës së brendshme të kalasë, konkretisht për ndërtimin e një amfiteatri të hapur aty. "Shpresoj se projektet tona do të mbështeten financiarisht nga ZNKE-ja", ka thënë z.Zharku, pasi ka rikujtuar se Komuna ka buxhet të limituar për investime kapitale. Z.Stock e ka njoftuar kryetarin për programet e ZNKE-së për investime në kulturë, në infrastrukturë fizike, në çështje sociale dhe në mjedis. Ai ka shtuar se ZNKE-ja ka programe edhe për mbështetjen e fermerëve dhe bizneseve. "Sa i përket programit të

infrastrukturës komunale, aplikimi bëhet me konkurrim dhe fitues do të mund të jenë 6-7 komuna që i plotësojnë më së miri kushtet", ka theksuar z.Stock. Mysafiri e ka porositur kryetarin Zharku që të bashkëpunojë edhe me Agjencinë Rajonale për Zhvillim që financohet nga ZNKE-ja. Kryetari Zharku e ka falënderuar z.Stock për informacionet të cilat i ka vlerësuar shumë të rëndësishme. "Unë do të bashkëpunoj ngushtë me ju. Ne jemi zotuar ta ndryshojmë Kaçanikun, prandaj edhe do t'i koordinojmë veprimet tona të përbashkëta", është shprehur kryetari Zharku. Edhe z. Stock e ka artikuluar gatishmërinë e tij për bashkëpunim.



# Kreu i Komunës firmos memorandumin për mbrojtjen e lumenjve

**19 dhjetor -** Kryetari i Komunës, Xhabir Zharku, e ka nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit për koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 02/46 për ndalimin e eksploatimit të materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Kryetari Zharkun ka deklaruar se memorandumin e nënshkruar Komuna e Kaçanikut do ta zbatojë pa kurrfarë ngurrimi. Në funksion të krijimit të kushteve për zbatimin e vendimit të sipërpërmendur, memorandumi ndërkohë është nënshkruar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve dhe komunat: Prizren, Pejë, Gjakovë, Rahovec, Klinë, Gjilan, Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Vushtrri dhe Kaçanik". Memorandumin e sipërpërmendur z.Zharku e ka nënshkruar në prani të Gëzim Sahitit dhe Kujtim Aliut, zyrtarë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.



## Kryetari përgëzon nxënësit dhe mësimdhënësit në fund të gjysmëvjetorit

**23 dhjetor** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka përgëzuar nxënësit dhe mësimdhënësit për përfundimin e suksesshëm të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2011/2012. "Ju përgëzoj nga zemra për përfundimin e suksesshëm të gjysmëvjetorit të parë, ndërsa u dëshiroj pushime të këndshme, shëndet, lumturi e mbarësi", thuhet në urimin e kryetarit Zharku. Tutje, në urim thuhet se në vitin e kaluar shkollor arsimin e patëm vënë si prioritet dhe patëm rekomanduar e nxitur iniciativa në funksion të një sistemi cilësor. "Edhe këtë vit shkollor jemi zotuar se në komunën tonë do të aplikohen metodologji bashkëkohore të mësimdhënies duke promovuar ngritje cilësore në arsim, posaçërisht në atë bazik, meqë arsimi është instrumenti më strategjik për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë sonë", nënvizohet në urimin e z.Zharku. Në përmbyllje të urimit thuhet: "Synim yni është qasja e re dhe ngritja dinamike në procesin e mësimdhënies e mësimnxënies për të arritur standarde evropiane, prandaj kërkohet mobilizim e përkushtim për përmbushjen e objektivave".

## Kryetari Zharku: 2011-ta, vit suksesesh

**28 dhjetor** – Viti 2011 ka qenë vit i sukseseve. Janë realizuar një numër i madh projektesh me interes për qytetarët, ndërsa buxheti është shpenzuar në shkallën mbi 97 për qind. Kështu ka deklaruar kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, në takimin e fundvitit me gazetarët që raportojnë nga Kaçaniku. “Janë realizuar 50 projekte të vogla e të mesme”, ka theksuar z.Zharku. Për realizimin e tyre janë investuar 1.442.000 euro të buxhetit komunal dhe rreth 400 mijë euro nga donatorët qeveritarë dhe joqeveritarë. “Buxhetin komunal e kemi realizuar në shkallën prej më se 97 për qind”, ka theksuar kryetari Zharku. Ai e ka vlerësuar edhe punën e administratës komunale në raport me ofrimin e shërbimeve qytetarëve. Komuna sivjet i ka mbështetur edhe projektet në funksion të uljes së papunësisë dhe zbutjes së varfërisë nëpërmjet punësimesh sezonale. “Rëndësi i kemi kushtuar edhe subvencionimit të bujqësisë”, ka nënvizuar kryetari Zharku. Në këtë kontekst, ai ka thënë se fermerët sivjet janë subvencionuar me 100 mijë euro. “Me 100

